

**LUTFI ALIA**



**KRONIKA E EKSODEVE  
DHE VENDBANIMET  
ARBËRESHE NË ITALI  
1272 - 1774**

**SIENA 2016**



**Mbesës dhe nipit  
Emma ALIA  
Matteo ALIA**



LUTFI ALIA

KRONIKA E EKSODEVE  
DHE VENDBANIMET  
ARBËRESHE NË ITALI  
1272 – 1774

Siena 2016

Titulli origjinal:

# **KRONIKA E EKSODEVE DHE VENDBANIMET E ARBERESHEVE NE ITALI 1272 - 1774**

Autori:

**LUTFI ALIA**

Redaktor: Fatmir MINGULI

Korrektore letrare: Drita ALIA

Kopertina: Christina Kruuse CHRISTENSEN


Realizimi grafik: Genci ALIA

© Të gjitha të drejtat janë të autorit.

Shtëpia Botuese: 2M – Printing Durrës.

ISBN. 978-9928-209-48-1

Siena 2016



Portreti i Gjergj Kastrioti Skenderbeu.  
Në Galleria Degli Uffizi – Firenze.





## **KRONIKA E EKSODEVE DHE VENDBANIMET ARBËRESHE NË ITALI 1272 – 1774.**

### **1272 - 1278:**

Pas rënies të Principatës së Arbërit (1255), më 21 shkurt të vitit 1272, në skenën e historisë arbërore shfaqet *Regum Albaniae*, me mbret *Karli I Anzhuin (Carolus I, dei gratia Rex Napoli, Siciliae et Albaniae)*. Mbreti Karli I Anzhuin, mobilizoi shumë albanezë në shërbim të ushtrisë në Durrës dhe në gardën e oborrit mbretëror në Napoli. Kuptohet nuk kemi të bëjmë me emigrim të banorëve, por me transferimin e një grupi ushtarakësh albanezë, të cilët nuk u kthyen në vendlindje, por morën familjet e tyre dhe u sistemuan përfundimisht në Napoli dhe në qytete të tjera të mbretërisë.

Mbreti Karl I dhe pse u premtoi fisnikëve arbëror mbrojtje dhe vetqeverisje sipas ligjeve lokale, nuk e mbajti fjalën e për të shmangur revoltat, mori peng disa fisnikë, të cilët i internoi në Itali, disa prej tyre dhe i burgosi.

Ne vitin 1278, rezultojnë të burgosur në Terni një grup fisnikësh, si *Duka Tanush Dukagjini (Dux Ginus Tanusius Albanensis)*, në Anversa, ishin të burgosur 5 fisnikë ndër ata *Duka Tanush Skura* i Kunavisë (*Dux Tanusius Scura*).

### **1368 – 1410:**

Dyndjet sllave dhe presionet e tyre për konvertimin e popullatës në ortodoksë, i detyroi disa familje nga Drishti, Danja dhe Shkodra, të braktisin trojet dhe të emigrojnë në Venecia.

Në vitin 1368, në kishën San Severo të Sestiero di Castello të Venecias, komuniteti albanez hapi shkollën e devotshmerisë (*Scuola di Devozione*), që funksionoi deri në fund të vitit 1443.

Studiuesi Ilija Karanxha, në shkrimin "*Shkolla e shqiptarëve në Venedik*", botuar në [Zemrashqiptare.net](http://Zemrashqiptare.net), tregon se më 21 qershor 1368, Këshilli i të Dhjetëve në Venedik, i dha lejen disa "*personave të devotçëm*" të krijonin një "*scuola*", që do t'i dedikohej Shën Gallos

në kishën e Shën Severo. Sipas Lucia Nadin (2008), këta të devotshëm ishin drishtanë, të cilët e vazhduan veprimtarinë e tyre të organizuar si bashkëvllazëri deri më 10 shtator 1443.

Sipas Zef Valentinit, Serenismës nuk i pëlqeu entuziazmi i më se 200 albanezëve, për të formuar bashkëvllazërin e tyre, andaj arsyeja e vërtetë e mbylljes së shkollës ishte: “*Këta të mos guxojnë më të mbliidhen në të ardhmen.*” (G. Valentini: *Acta Albania Veneta p.III, f. 18, doc. 5029*). (P. Xhufi : *Dilemat e Arbërit 2006, f.246*).

Në fund të shekullit XIV, arbërit u përballen me sulmet e para të hordhive osmane, që pasi morën një pjesë të Moresë, Kosturin dhe Ohrin, në vazhdim pushtuan Beratit dhe Lushnjën.

Më 18 shtator 1385, Balsha II me reparte kalorësish i sulmoi turqit në Savër të Lushnjës, por u thye dhe Balsha II mbeti i vrarë. Pas kësaj fitore, turqit morën Krujën e më pas pushtuan dhe treva të tjera në veri të vendit.

Në këto situata të nderlikuara, një pjesë e popullatës të territoreve të pushtuara, për t'i shpëtuar reparaaljeve të barbarëve turqë, emigroi drejt Italisë.

Fluksi i parë i albanezëve ishin 60 familje nga Shkodra, Lezha, Durrësi, Mati, te cilat u vendosën në Venecia, Trieste dhe Istria.

Historiani Pietro P. Rodotà në veprën “*Dell'origine, progresso e stato del rito greco in Italia; vol 3, Roma 1775*” shkruan: “... *sulmet turke i tronditën albanezët, një pjesë e të cilëve, për t'i shpëtuar nënshtrimit dhe ndëshkimit të osmanëve, i braktisën trojet e veta dhe ikën ne Itali*”.

Ndër refugjatët e parë, që zbarkuan në brigjet italiane ne vitin 1396 janë 10 familje albaneze, të drejtuara nga Miko Dragovik. Këto familje u shpërndanë në Venecia (në fshatin Peroi), në Trieste dhe në Istria, ku u vendosen në komunat e Parenzo, Pola, Umago.

Në gjysmën e parë të shekullit XV, filloi emigrimi dhe nga trojet jugore arbërore. Tajani shkruan: “Në vitet 1399 - 1410, grupe familjesh albaneze, me në krye fisnikun Gjergj (Giorgio) Matranga, zbarkuan në Sicili dhe u vendosen ne trojet rreth Palermos.

Krahas impenjimit në punët bujqësore dhe me blegtori, një pjesë e burrave u vunë në shërbim të ushtrisë dhe te gardës te mbretit aragonez Martino (1399-1409)". (Shih: Tajani F. *Albanesi in Italia. Cosenza. Casa del Libro. 1969*).

#### **1413:**

Në muajin maj të vitit 1413, princi Gjon Kastrioti, i doli para ushtrisë turke e pas luftimesh të ashpra në fshatin Shkallë të Matit, ushtria albaneze u thye, duke lënë në fushën e betejës shumë të vrarë. Pasi morën kështjellën e Shkallës, hordhitë osmane i pushuan fshatrat për rreth, duke masakruar banorët, ndërsa disa grupe familjesh, që i shpëtuan reprazaljeve, zbritën në Durrës dhe me ndihmën e anijeve veneciane ikën në Siçili, Marke dhe Venecia.

Grupi i familjeve që shkoi në Siçili, u sistemua në trojet e komunës Mezzojuso.

#### **1444:**

Ushtarët e kapedanit Demetrio Reres, që i dërgoj Skënderbeu në ndihmë të Alfonsit V Aragona, u vendosën përgjithmonë me banim në Siçili dhe në Kalabri.

#### **1461:**

Reparti me 2800 kalorës, që shkuan në ndihmë të Mbretit Ferrante I Aragona i Napolit, nuk u kthyen në vendin e tyre, por qëndruan në Itali te shpërndarë në disa komuna në Pulia.

Në verën e vitit 1462, pas fitores të ushtrisë albaneze kundër aleatëve të kontit Orsini, në betejën pranë qytetit Troia në provincën e Foggia (Foxhia), mbreti Ferrante I e konsolidoi pushtetin dhe për të kompensuar kontributin e Skanderbeut, i dhuroi feudet e San Giovanni Rotondo, Monte Sant Angelo, Terni etj, të cilat nga ajo kohë janë prona të familjes Kastrioti.

Në këto komuna u vendosën kalorësit albaneze dhe disa pjestarë të familjes të Gjergj Kastrioti.

#### **1462– 1466:**

Në këto vite, një valë emigrantësh albanezë, zbarkoi në brigjet e Italisë, ku filluan një jetë të re. Familje të shumta u sistemuan në

Pulia e Molise, ku i dhanë jetë fshatrave Kampomarino, Kieuti, Kasalnuovo, Ururi, Faxhiano, Kazalvechio, Monteparano, Maliano, Shen Paolo, Portokanone, Santa Croce Montinjano, Shen Giorgio, Rokaforcata, Shen Marcano, Shen Martino, Sternaria, Zollino etj.

Nga 60 familje albaneze, që u vendosën në vitin 1462 në komunën Faxhiano në Pulja, në vitin 1545 u bënë 190 familje, ndërsa në vitin 1560, komuniteti arbëresh kishte 500 familje, madje me dekret mbretëror ishin përjashtuar nga taksa e oxhakut.

Si pasojë epidemive, luftërave dhe migrimit të brendshëm, në Faxhiano në vitin 1669, mbeten 123 familje arbëreshe. (*Monografia - Faggiano: "Primo casale albanese nel tarantino"; Taranto 1930*).

Albanezët, në keto troje të reja, sidomos aty ku u vendosën si fise e në grupe familjesh, i ruajtën traditat, besimin ortodoks, madje në shumë komuna, banorët ende flasin gjuhën e të parëve, arbërishten. Në vitin 1866, gjatë një vizite në Rokaforcata, një historian takoi një arbëreshe të moshuar e cila këndonte disa këngë në gjuhën shqipe dhe njera prej tyre ishte kënga e Shen Lazarit, të cilën pasi e degjoi disa herë, e transkriptoi dhe e botoi.

Këtë tekst këngë po e prezantoj në vazhdim:

*"O Zoti, madhe Zoti  
Se ka deka Lazarini  
E Zoti nenja gjender  
Vemmi Eklishi  
E shohu Lazarini  
E thirti Lazari ngridu  
E Lazari ngridi uperbissi  
neng pavi, neng favi  
neng keshi.*

Transkriptimi në shqipen e sotme:

*O Zot, i madhi Zot/Ka vdekur Lazari/E ti Zot nuk u gjende/Ne shkojme ne Kiseh/Te shohim Lazarin/E therrasim Lazar ngrihu/ Dhe Lazari u ngrijt ne gjunje/ Nuk shihte, nuk fliste, nuk qeshte/.*

**1467:**

Në këtë vit, ushtria turke pushtoi shumë treva, çka nxiti valën e tretë të emigrimit të albanezëve. Shumë fise e grupe familjesh lanë trojet arbërore dhe emigruan në Itali. Ky fluks migrator kryesisht familje fisnikësh dhe kushërinj të Skenderbeut, shkuan Siçili, ku u bashkuan me komunitetet albaneze, që ishin vendosur vite më parë në ishull. Kjo masë e madhe refugjatësh, u nda në grupe dhe sipas familjeve u vendosën në komunat Kontessa Entellina, Mezzojuso dhe Palazzo Adriano.

Për të garantuar jetesën në trojet e reja, shumica e albanezëve u impenjuan me punët bujqësore e me blegtori, ndërsa një pjesë hynë në shërbimin e milicisë të mbretit, ku krijuan repartet e stratiotëve jo vetëm në Itali, por dhe në Francë, Bohemi, San Marino etj.

Në fund të vitit 1467, ndër albanezet, që zbarkuan ne Sicili, ishin fisnikët: duka Pietro Emanuele Pravatà, duka Zakaria Groppa, duka Pietro Kuçia, duka Pal Mânsi, të cilët u sistemuan në pronat, që iu dhuroi mbreti Ferrante I i Napolit.

Familjet e Zakaria Groppa dhe e Giorgio Mirespia (Gjergj Mirëshpia) shkuan ne Palazzo Adriano; dhespoti Cernojeviç në Sant Angelo Muxaro, konti Elia Mullisi në Piana Albaneze, ndërsa kapedani Pal Mansi, u bashkua me bashkëvendasit e tij nga Kunavia, të vendosur vite më parë në feudin e Mezzojuso.

Populli italian u rezervoi pritje te përzemërti refugjatëve, që vinin nga Albania e martirizuar nga pushtuesit osmane. Kjo mikëpritje shprehte admirimin për heroizmin e këtij populli të vogël, që iu rezistoi dyndjeve osmane, por ishte dhe mirënjohje për ndihmën e madhe që Skenderbeu i dha dinastisë Aragoneze, ashtu si nuk duhet nënvleftësuar dhe fakti, se kjo mikpritje ishte një llogari politike e mbretërive të Spanjes, Napolit, Frances etj, të cilat kishin interesa t'i merrnin në shërbimin e tyre këta luftëtarë stratiotë të shquar.

**1468:**

Pas vdekjes të Gjergj Kastriotit, trojet arberore u pushtuan nga hordhite turke, qe provokuan eksodin e rreth i 300 000 albanezëve,

që braktisën trojet e tyre dhe u vendosën në provinca të ndryshme të Italisë, Francës dhe Spanjës.

Fillimisht, gjatë avancimit të ushtrisë osmane, popullata albaneze u ngjiti në zonat e thella malore, por repraaljet dhe masakrat e turqëve, një gjenocid mizor kundër albanezëve, e detyroi një pjesë të popullit tonë, të braktisi vendin dhe të emigroi drejt territoreve të Mbretërisë Aragoneze, por dhe në Milano, Torino, Firenze, Val D'Aosta, në San Maurizio, në Urbino, në Bolonja, në Venecia etj.

Grupe burrash të ngarkuar me teshat në kurriz, gra dhe femijë që qanin, të moshuar të rraspkapitur, të rrasur ngjeshur në stivat e anijeve veneciane, napolitane dhe albaneze, kapërcyen detin Adriatik dhe zbarkuan në brigjet italiane, ku gjetën një pritje miqësore, por një pjesë e madhe e tyre, do të vuanin një kalvar të dytë.

Të ndarë sipas fiseve, refugjatët albanezë u shpërndanë nëpër komuna te ndryshme në Pulja, Abruco, Kalabria, Sicilia, Toskana, Molisse, Bazilikata, Sicilia, Kampanja, Lazio, Toskana, Umbria, Lombardia, Venecia, San Marino etj.

Grupe familjesh albaneze, të shoqëruar nga priftërinjt dhe murgjër françeskanë të urdhërit minor, u sistemuan ne Trani, San Giovanni Rotondo dhe Monte Sant'Angelo, që ishin feudet e Gjergj Kastriotit, ndërsa Gjoni, i biri i Skenderbeut, fillimisht u vendos në kontenë e Galatina të Leçes. Një pjesë tjetër e emigranteve, u vendosën në Kapitanata të provincës së Foxhia, San Xhiakomo Skiavoni, Peskiçi, Monte Sant Anxhelo, Manfredonia, Kastellucio i Saurit, ndersa ata qe skuan ne Molise u vendosen ne Kampomarino, Portokanone, Grottaminarda, Ururi, Montecilfone etj.

Sipas dokumentave ne arkivin e Napolit, të gjitha këto komuna, në vitin 1483 banoheshin vetëm nga albanezët, të cilët flisnin gjuhën e tyre, hapën kishat e ritit ortodoks dhe ishin të përjashtuar nga taksa e oxhakut (fuoco). (*Fra Primaldo Cocco: Gli albanesi nel Tarantino. Revista "Roma e l'Oriente" 1919*).

Në fshatin Kazalvechio (Kasollet e Vjetra) në provincën e Foxhia, arbëreshët e ardhur me flukset e para emigraore, me urdhër të

mëkembësit të Mbretit të Napolit, u detyruan ta braktisin këtë qendër banimi dhe u vendosën në Kastelnuovo të Daunia.

Në vitin 1571, këtij komuniteti arbëreshësh iu njoh autonomia dhe tre vjet më pas, Kazalvechio u rindërtua dhe u ribanua nga arbëreshët dhe nga viti 1574 quhet Kasalvechio e Albanezëve.

Shumë familje albaneze në Kieuti dhe në disa komuna të tjera në Provincën e Foxhia, flasin gjuhën albaneze dhe në ditët e sotëme.

Sipas Giustiniani, emigracioni i albanezëve u intensifikua në vitet 1468 – 1506. Këto eksode të vazhdueshme janë pasqyruar në kengë të vjetra arbëreshe, ku në njëjërën prej tyre thuhet: “*Per tre qind mile trima iktin, çaitin detin, se të mbajën besën - treqind mijë trima, ikën e çanë detin, për të mbajtur besën.* (I.Mazziotti: *Immigrazione albanesi in Calabria nel XV secolo e la colonia di San Demetrio. Edizione: Il Coscile Castrovillari, 2004*).

Albanezët zbarkuan në një periudhë të vështirë për mbretërinë e Napolit, që ishte tronditur nga luftërat e brendëshme, nga epidemite e murtajes dhe nga kriza e rëndë ekonomike, që kishte çuar, në çpopullimin e disa fshatrave të Kampanjes dhe të Kalabrisë.

Një pjesë e familjeve albaneze u vendosën pikërisht në këto troje, shumicën e detyruan të vendosen në toka djerrë, në gryka malesh, në thellësi të kodrave dhe të maleve të pabanuara, ku ata me shumë mundime dhe sakrifica hapën toka të reja bujqësore, blenë bageti, ndërtuan shtëpitë dhe formuan qendra të reja banimi.

Krahas këtyre vështirësive ekonomike, komunitetit albanez u përball dhe me vështirësi sociale, kështu p.sh shpesh u konfliktuan me popullatën vendase, e cila duke mos e kuptuar gjuhën e të porsaardhurve, jo rrallë krijonin keqkuptime, që përfundonin dhe me grindje, deri në konflikte fizike në mes tyre.

Në krijimin e këtyre konflikteve, ndikoi dhe kleri katolik i dioqezave të këtyre trevave, të cilët me nxitjen e ipeshkëve, nuk e pranuan praktikimin e riteve ortodokse të albanezeve dhe jo vetëm kaq, por kleri i dioqezës të Acerenza, ndërmoi veprime jo humane dhe jokristiane, duke i ndaluar të kryenin varrimet me ceremoni

fetare ortodokse, madje filluan të bëjnë presione për t'i ripagëzuar fëmijet sipas ritit latin. (R. Di Fasanello: *D'amore di Ruffano, D. Baffa-Trasci Amalfitani, Di Crucoli, Santa Sofia – Rapporti con la Città di Bisignano. Edizione MIT, Cosenza 2009*).

Një ndër problemet e komunitetit albanez në Itali ishte shpërndarja dhe vendosje e familjev të veçuara, në rajonet veriore, si në Liguria, Lombardia, Piemonte, Emilia Romanja, Toskana dhe Val D'Aosta, të cilat me kalimin e viteve u asimiluan, shumica e harruan gjuhën e të pareve, por i ruajtën mbiemërat e origjinës, si p.sh në Toskana ka familje me mbiemëra tipike shqiptare: Makashi, Shini, Konxhiu, Pepi, Papa, Mansi, Vata, Vatimo, Renga, Mirako, Balla, Leti, Alcani, Guxholli, Bardi (Bardhi), Bala, Skura, Granai, Presta, Sinja, Geci, Damesi, Kalo, Korbi, Blini, Bitri, Çerri (Cerri) etj, etj.

Ndryshe ndodhi me emigrantët albanezë, që u vendosën në trojet jugore të Italisë. Përgjithësisht, ata u sistemuan së bashku, me fise e grupe familjesh, madje dhe në ditët e sotme, ka komuna të banuara nga shumica albanezë.

Vendbanimet me bashkësi albanezësh, ishin më të favorizuar të ruajnë e të forcojnë lidhjet mes tyre, te organizojnë jetën sipas rregullave dhe normave të vendit të origjinës, kesisoj ruajtën besimin ortodoks, hapën kisha te ritit otodoks, ku vendosën ikonat e marra nga kishat e vendeve te origjines, ruajtën gjuhën e atdheut, flisnin dhe ende vazhdojnë të flasin në dialektin arbëresh.

#### **1470 – 1477:**

Gjatë vitit 1470, drejt brigjeve Pulieze u dynd një valë tjetër refugjatësh albanezë, të cilët u pritën nga Geronimo Sansaverino, princi i Bisignano, i cili i sistemi në pronat e tij, pasi në vitet 1410-1451, ishin çpopulluar gati tërësisht nga vdekjet masive, të shkaktuara nga epidemia e murtajës, por dhe nga vdekjet nga zia e bukes, si pasojë e thatësirës së gjate në ato vite, që i dëmtoi rëndë prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

Në pritjen dhe sistemimin e këtij fluksi refugjatësh, u impenjua dukeshja Irina Kastrioti, stërmbesa e Skenderbeut, dukeshja e San



Pietro dhe Galatina, e cila ishte e martuar me Antonio Sansaverino, i biri i Princit Geronimo Sansaverino të Bisignano.

Në vitet 1467 – 1471, refugjatët albanezë u sistemuan në brigjet e Koriliano të Kalabria Citra, troje pothuaj të çpopulluara, ndërsa në këmbët e Shillës, albanezët u vendosën në San Demetrio (Shen Mitri), Makia, Shen Kozmai, Shen Sofia e Epirit, Vakaricio, Shen Giorgio – Albaneze, Karaffa dhe Spezzano Albaneze, një qendër banimi, që shtrihet pranë lumit Krati.

Në vitin 1471, familjet albaneze të sistemuara në San Demetrio Korone të provincës së Kozences, fituan të drejtën e pronësisë të trojeve dhe të shtëpive.

Ky sukses u arrit për merita të murgut arbëresh Paolo Greko, i cili më 3 nëntor 1471 i kërkoi noterit De Angelis, të hartonte aktet e regjistrimit të albanezëve dhe dhënien e tapive të pronësisë të tokave, që do të kultivonin.

San Demetrio është ndër qendrat kulturore më të rëndësishme të komunitetit arbëresh, që ka ruajtur gjuhën albaneze, ritin ortodoks, kostumet, doket e origjinës dhe traditat patriotike.

Në periudhën e sundimit të Ferdinandit IV Borbon, në komunën e San Demetrio u hap "Kolegji Italo-Albanez i Sant'Adriano" (1732-1794), institucion i rëndësishëm fetar e kulturor, i konsideruar fari i identitetit albanez.

Në vitin 1524, me urdhër të mbretit Karlit V, në San Demetrio u sistemua një grup refugjatësh arvanitas nga Korone e Mores.

Në fraksionin Macchia Albanese (Makia–Maqa) të San Demetrio, u lind Jeronim De Rada, figura më e shquar e kulturës dhe e patriotizmit arbëresh, shkrimtari dhe publicisti në përmasa europiane, themeluesi i letërsisë moderne albaneze - arbëreshe.

Në kodrinat në veri perëndim të Bisignano, në vitin 1471 refugjatët albanezë u vendosën në komunën San Sofia D'Epiro.

Nga 77 shtëpi që kishte në vitin e themelimit, me pas u bashkuan dhe banorët e fshatit Pedilati, kesisoj në vitin 1543 u zgjerua me 96 shtëpi arbëreshësh.

Në këtë komunë u vendosën albanezë nga fiset fisnike Mirako, Baffa-Trashi, Damesi, Beçi, Bujari etj.

### **1478 - 1479:**

Gjatë këtyre dy viteve ranë Kruja dhe Shkodra, dy qendrat e rezistencës heroike antiturke. Ushtria otomane, pasi i pushtoi dy qytetet, vrau me mijëra banorë të pafajshëm dhe për këtë fakt, historiografia shqiptare ende nuk po pronocohet, për të treguar përmasat e këtij gjenocidi të popullit tonë. Jo vetëm vranë shumë njerëz, por morën robër një pjesë të banorëve, që i dërguan skllëvër në Turqi.



Paolo Veronesi (1585): Kapidani Antonio Loredan, në luftimet e vitit 1479, për çlirimin e Shkodrës të rrethuar nga ushtria turke.

Pasi pushtuan Krujën (1478), ushtria osmane i masakroi të gjithë luftarët dhe banorët, që ishin në kështjellën e Krujës dhe shumë pak nga ata që i shpëtuan reprazaljeve dhe një pjesë e vogël e ushtarëve milanezë, napolitanë dhe artilierët gjermanë, me shumë vështirësi, arrijtën në Kepin e Rodonit, ku i hypën anijeve veneciane dhe zbarkuan në brigjet italiane.

Në vitin 1479 ra Shkodra, bastioni i fundit i rezistencës heroike kundër hordhive osmane.

Më 25 janar 1479, në Stamboll u nënshkrua paqa Turko-Venedikase dhe nga kjo marreveshje, mbrojtësit e Shkodrës fituan të drejtën të largoheshin me armët dhe pasuritë e tyre.

Rreth 2500 luftëtarët dhe banorët, që i shpëtuan masakrave të ushtrisë otomane, hypën në anijet veneciane, që ishin ankoruar në molin e lumit të Bunës dhe emigruan në Venecia.

Mbrojtja heroike e Shkodres, është përjetësuar në shumë kronika dhe në një varg veprash letrare, ndër të cilat mbishquhet Marin Barleci me veprën “Rrethimi i Shkodrës”, piktori Vittorio Karpaçi, me bazorilievin “Rrethimi i Shkodrës”, i vendosur në fasadën e shkollës së pikturës Shen Maria e Albanezëve ne Venecia, si dhe Paolo Veronesi me afreskun “Qendresa e Shkodrës”, që ndodhet në Sallën e Këshillit të Madh të Dozhëve të Venedikut.



Vittorio Carpacci: Bazorilievi “Rrethimi i Shkodres”, i vendosur në fasadën e shkollës të Albanezëve, në rrugicën Piovan në Shen Mauricio – Venecia.

Në Venecia, shkodranët gjetën mjedis të favorshëm, për të shprehur kulturën arbërore, që i lejoi të integrohen denjësisht në rinashimenton italiane dhe europiane, ndër të cilët u shquan humanistët Gjon Gazulli, Pal Gazulli, Andrea Gazulli, Mikel Marullo, Marin Barleci, Nikolla Tomeo, Mikele Artisti, Mikele Greçi etj.

Në këtë grup albanezësh të shquar, bënin pjesë piktorët dhe skulptorët Andrea Aleksi, Viktor Karpaçi, Mark Bazati etj, të njohur në historinë e artit, si krijuesit e shkollës albaneze të pikturës.



Emigrimi i shkodraneve, pas pushtimit turk.  
(miniature e Franc Juca - 1690)

### **1480:**

Në vitin 1480, Sulltan Mehmetit II – Fatihu, urdhëroi sulmin kundër Romës. Me 281 anije, dhjetra mijëra ushtarë turq zbarkuan në lokalitetin Roka të Otrantos, ku banonin edhe një grup i madh familjesh albaneze. Hordhitë turke sulmuan me egërsi, vranë, dogjën e shkatërruan gjithëçka që gjenin përpara.

Pas një rezistence të mundueshme, 400 ushtarët dhe banorët e Roko, u strehuan në kështjellën e Otrantos dhe nuk pranuan t'i dorëzohen pashait turk.

Pas dy javë luftimesh, artileria turke i shembi muret, e pushtoi kështjellën dhe i masakroi të gjithë banorët arbëreshë dhe italianë.

Me 28 gusht 1480, barbarët turq, kryen një masakër të tmerreshme, iu prenë kokat 813 robërve italiane dhe arbëreshë.

Skeletet e martirëve të masakrës të Otrantos, ruhen në katedralen Santa Maria Annunziata të Otrantos.

## 1481:

Eksodi masiv, i organizuar nga Princi Gjon Kastrioti, së bashkëu me Republikën e Venecias. Me mijëra albanezë, pas një lundrimi të gjatë e të mundueshëm, zbarkuan në Napoli.



Refugjatë albanezë nga Parga, që zbarkuan në Pulja.  
Pikturë e vitit 1826 e Françesko Hayez.

## 1482 – 1492:

Familje albanezësh nga Çamëria dhe Himara, zbarkuan në Salento dhe në Siçili. Ata që u vendosën në Salento, përballuan sulmet dhe reprazaljet e ushtrisë turke, që vazhdonin të sulmonin qytetet bregdetare të Puljas.

Në këto rrethana, një pjesë e albanezëve u detyruan të ikin e të shkojnë në Siçili. Pas një udhëtimi të gjatë, arrijtën në komunën e Monreal ku u pritën nga ipeshkëvi Imzot Nikolao Trullenki, i cili u dha refugjateve feudet e Merco (Merko) dhe Daydingli në Palermo.

Në vitet 1482 – 1483 bëri dimër i egër, kështu himarjotët dhe çamët, që ishin vendosur në shpatet e malit Pizzuta (Picuta), u detyruan të zbresin në luginë, në pllajtat dhe kodrinat, ku ndërtuan shtëpitë dhe themeluan komunën e famëshme Piana degli Albanesi.

Disa familje të tjera, të fisnikëve Janni Barbati, Gjergj Gulemi, Janni Skirò, Janni Mankaluzi, Tomaso Thani, Gjon Borshi, Mateo Masa, Teodor Dragoti, Gjergj Barleci, Jani Thaminiti dhe familjet Muzaka, Mansi dhe Mazi, u shpërndanë në feudet Bronto, Mezzojuso, Sant' Angelo e San Mikele. (Raffaele P. A. Patitario: *Casati albanesi in Calabria e Sicilia*. Rivista Storica Calabrese: N.S. X-XI 1989 -1990 NN 1-4).

Avancimi i hordhive turke ne Ballkan vazhdonte pandërprerje, duke pushtuar territore të gjera dhe të Greqisë, ndër ato shumë vendbanime arvanitase.

Në 1470 pushtuan ishullin Negroponte, më 1472 Vonizza, më 1479 dy fortesat Zarnata e Maina, më 1479 Navarino dhe Lepanto. Rënia e këtyre qyteteve u shoqërua me emigrime masive të arvanitasve dhe grekëve drejt Italisë. (C Ciampi: *Le sedi dei greci arvaniti*. Rivista Geografica Italiana: XCII. 2, Giugno 1985).

### **1503:**

Pas dështimit të kryengritjes së përgjithëshme të viteve 1501 – 1503, të udhëhequr nga Princi Gjergji II Kastrioti (nipi i Skenderbeut) dhe nga konti Progon Dukagjini, shumë familje albaneze emigruan në Itali.

Progon Dukagjini pranoi të hyjë në shërbim të Sulltanit, i cili e emëroi sanxhakbej, ndërsa Gjergji II Kastrioti dhe një grup të vogël albanezësh, fillimisht u kthye ne Itali e me pas, Ai se bashku me gruan shkoi në Qipro.

### **1500 - 1540:**

Arvanitasit dhe grekët e Korone dhe të Modone, dy qytetet më të rëndësishme të Moresë, të frikësuar nga lajmet e masakrave, që kryen turqit ndaj popullatës në Zante, vendosën t'ia dorëzojnë qytetin Sulltan Bajzitet II, i cili më 9 gusht 1500 e pushtoi pa rezistencë. Vendimi për t'iu dorëzuar turqëve pa luftë, nuk i favorizoi banorët e këtyre dy qyteteve. Të ndodhur para presioneve dhe persekutimeve të vazhdueshme të turqeve, shumë familje arvanitase dhe greke, të udhëhequr nga arvanitasi Mark Militani emigruan drejt Italisë.

Grupet e para të refugjatëve u vendosën në komunën Kaxhiano (Caggiano-Salerno). Trojet e kësaj komune dikur ishin feud i Luigi Gesualdo, por si pjesëmarres në komplotin e baroneve kunder mbretit Ferdinadit II Aragona, pronat iu sekuesiruan dhe iu dhanë arbëreshëve të Xhiakomo Karaçiolos dhe më pas arvanitasve, që arrijtën nga Korone.

Komuniteti i albanezeve në Kaxhiano u zgjerua dhe u forcua, madje në vitin 1595, familjet arbëreshe, u përjashtuan nga taksa e zjarrit (*Archivio di Stato di Napoli: Proc R. Cam. Nr 1251, vol 134*).

Pas Korone dhe Modone, në vitet 1533 – 1540 ranë njeri pas tjetrit qytetet greke Egina, Malvasia, Naupalia, Skutari dhe Patrassa në Morè.

Pushtuesit turq edhe në këto qytete vazhduan me persekutime dhe masakra, andaj shumë familje arvanite dhe greke, i kërkuan Papes dhe perandorit Karlit V, të ndihmonin për shpëtimin e tyre.

Sipas relacioneve të Giustiniani, në vitet e pushtetit të Perandorit Karli V, drejt Italisë vërshuan shumë familje arvanite dhe greke, mes tyre dhe pjestarë të familjeve mbretërore bizantine Laskari dhe Paleologu, që ishin zotër të shumë feudeve të Moresë, të banuara masivisht nga arvanitasit.

Në vitin 1533, me ndërhyrjen e Papës Klementi VII dhe të Urdhërit Kavalierët e Shen Gjonit të Jerusalemit, perandori Karli V, vuri në dispozicion 200 anije tregtare, për të ndihmuar largimin e arvanitasve dhe të grekeve drejt Italisë.

Mëkëmbësi i Mbretit, Pietro da Toledo, urdhëroi admiralin Andrea Doria, të transportonte familjet arvanite dhe greke për në Napoli. Një pjesë e këtyre refugjatëve u sistemuan në Napoli, por shumica shkuan në Kalabri dhe Siçili, në komunat e banuara nga albanezët, të vendosur aty vite më parë.

Arvanitasit e Korone, të udhëhequr nga kapidani arvanit Lazaro Mathes, themeluan fshatrat Barile, San Kostantino Albanese, San Paolo Albanese, Ginestra, Maschito (në Potencia); Castroregio (Kastrorexhio) dhe Farneta (në provincën e Kozences); Greci (Avellino),

San Xhiakomo, ndërsa një grup familjesh shkuan në ishullin Giglio (Xhilio) në Toskana, ne Livorno dhe Pistoja.

Sipas shumë historianëve, qëllimi i pranimit të emigrantëve albanezë në trojet e mbretërisë së Napolit, inspirohej dhe nga qëllimi për t'i rekrutuar burrat në repartet e famëshme të stratioteve, që u shkuan në luftimet në Itali, France, Bohemi, Dalmaci, Spanje etj.

Bashkë me banorët, në anijet e admiralit Andrea Doria ishin edhe Ipushkevi orotodoks i Korone hirësia Benedetti, ipushkevi i Modone hirësia Gerasimo, ipushkevi Monemvasia hiresia Makario, si dhe familje tregëtarësh e fisnikësh albanezë dhe grekë.

Shume luftetarë arvanitas nga Korone dhe albanezët nga Himara, u mobilizuan në gardën e oborrit të mbretërisë së Napolit, madje u paguhej rrogë e mirë dhe shumë prej tyre janë shkruar në “Librin e artë të patricëve”, mes tyre edhe stërgjyshi i Antonio Gramshit.

Stratiotëve albaneze u lejohej të mbanin armët, madje kishin të drejtë të hynin të armatosur në apartamentin e princit dhe konsideroheshin “le lance spezzate del re di Spagna”.

### **1552:**

Grupe familjesh albaneze, zbarkuan në Pulja dhe u shperndanë në feudet e Rignano (Rinjano), Lesina, Guglionisi (Gulionizi), Ischitella (Iskitella), Carpino (Karpino), Bari, Civitate, San Martino, Foggia (Foxhia), Vico Garganico (Viko Garganiko), Ruvo, Larino, Apricena, Pescchici (Peskiçi), Monopoli, Manfredonia, Cassano di Acquaviva (Kasano Akuaviva), Casamassima (Kazamassima), Gioia (Xhioia), Toritto, Bitetto, Palo, Giovinazzo, Bisceglie (Bishelie), Molfetta, Andria, Barletta, Terlizzi e Bitonto. (*Palumbo Manfredi: I comuni Meridionali, Montecorvino Rovella: 1910*).

Historiani Bernardino Biondelli ne vepren: “*Prospetto topografico-statistico delle colonie straniere d'Italia*”: *Annuario geografico italiano, pubblicato dall'ufficio di corrispondenza geografica in Bologna. Libreria Rusconi, 1845* shkruan: “Në disa qendra banimi si Portocannone (Portokanone), Ururi, Chieuti (Kieuti); Campomarino (Kampomarino), Santa Croce di Greci, Montelongo, Canore



(Kanore) etj, banorët flisnin vetëm gjuhën albaneze, madje dhe në kishë, ritet liturgjike dhe meshën e zhvillonin në gjuhën albaneze”.

**1647 – 1664:**

Eksodi i arvanitëve dhe i grekëve nga Maina, të cilët u transportuan nga anijet veneciane. Pjesa më e madhe zbarkuan ne Livorno, një pjesë në Volterra, ndërsa 700 emigrantë shkuan në Korsikë.

**1691 – 1750:**

Në vitin 1691, ipeshkevi i Palermos Imzot Ferdinando Bazan, sistemoi shumë familje refugjatësh albanezë në feudin e Santa Cristina (Shen Kristina) dhe Gela (Xhela), ndërsa 82 albanezë i dergoi në Piana degli Albaneze (Hora Arbereshe).

Albanezët punonin tokat e Ipeshkevisë të Palermos dhe të Dukës së Gela (Xhela), por me që keto toka ishin larg qëndrave të banimit të Piana Albaneze, arbëreshët, filluan të ndërtonin shtëpitë e veta prane dhe rreth vendeve të punës. Në vitet e më pasme, me ardhjen e arvanitëve nga Morea, kjo qendër banimi u zgjerua dhe u organizua në komunë autonome me emërin Santa Cristina Gela (Shen Kristina e Xhela).

**1743:**

Me 4 mars 1743, një grup familjesh himariote dhe çame, arrijnë në Pulja dhe me urdhër të mbretit Alfonsi III Borbon, u sistemuan dhe themeluan Villa Badesse, ne provincen e Peskares – Abruco. Një grup prej 18 familjesh ishin me origjinë nga Piqerasi, ndërsa të tjerat nga Lukova, Kudhesi, Shen Vasili dhe Çameria.

Së bashku me keta familjes ishin dy prifterinj ortodoksë, që iu dedikuan jetës shpirtërore të ketyre banorëve të rinj.

Si shkruhet në enciklopeditë italiane te vjetra dhe aktuale, arbëreshët e Villa Badesse, e kane ruajtur kulturën etnike, ritin ortodoks veshjet, doket dhe gjuhën albaneze.

**1774:**

Gjatë këtij viti, grupe të shumta familjesh albaneze, zbarkuan në Brindisi di Monatgna - Bazilikata, ndërsa një grup me rreth 70 persona, shkuan dhe u vendosen në Viterbo, në veri të Romës.

Kur arrijtën në Brindisi di Montagna, grupi i refugjatëve albanezë, u bashkua me grupin e arbëresheve, që jetonin në këtë feud, që nga viti 1536, kur i priti dukeshja Irena Kastriotit, gruaja e princit Pietro Antonio IV dei Sanseverino di Bisignano.

Perpos ketyre eksodeve dhe gjatë shekujve XIX, vazhduan zbarkimet, kryesisht në grupe familjesh, që lundronin drejt brigjeve italiane, me ndihmën e anijeve veneciane dhe albaneze.

Sejcili nga këto eksode, përbën histori me vehte, e pamundur të trajtohen në një shkrim, andaj në vazhdim të këtyre kronikave, do të tregoj historinë e grupit të emigrantëve albanezë, që zbarkuan në Itali me kapedanin Demetrius Reres dhe për fluksin e refugjatëve albanezë te vitit 1481, të organizuar nga Gjon Kastrioti, i biri i Gjergj Kastriotit - Skenderbeu.

## EMIGRIMI I ALBANEZËVE NË VITET 1413 - 1444.

Ernesto Skirò (Schirò), në studimin “*Origine degli insediamenti albanesi in Italia-Origjina e vendbanimeve të albanezëve në Itali*” – Palermo 2009, përshkruan disa nga flukset emigratore të albanezëve, që fillimisht u vendosën me banim në Siçili.

Rreth këtij libri, me 12 qershor 2009, në Palermo u organizua një “tavolinë e rrumbullakët”, e ideuar dhe e drejtuar nga arbereshët dr. Romanjoli dhe Papas Vito Stassi.

Ky aktivitet u zhvillua, pas festës të Pentekoste, që kremtohet më 31 maj, që sipas liturgjisë orientale, është dita e përkujtimit të vdekurve, por për arbëreshët, evokon dy ngjarje të dhimbëshme, thyerjen e ushtrisë të Princit Gjon Kastrioti më 1413 dhe pushtimin Kostaninopolit nga otomanet.

Festimi i Pentekoste më 31 maj, lidhet me ngjarjen tragjike të vitit 1413, kur ushtria e Gjon Kastrioti u thye në Shkallë të Matit dhe ku u detyrua t’i dërgoi djemtë peng në oborrin e sulltanit, pra si kuptohet Gjergj Kastrioti ishte 9 vjeç kur shkoi në Stamboll.

Shumë luftëtarë mbetën të vararë në fushën e betejës, shumë banorë u masakruan nga pushtuesit turq, një pjesë u morën rob dhe u dërguan në Turqi.

Kjo ngjarje ka mbetur e pashlyer në memorien e arbëreshëve të komunës të Mezzojuso, që e kujtojnë me shprehjen: “*Është e bukur të kremtohen të gjitha festat, por e shtuna e Shkallës (Scialla), mos ardh të kurrë!*”

Kjo shprehje mallkimi, i referohet të shtunës të 31 maj 1413, ditës të Pentekoste, kur pas luftimesh të ashpra në fshatin Shkallë të Matit, ushtria e Princit Gjon Kastrioti u thye nga hordhitë turke, çka shënoi fillimin e dominimit otoman në Mat.

Një pjesë e popullatës, që i shpëtoi reprazalieve turke, në vitin 1413 emigroi në Itali dhe u vendosen në troje të çpopulluara të Siçilisë, si në komunën e Mezzojuso dhe në disa komuna në Kalabri. Për arbëreshët e Mezzojuso, e shtuna e Pentekoste është dita, që

evokon dhe këtë ngjarje të dhimbëshme të lidhur me atdheun, që u detyruan ta braktisin e të emigrojnë në Siçili.

Arbëreshët e Mezzojuso, prej 603 vite, ditën e shtunë të Pentekoste mblidhen në katedrale, ku mbahet mesha në kujtim dhe nderim të martirëve të betejës në Shkallë të Matit.



Në mjediset e ndërtesës të Komunës të Mezzojuso, është ky afresk i vitit 1525, ku paraqitet Mezzojuso në këmbët e dy kodrave, më e larta Brinja (Brigna) dhe më e ulëta quhet Dirrachion (Durrësi).



Fotografi aktuale e Mezzojuso, nën dy kodrat Brinja dhe Durrësi.

Pas meshës, pasdite në perëndim të diellit, korteu i banoreve te Mezzojuso, ngjitet në majën e dy kodrave qe aktualisht quhen Brigna (Brinja) dhe Dirrachion (Durrësi) dhe me fytyrat e kthyer nga lindja, këndojnë së bashku këngën e famëshme “O e bukura Morè”, një këngë krenarie kombëtare, këngë malli e trishtimi, këngë vuajtje e dashurie përvëlimgtare për atdheun.

Grupi i parë i albanezëve, arrijti në Siçili në vitin 1413, grupi i dytë në vitet 145 – 1440, ndërsa në vitet 1444 – 1448, u bashkua një grup tjetër, i përbërë nga tre reparte kalorësish, të komanduar nga kapidani Demetrio Reres.

Ky emigracion lidhet me dy rrethana politike të kohës:

- Së pari u diktua nga dyndjet otomane, që pasi i pushtuan trojet albaneze, e masakruan popullaten, kryen gjenocidin e albanezëve, si dhe morën robër, që i dërguan në Turqi si skllëvër, ndërsa ata që i shpëtuan reprazaljeve morën rrugën e emigrimit drejt Italisë
- Së dyti, lidhet me konfliktet e brendëshme në mbretërine e Napolit, te nxitura nga revolta e baronëve kalabrezë, që u ngritën kundër Alfonsit V Aragona, mbretit të Napolit dhe Siçilisë, i quajhuri Magnanimo (fisniku shpirtmirë).

Ky rrebelimi i baronëve u nxit nga Anzhuinët dhe u organizua nga Markezi Antonio Centelles, që ishte dhe mëkëmbës i mbretit për Kalabrinë. Këto konflikte të brendëshme e destabilizuan situatën në Kalabri, por mbreti Alfonso V Aragona, ishte i pafuqishëm, për ta shuar revoltën, andaj i kërkoi ndihmë Gjergj Kastriotit.

Në vitin 1444, Skenderbeu iu përgjigj kërkesës të mbretit Alfonso V, duke i dërguar repartet me 200 kalorës, të komanduara nga kapedani Demetrius Reres, me dy djemtë e tij Gjergji dhe Vasil Reres, të cilët udhëhoqën luftimet dhe triumfuan kundër koalicionit të baronëve kalabrezë proanzhuinë.

Nuk ka të dhëna nga cila trevë ishte origjina e Demetrio Reres dhe e as kalorësve albanezë.

Sipas dokumentave Veneciane mbiemëri ishte Renes o Renessi dhe Demetri ishte kapedan në rradhët e ushtrisë albaneze, i shquar

në luftimet kundër sulmeve të ushtrisë turke. (Domenico Zangari: *Le colonie albanesi in Calabria: Storia e demografia nei secoli XV-XIX. Editore Caselli, Napoli 1941. XIX*).

Johann Georg Von Hahn (1854), duke iu referuar historianit italian Biondelli, shkruan se emëri i kapedanit ishte Demetrius Reres Castriota dhe ishte kushëri i Gjergj Kastriotit – Skenderbeut, por ky opinion ka mbetur i pa konfirmuar. (Johann Georg Von Hahn 1854: *Geographischethnographische Uebersicht. Sind die Albanesen Autochthonen? Alphabet. Historisches. Verlag von Friedrich Mauke*).

Repartet e kalorësve albanezë të Demetrio Reres, pasi zbarkuan në Siçili, u vendosën në kështjellën e vjetër saraçene të Bizyr (sot quhet Bisiri), e ngritur në majën e një kodre, mbi fshatin e vogël Mazzaresë, në krah të djathtë të lumit Mazzaro, 10 km larg nga grykëderdhja e lumit në detin Mesdhe.

Kapedan Demetrio, në krye të kalorësve albanezë, i sulmoi dhe i theu njeri pas tjetrit baronët kalabrezë, të ngritur kundër mbretit. Pas këtyre fitoreve reparti i kalorësve albanezë, u ngarkua me detyra të mbanin rendin publik dhe të mbronin bregdetin perëndimor të Siçilisë, si nga sulmet e flotës osmane, ashtu dhe nga sulmet e rastit, që mund të ndërmerrenin përkrahësit e anzhvineve.

Në vazhdim të fitoreve, Demetrio Reres, në krye të kalorësve albanezë dhe të reparteve të mbretit, i dha goditjen përfundimtare forcave të markezit Antonio Centelles dhe në shkurt të vitit 1445, e arrestoi markezin Centelles, të cilin ia dorezoi mbretit Alfonso V.

Pas kësaj fitoreje, kalorësit albanezë qëndruan dhe dy vjet të tjera në kështjellën e Bizyr dhe ndonëse nuk u impenjuan në luftime, ata kryen funksione të rëndësishme civile dhe sidomos në mbajtjen e rendit publik.

Ne mbyllje të konfliktit, mbreti Alfonso V i Napolit i konfiskoi pronat e markezit Antonio Centelles, dhe me akte të rregullta notarile ua dhuroi ushtarëve albanezë, kesisoj albanezët fituan të drejtën e pronësisë, të tokave, livadheve, pyjeve dhe shtëpive.

Në vitin 1445, disa grupe kalorësish të kapedanit Demetrio Reres u vendosën në trojet e Kortone, Katanzaro dhe Belkastro, fshatra të çpopulluara nga banorët vendas, si pasojë e vdekjeve masive pas epidemive të kolerës dhe murtajës.

Banorët e rinj albanezë, pasi i sistemuan tokat bujqësore, blenë dhe bagëti, kësisoj filluan jetën e re në këto troje siçiliane.

Këto vendbanime të herëshme me albanezë, dokumentohen në relacionet e Lorenzo Giustiniani, i cili në fillimet e viteve '800 ia dorëzoi Miliorinit, ministri i Drejtësisë i Mbretërisë të Napolit, për ta informuar rreth pronave që kishin albanezët në këto troje.

Si tregohet në relacionet, prezenca e kalorësve albanezë, u mirëprit nga feudalët e vegjël kalabrezë, që u ndjenë të sigurtë, pasi vetë nuk ishin në gjendje t'i mbronin pronat nga sulmet, nga grabitjet dhe shkatërrimet, e krijuar nga konfliktet e vazhdueshme nga forcat e baronëve.

Kontributi i kalorësve albanezë, ishte vendimtar për normalizimin e jetës shoqërore, ekonomike, bujqësore dhe ushtarake në rajonin e Kalabrisë, andaj mbreti Alfonso V Aragona i Napolit, në vitin 1448 e emëroi Demetrio Reres guvernator i Provincës të Kalabrisë.

Kontributi i kapedanit Demetrio Reres, u vlerësua nga fisnikët dhe nga populli kalabrez dhe në nderim të veprës së tij, në komunën San Nicola Dell'Alto (Shën Nikolla e Sipërme) në Krotone të Kalabrisë, një nga rrugët kryesore mban emërin e tij: Via DEMETRIO RERES.

Në vitin 1450, përfundoi misioni ushtarak i forcave albaneze në Kalabri. Në këto rrethana, një pjesë e kalorësve u transferuan në malet përtej lumit Belice, në bregun e Siçilisë jugore, në pritje për t'u riatdhësuar, por ndryshuan mendim dhe një pjesë qëndruan në Siçili, ndërsa disa të tjerë u vendosën në Kalabrinë jugore.

Bartolomeo Facio, në veprën: "*De rebus gestis ab Alphonso I*", botuar më 1562, shkruan: "*Quo tempore Scanderbecus nobilis in Epiro Regulus ac magnae et spectatae virtutis adversus Tureos, a quibus obsidebatur, ad Alphonsum legatos auxilium oratum misit*",

pra për të shpërblyer ndihmën e ushtarëve të Skenderbeut, që luftuan dhe e thyen revoltën e baronëve, mbreti Alfonsi, vendosi t'i dhuroi troje në Siçili dhe në Kalabri, ku shumica e këtyre ushtarëve ripopulluan komunat Piana degli Albanesi, Contessa Entellina (quhet dhe Kundës-Kudhësi), Santa Cristina Gela, Palazzo Adriano, Bronte, Mezzojuso, Biancavilla, San Michele, San Giuseppe di Mastellaro, Sant'Angelo, Taormina (në Sicilia); Caraffa di Catanzaro (Karafa), Carfizzi (Karfici), Gizzeria (Xhixeria), Pallagorio, Vena, San Nicola dell' Alto, Amato, Arietta, Andali, Belvedere, Marcedusa, Zagarise e Zangarona (në Kalabri, në provincën e Katanzaro) etj.

Krahas këtyre vendbanimeve të para, , eksodet e tjera në vitet 1461 – 1503, u shprehën me ardhjen e shumë familjeve të tjera albaneze, që u shpërndanë në 35 komuna, që aktualisht banojnë kryesisht me arbëreshë, ku flitet gjuha shqipe në dialektin arbëresh. (Raffaele Patitucci D'Alfiera Patitario: *Casati Albanesi in Calabria e Sicilia. Rivista Storica Calabrese: N. S. Nr. 4; X-XI: 1989 – 1999*).

Sipas historianit I. Mazziotti, shtrirja gjeografike e vendbanimeve albaneze, nga Karfici, në San Pellegrino e San Nikola Dell'Alto, nga Marcedusa, Andali e Zangarona dhe zbritja në formë harku deri në Gizzeria pranë bregut të detit Tirren, të bëjnë të mendosh se këto qendra banimi, u populluan nga albanezët, sipas një plani strategjik të Demetrio Reres, për ta vënë nën kontroll ushtarak terrenin, për të survejuar qëndrimin e baronëve dhe për të shtypur çdo formë revolte.

Familja e Demetrio Reres dhe e të dy djemëve të tij, u vendos në komunën e Mezzojuso, në një feud të bukur pranë një burimi uji, në anën tjetër të humnerës Salto, afër kishës normane Shën Maria Mëshirmadhe.

Në këtë lëndinë të bukur, Demetrio ndërtoi shtëpitë për familjen dhe për djemtë.

Kalorësit albaneze, që u vendosën në komunat e Siçilisë dhe të Kalabrisë, me që dispononin burime financiare, të fituara për shërbimet që kryen për mbretin Alfonso V, në vitet në vazhdim, blenë shtëpia, toka dhe bageti, duke iu dedikuar me përparësi blegtorisë,



pasi trojet e dhuruara nga mbreti, ishin të pasura me kullota mes pyjeve, të ngjashme me ato të fshatrave të origjinës, ku dikur ata ishin dalluar si blegtorë.

Pjesa më e madhe e kalorësve albanezë, morën familjet e veta nga Albania, ndërsa të tjerë krijuan familje me vajzat vendase.

Shumica e albanezëve iu dedikuan blegtorisë, por kur ishte e nevojëshme, merrnin armët për mbrojtjen e pronave dhe trojeve të komunës. (Robert Elsie: *19 March 2010. Historical Dictionary of Albania*. Scarecrow Press. ISBN 978-0-8108-7380-3. Retrieved 10 June 2013).

Në fakt kalorësit e Demetrio Reres, janë grupi i dytë i albanezëve të vendosur në trojet e Siçilisë dhe Kalabrisë, madje këto banorë të rinj, administrata mbretërore i pajisi me një autorizim të rregullt pronësie, të quajtur "*Licenti populandi*" (leje banimi), të shoqëruar me aktin e noterit, që ligjeronte të drejtën e pronës të tokave bujqësore, të livadheve, zabelave dhe pyjeve.

Prej rreth 550 vite, arbëreshët janë pronarë të trojeve ku banojnë.

Djemtë e Demetrio, Gjergji dhe Vasil Rere, u shquan si strategë ushtarakë dhe vazhduan të mbanin komandën e kavalerisë dhe rekrutuan shumë albanezë duke krijuar reparte stratiotësh, të cilët, si shkruan Paolo Petta, në vitet e më pasme u shtuan dhe shërbyen në rajone të tjera të Italisë (Venecia, Milano, Firenze, Val D'Aosta etj), në Francë, Spanjë, Fiandra, Bohemia, Dalamacia, San Marino etj. (Dott. Paolo Petta: *Stradioti – soldati albanesi in Italia durante secoli XV – XVIII*).

Demetrio Reres dhe sidomos djemtë e tij, kanë dhënë një kontribut të madh në krijimin e reparteve të stratiotëve albanezë, që u shquan si luftëtarë trima në vitet 1450 – 1500, madje kjo tradite vazhdoi dhe në vitet e më vonëshme deri në fillim të shekullit XIX.

Një ndër komandantët stratiotë në shërbim të dukës së Mantoves dhe të Republikës të Vendikut, ishte Gjergji II Kastrioti, i biri i Gjon Kastriotit, nipi i Gjergj Kastriotit, i cili pas vitit 1495, bashkë me 400 stratiotë nga Morea, Durresi dhe Shkodra, kaloi në shërbim të

mbretit të Frances Karli VIII. Ky repart stratiotësh, u shquan ne luftimet, sa i quajtën “*Coupiés neuves*” (kositesit e rinj).

Mbreti Karli VIII, i kenaqur me kontributin e Gjergj II Kastrioti, i dha ne dispozicion shumë kalorës të tjerë dhe e emëroi komandant i 1000 kalorësve të ushtrisë franceze.

Stratitët albanezë shkonin në luftë duke kënduar hymnin e tyre luftarak: “*Nu la sèmo de Albania/Strattioti palikari/ kie in cavallo, in terra, in mari/non stimemo la Turchia*”

Teksti i transkriptuar: “*Ne jemi nga Albania/stratitë heronj me famë/mbi kuaj, në tokë e ne det/nuk trembemi nga Tuqia*”.

Në kronikat e mesjetës (shekujt XV – XVIII), thuhet se albanezët nuk ishin ushtarë të çthurur, as varfanjakë, përkundrazi ishin kalorës trima, të rregullt dhe të bindur ndaj komandantëve.

Në shekujt XVI – XVIII, repartet stratitote shquheshin në Europë. Stratitët albaneze, në kohën e mbretit Louis II, formuan kalorësinë e lehtë franceze, e quajtur nga historianët francezë të artit luftarak “*chevalerie albanoise - kalorësia shqiptare*”.

Në vitin 1495, mbreti i Francës Karli VIII, me repartet stratitote te komanduar nga Gjergj II Kastriotin dhe Kostantin Arianitin, zbritën në Bari, për të organizuar kryqezatën kundër turqëve, por per fat te keq, kjo nisme deshtoi.



Duka Antonio Fernandino Kastrioti, – medaljon i vitit 1549.

Në mesin e shekullit XVI, nga familja fisnike e Kastriotëve, u shqua komandanti stratiot, duka Antonio Fernando Kastrioti.

Në vitin 1628, permendet stratioti Buzikio Renesi, feudatari i Rokaforzata dhe i San Martino, i cili shkoi në Milano në shërbim të mbretit Filipi III.

Bashkë me fisnikun Buzikio Renesi (Reres), ishin dhe stratiotët nga komuna arbëreshe e Faxhiano, ndër të cilët Dimiter Balza, Giorgio Fadati, Pietro Skura, Giorgio Skura, Kola Renesi, Pietro Pindao, Giovanni Traggina, Demetrio Krescia (Kreshia), Demetrio Gimata (Xhimata), Giorgio Kuedikano etj.

Shumë familje arbëreshe në Faxhiano, ende ruajnë ushtat, shpatat, kamat, veshjet dhe armaturat e këtyre stratiotëve të shquar në historinë arbëreshe në Itali.

Miku im, shkrimtari, poeti dhe publicisti Luan Rama, në shkrimin *“Da Vinçi, stratiotët shqiptarë dhe mbreti francez François I”*, tregon se Leonardo Da Vinçi, i admironte stratiotët albanezë, andaj shpesh organizonte mjeshtërisht spektakle në përkujtim të betejës së Marignano pranë Amboise.

Në këto spektakle, krahas mbretit, princërve, dukëve, ambasadorëve, ishin të pranishëm dhe stratiotët albanezë, ata të cilët, të udhëhequr nga kapedani albanez Mërkur Bua Shpata, në mëngjesin e 15 shtatorit 1515, fituan betejën e Marignano.

Leonardo da Vinci i njihte stratiotët në luftën kundër francezëve e herë pro tyre: i njihte nga mbreti Charles VIII, i cili së bashku me kapedanin Konstantin Araniti, zbriti deri në Bari, për të filluar së bashku me albanezët kryqëzatën kundër turqve.

Leonardo Da Vinçi i kishte njohur stratiotët dhe në shërbim të mbretit Louis XII e së fundi me Mbretin e ri, François I, por i kishte njohur dhe në oborrin e Cesare Borxhias, ku krahi tij rrinte prijësi stratiot; i kishte njohur kur në Milano arrestuan Ludoviko Sforca, të cilin e shoqëruan për ta burgosur në një kështjellë në Francë; e njihte dhe Mërkur Bua Shpatën - “Dominus Mercurio” si e quanin venecianët komandantin e shquar të stratiotëve albanezë, që lufto-

nte nëpër Itali ne krye të reparteve stratiote dhe si fitoi betejën e famëshme të Marignano.

Në ceremonitë e oborrit, mbreti mbante pranë kapedanin Bokali dhe heronjtë stratiotë Buziki, Gjon Manesi, Frata, Reposhi e shumë të tjerë, madje, Bokali ishte shqytar i mbretit. Bashkë me këta kapedana, ishin dhe një aradhë stratiotësh, të gatshëm në mbrojtjen e mbretit francez.



Pikturë murale në kishën e San Giorgio dei Greci në Venecia, ku prezantohet në plan të parë komandanri stratiot Joannis Manessi (Gjon Manesi) nga familja fisnike Manësi e Kunavisë.

Në vitet 1739 - 1745, komandant i regjimentit “*Real Macedone*” të mbretit Karli III Borbon, ishte stratioti arbëresh Gjergj Korafa, i cili kishte mobilizuar shumë arbëreshë, që u dalluan në luftimet kundër austriakëve në betejën e Veletrit më 1744.

Trimëria dhe besnikëria e stratiotëve albanezë vlersohej dhe admirohej nga mbretërit, princat dhe fisnikët europian. Jo vetëm Franca dhe Italia, por dhe Spanja, Bohemia, San Marino etj, kishin mobilizuar reparte stratiotësh, që shërbenin si reparte garde.

Giovanni Casanova (i famëshmi Kazanova), ne nje nga veprat e tij tregon se kur ishte i burgosur në Venecia, guardianët ishin stratiotë albanezë, burra të pashëm, të sjellshëm dhe trima të çartun.

Kazanova tregon se kishte miqësi me guardianët stratiotët dhe kalonte pjesën më të madhe të kohës duke biseduar. Ndër të tjera shkruan: “*Stratiotët albaneze ishin miqësor, por kishin një difekt, pinin shumë verë dhe qelbeshin se hanin shumë hudhra*”.

Komandanti i fundit i regjimentit “*Real Macedone*”, ishte gjenerali Dhimitër Leka nga Dhermiu, të cilit Jeronim De Rada i dedikoi poemën e famëshme “Milosao” (P. Petta: *Stradiotti, soldati albanesi in Italia. 2000 Ediz. Argo, Lecce*).

Familja Reres, krahas kontributeve ushtarake dhe administrative, u integrua dhe në jetën shoqërore e shpirtërore të arbëreshëve e të italianëve, ndër të cilët në veçanti shquhet murgu Andrea Reres, stërnipi i Demetrit, i cili themeloi Manastirin Basilian të Mezzojuso. Murgu Andrea Reres, i biri i Teodor Reres dhe Agnese Reres, vdiq në Mezzojuso ne vitin 1609.

Jeta dhe aktiviteti ekleziastik i murgut Andrea Reres, lidhen me manastirin e Mezzojuso, i urdhërit San Basilio Magno (1579) (Pietro di Marco – 2007).

Në memorialin rreth aktivitetit të komunitetit arberesh në komunën e Mezzojuso, murgu arbëresh Nikolla Filia, ka shkruar se albanezët, me nismën e murgut Andrea Reres, në vitin 1601 kërkuan themelimin e një manastiri të ritit ortodoks, pranë kishës të Shen Maries në Mezzojuso.

Këtë fakt e konfirmon dhe arbëreshi Nikolla Keta, i cili tregon se ky akt u firmos nga noteri arbëresh Luka Kuçia (Cuccia) më 12 janar 1601, ku dokumenton se manastiri basilian i Mezzojuso u themelua me iniciativën e Andrea Reres. (N. Chetta, *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*. Contessa Entellina 2002, f. 454).

Nikolla Filia dhe Nikola Keta, tregojnë se më 13 prill 1609, murgu Andrea Reres (para se të ndahej nga jeta), kishte depozituar testamentin noterit Antonio Glaviano në Palazzo Adriano.

Në testament, Andrea Reres thekson se murgjit në manastir duhet të jenë albanezë dhe grekë (arvanitas), të aftësuar në ritet ortodokse.

Pas vdekjes të murgut Andrea Reres, për ngritjen e manastirit në Mezzojuso, u impenjuan nëna e tij Agnes Reres, si trashëgimtaria universale e testamentit, dhe komisarët zbatues të testamentit arbëreshët Nicolò Matranga di Paolo (nga Piana degli Albanesi), Paolo Reres (i vëllai i Andreas), Gregorio Droserò (nga Palazzo Adriano), të cilët e bën publik vendimin e Papa Paolo V, të shpallur me bulën e 4 prillit 1617, ku urdhëronte themelimin e manastirit të Urdhërit Basilian në Mezzojuso.

Arbereeshi C. Granà, në kronikat e tij thekson fisnikërinë, cilësitë morale dhe patriotizmin e murgut Andrea Reres, ideatorit të themelimit të manastirit basilian në Mezzojuso. (Archivio Parrocchiale San Nicolò di Mezzojuso, vol. II, *Documenti Manoscritti*, p. 22). (Onofrio Buccola, *La Colonia Greco-Albanese di Mezzojuso. Origine, vicende e progresso*, Palermo 1909, p. 42).

Vendimi i Papa Paolo V, iu dorëzua ipeshkëvit të Palermos, kardinalit Giannettino Doria (1608 – 1643), i cili në vitin 1617 konsakroi hapjen e manastiri të San Basilio në Mezzojuso.

Në nderim të veprës të murgut të shquar arbëresh Andrea Reres, një nga rrugët kryesore të komunës të Mezzojuso mbanë emërin: Via ANDREA RERES.

Manastiri i Mezzojuso, ka kontibuar jo vetëm në jetën shpirtërore të arbëreshëve, por dhe në zgjimin e ndjenjave kombëtare, ruajtjen e identitetit albanez, duke hapur shkolla në gjuhën albaneze dhe në ruajtjen e besimit të krishterë në banorët e Provincës të Himarës albaneze.

Një grup murgjër arbëreshë siçilianë të urdhërit basilian, që ishin shugruar dhe kishin shërbyer në manastirin e Mezzojuso, në shekujt XVII – XVIII shkuan misionarë në Himarë, ndër të cilët janë: Imzot Neofito Rodinò, Imzot Simeone Laskaris, murgjit Onofrio Costantini e Giuseppe De Camillis, Imzot Arcadio Stanila, Don Nilo

Katalano, Don Filoteo Zassi, Don Callinico Granà, ndërsa arbëreshët Don Basilio Matranga dhe Don Giuseppe Schirò ishin nga Piana degli Albanesi. (N. Borgia: *I Monaci basiliani d'Italia in Albania, Appunti di Storia Missionaria, Secoli XVII-XVII*, Roma 1942).

Manastiri i Mezzojuso kishte një bibliotekë të pasur me libra, me dokumenta e me dorëshkrime të vjetra, pra ishte një institucion kulture, ku murgjit e pa lodhur i kanë dhënë dituri dhe kulturë komunitetit arbëresh të Siçilisë.

Në arkivin e Manastirit dhe të famullisë Shen Nikolla, ndodhen dokumenta interesante, ndër ato një dorëshkrim antik në dy vëllime me titull: “*Memoria per il Monastero di San Basilio di Mezzojuso*”. Njeri nga këto vëllime është transkriptuar nga Karmelo Filia-Spata, murg arbëresh nga Mezzojuso.

Memoriali fillon me një koment të shkurtër rreth testamentit të Andrea Reres dhe vazhdon me fakte e me ngjarje fetare, shoqërore dhe kulturore në manastir. Ky informacion i dokumentuar vazhdon deri më 16 tetor 1706, ditën kur vdiq arbëreshi Don Nunzio Schirò, i cili e pasuronte rregullisht kronikën e manastirit.

Me rëndësi janë shumë dokumenta dhe dorëshkrime të tjera, të sistemuar në vëllime të veçanta dhe të arshivuara në bibliotekën e manastirit nga murgu arbëresh Callinico Granà (Kallinico).

Manastiri i Mezzojuso, pas një lulëzimi 200 vjeçar kaloi një periudhë dekadence, madje me ligjet e vitit 1866-1867, iu hoq funksioni fetar, ndërtesa u braktis, murgjërit u larguan.

Gjatë Luftës I Botërore, ndërtesën e manastirit e shndërruan në gazermë dhe burg për robërit e ushtrisë austro-hungareze, madje në muajt e dimrit, ushtarët dhe të burgosurit, për t’u ngrohur, dogjën një pjesë të librave dhe të dorëshkrimeve të vjetra e me shumë vlera.

Në vitet pas luftës, Vëllazëria Shen Maria e të Gjitha Mëshirave, e bazuar dhe duke respektuar kriteret e testamentit të Andrea Reres, e rikonstrukttoi dhe e vuri në funksionim manastirin.

Në vitin 1920 Konfraterniteti vendosi që Fondacioni Andrea Reres, të shndërrohet në “Instituti Andrea Reres”, me objektiva edukimin

dhe formimin kulturor të rinisë arbëreshe të rritit ortodoks.

Ky mision iu besua Etërve Basilianë të Manastirit të Grottaferrata, ku ruhen libra të shumtë e plot dokumenta me vlera për historinë, kulturën dhe krishtërimin në trojet arbërore, por për fat të keq ende nuk janë studiuar.

Në këtë manastir, murgu Nilo Borgia (Borshi), kishte zbuluar një shkrim në gjuhën albaneze i shekullit XIII, por ai vdiq e nuk arriti t'ia dorëzonte Prof Eqerem Çabejt, si i kishte premtuar, kësaj nuk u arrit të bëhej publik ky dokument i rëndësishëm i gjuhës shqipe.

Ndërtesa e rinovuar e manastirit, ka dhe bibliotekën e re, ku janë depozituar pjesa e librave antike, që u shpëtuan nga djegiet, vjedhjet dhe nga shkatërrimet.

Kështu pra, historia e familjes Reres ne Itali, filloi si një mision ushtarak, u konkretizua me kontribute në jetën politike, administrative dhe shoqerore të Kalabrisë e të Siçilisë dhe vazhdon të jetë e pranishme e të ndihmoi denjësisht në jetën shpirtërore dhe kulturor të popullatës arbëreshe.



## **Eksodi i vitit 1481, i organizuar nga Princi Gjon Kastrioti, i biri i Gjergj Kastriotit.**

Princi Gjoni II Kastrioti, i biri i Skenderbeut, pasi mobilizoi shumë bashkatdhetarë në Kalabri dhe Siçili, zbarkoi në Himarën heroike, ku organizoi një kryengritje mbarëpopullore, për të çliruar atdheun nga pushtuesit.

Gjate vitit 1481 u zhvilluan luftime të ashpra, por forcat kryengritëse nuk mundën ta thyenin ushtrinë e madhe turke, kështu Princi Gjon Kastrioti u detyrua të kthehej në Itali, i shoqëruar nga bashkëluftëtarët dhe me shumë familje albaneze.



Mozaik i stemës të Kastrioteve në rezidencën e markezit Auletta, në lagjen Stella - Napoli

Stema Kastriotëve, në portën e rezidencës së familjes Kastrioti në lagjen Stella - Napoli.

Me që brigjet e detit Jon dhe të detit Adriatik, patrulloheshin nga anijet e flotës turke, ishte e pamundur të lundronin drejt brigjeve të Puljas, andaj princi i organizoi pjesën më të madhe të banorëve nga

Parga, Himara, Vlora, Myzeqeja, Durrësi, Mati, Lezha, Shkodra, të lundronin me varka dhe anije në afërsi të brigjeve tona ndërsa të tjerët duke udhëtuar nëpër rrugët malore, për t'u grumbulluar në Tivarin e Vjetër, ku do t'i prisnin galerat veneciane.

Ky eksod masiv u organizua nga Gjon Kastrioti dhe princat e tjerë albanezë, në marreveshje me Dozhën e Venedikut, i cili iu premtoi të dërgonte anijet për transferimin albanezëve në Itali.

Historia e këtij eksodi pasqyrohet në një dokument të shkruar në vitin 1650 nga albanezi Agostino Toçi, banor i San Kozmo Albanese dhe që u botua në Firenze në vitin 1860 nga Jeronim De Rada dhe Nikolo Jenò, si shtesë në veprën "*Rapsodie di un poema Albanese*". Sipas Prof Domenico Cassiano (Kasiano), ky memorial është një dokument historik me rëndësi, se përmban lajme të vërteta dhe dramatike të vitit 1481, rreth udhëtimit të albaneze drejt Italisë.

Grupe fisesh albaneze, të udhehequr nga Princi Gjon Kastrioti dhe kapedanët Kol Mark Shini, Elia Mullisi dhe Mark De Mathia (Mark Mati), nisën lundrimin e gjatë dhe pas disa ditësh arrijtën në portin e Pristan në Tivarin e Vjetër, ku sipas marrëveshjes duhej t'i prisnin anijet veneciane, por kur arrijtën, u ndodhën para një të papriture të trishtueshme, në port nuk ishte asnjë anije.

Venecianët, nga frika se mos revoltoheshin turqit për implikimin e tyre në këtë eksod, e shmangën portin e Tivarit të Vjetër dhe i ankoruan anijet më në veri, në portin e Pastroviç.

Gjon Kastrioti, kapedanet dhe masa e popullit, nuk u dekurajuan nga kjo pabesi. Të lodhur dhe të raskapitur nga udhëtimi i gjatë, para se të nisnin marshimin për në Pastroviç, vendosën të bëjnë një pushim të shkurtër, andaj u sistemuan në fortesën e qytetit dhe nëpër shtëpitë e pakta të Tivarit të Vjetër.

Komandanti i garnizonit turk, Jusuf Pasha, i informuar për këtë ikje masive të albanezëve, u vu në ndjekje me reparte kalorsish dhe arrijti t'i rrethoi në kështjellën e Tivarit të Vjetër. Për të dalë nga rrethimi, burra e gra të armatosura, pasi i vranë rojet, u hodhën kundër turqëve, që të befasuar nga sulmi i guximshëm, në një natë

me stuhi të forta shiu, u shpartalluan dhe nuk ishin në gjendje të organizoheshin për të përballuar situatën.

Pasi çanë rrethimin, masa e madhe e emigrantëve vazhduan udhëtimin gjatë asaj nate me kohë të keqe dhe me stuhi shiu, por para tyre doli një pengesë tjetër. Lumi që zbriste nga malet Perasto, dhe që kalonte në pllajën ndërmjet Tivarit dhe Pastroviç, kishte prurje të madhe uji dhe në këtë pjesë nuk kishte ura për të kaluar në anën tjetër.

Prijësit dhe populli, që po marshonte në këtë ikje masive, vendosën të mos ktheheshin pas, për të mos rënë robër të ushtrisë turke, që ishte vënë në ndjekje me repartet e kalorësve, andaj unanimisht vendosën ta kapërcejnë lumin.

Të kapur dorë për dore, me fëmijët në krah, të gjithë së bashku e kaluan lumin, por një pjesë e tyre, sidomos të moshuarit e drobitur nga ky udhëtim i gjatë, u mbytën nga valet e lumit të rrëmbyer. Pjesa më e madhe dolën në anën tjetër të lumit, ashtu të lagur e të cflitur nga lodhja, vazhduan udhëtimin dhe sapo arrijtën në portin e Pristan, hypën në anijet e nisën lundrimin drejt Palermos.

Ndoqën këtë intinerar lundrimi, sepse Ferrante I, mbreti i Napoilit dhe i Siçilisë, i kishte premtuar Princit Gjon Kastrioti, t'i sistemoi këta emigrantë, në komunat siçiliane, të banuara nga albanezët e emigruar në vitet e më parëshme.

Pas këtij lundrimi të mundueshëm shprese, masa e refugjateve u përball me një të papritur tjetër të hidhur. Mbreti Ferrante I Aragona, i friksuar nga ndonjë sulm hakmarrës i ushtrisë osmane, e urdhëroi mëkëmbësin, të mos lejonte zbarkimin e albanezëve në Palermo dhe në portetet e tjera siçiliane.

Kjo pabesi dhe vendim i pandershëm, që shprehte mosmirënjohje për ndihmën, që albanezët i kishin dhënë në mbrojtje të fronit të tij, i revoltoi Gjon Kastriotin dhe prijësit e tjerë albanezë, të cilët vendosën të vazhdojnë lundrimin drejt Salernos, me mendimin të zbarkonin aty dhe të vazhdonin udhëtimin në këmbë për në Napoli, por kur arrijtën ne Salerno përsëri u ndodhën para një të papriture, që i

revoltoi refugjatët. Mëkëmbësi i mbretit kishte urdhëruar të mos lejohej zbarkimi i albanezëve në Salerno.

Në këto rrethana, Gjon Kastrioti dhe prijësit albanezë vendosën të lundrojnë drejt Napolit dhe pa i përfilluar presionet dhe urdhërat e mëkëmbësit të mbretit, zbarkuan në portin e Napolit, ku u pritën me dashuri dhe me nderime nga turma të mëdha napolitanësh, të cilët i shoqëruan për në fortesën e Castel Nuovo (Kastel Nuovo).

Në këtë situatë të vështirë konfliktuale, princi Gjon Kastrioti, i shoqëruar me disa nga oficerat e tij, shkoi në Vatikan dhe takoi Papa Sisto IV, të cilit i tregoi për vuajtjet e bashkatdhetarëve, për pabesinë dhe pengesat që iu kishte krijuar mbreti i Napolit dhe i kërkoi nderhyrjen e tij për sistemimin e albanezëve, që ishin larguar, për t'iu shpëtuar masakrave turke dhe për të ruajtur fenë e krishterë.

Papa Sisto IV, kur u njoh me kalvarin e albanezëve, u mallëngjye dhe menjëherë u shkruajti letra mbretit Ferrante të Napolit, mbretit të Spanjes dhe mbretit të Francës, të cilët i urdhëroi të ndërhynin menjëherë për sistemimin e refugjatëve në trojet napolitane, ku ishin dhe pronat e familjes Kastrioti.

Mosmarreveshja mes mbretit Ferrante I dhe Gjon Kastriotit, ndikoi që shumë familje albaneze, të shpërndareshin e të vendosehin me banime në rrethinat e Napolit, ndërsa një pjesë zbritën në Siçili, ku ekzistonin shumë vendbanime të kaherëshme me albanezë. Mbreti Ferrante I, nuk u mjaftua me këto pengesa, por i kërkoi ndihëm mbretit të Spanjës, i cili dërgoi forca ushtarake, për t'i larguar me forcë albanezët nga Napoli.

Të ndodhur para këtyre presioneve, shumica e refugjatëve albanezë u grumbulluan në Avellino dhe në Ariano, ku i bënë rezistencë me armë ushtrisë spanjolle dhe asaj napolitane, që u thyen para forcës të albanezëve.

Pas këtyre përpjekieve të ashpëra, albanezët u detyruan të tërhiqen në Trebisacia, ku u bashkuan me forca të tjera albaneze, që kishin ardhur nga Kalabria.

Përndjekia e refugjatëve albanezë nuk u kufizua me kaq, pasi

mbreti Ferrante, me ushtrinë e tij shkoi në Koriliano (Corigliano) në shpinë të albanezëve, duke ua mbyllur rrugët e kalimit për në jug dhe duke i vënë luftëtarët albanezë në darën e rrethimit.

Princi Gjon Kastrioti, me forcat albaneze, i ndodhur i rrethuar nga ushtritë napolitane dhe spanjolle, kërkoi armëpushim dhe vendojen e paqës, ashtu si kishte urdhëruar Papa Sisto IV.

Në bisedimet mes dy palëve, u vendos që Princi Gjon Kastrioti të rikthehej në feudet e familjes në San Pietro Galatina, ndërsa familjet e tjera u shpërndanë në disa komuna të mbretërisë, madje iu dha një mbështetje modeste financiare, për të përballuar shpenzimet për sistemimin në trojet e reja.

Kështu u mbyll aventura e këtij fluksi të madh refugjatësh albanezë të vitit 1481.

## Shpërndarja e arbëreshëve dhe disa të dhëna nga regjistrat kishtare për familjet arbëreshe dhe italo-arbëreshe.

Arbëreshët, prej rreth 6 shekuj, janë minoranca etno-linguistike më e madhe në popullatën e Italisë.

Ndonëse nuk ekzistojnë regjistrime të plota dhe të sakta të albanezëve, që kanë populluar rajonet italiane, në fakt ka edhe të dhëna, që orientojnë për prani më të madhe të arbëreshëve.

Spas të dhënave të ISTAT të Italisë, në censimentin e vitit 2015, rezultojnë 120 000 shtetas italianë të regjistruar me kombësi arbëreshe, por duhet t'i rikujtoj lexuesve, se ka shume të tjerë, sidomos familje italo-arbëreshe dhe pse të regjistruara me kombësi italiane, vetëm mbiemëri dëshmon se janë arbereshë.

Për të argumentuar këtë fakt, por prezantoj të dhënat zyrtare, që i ka publikuar ISTAT i Italisë, i cili komunikon, 4429 familje me mbiemërin **Albanese** (Albaneze) dhe 145 familje me mbiemërin **Castriota** (Kastrioti), nga të cilët disa pjestarë rezultojnë me shtetësi dhe kombësi italiane.

Mbiemëri **Albanese** filloi të përdoret në shekujt e mesjetës. Banoret e porsardhur nuk ishin të regjistruar, shumë familje nuk gëzonin të drejtën e “zjarrit” (Fuoco), madje diferencoheshin nga banorët vendas, që i quanin “*coloro albanesi - ata shqiptaret*”. Në vitet e më pasme, këta banorë të rinj filluan t'i regjistrojnë me mbiemër Albaneze, pra si banorë jo italianë.

Ky regjistrim kryhej, kur duhej të paguanin taksat fisnikëve, në aktet notarile të legalizimit të pronësisë të tokës, të shtëpiave dhe të mjeteve të tjera të jetesës, kesisoj regjistroheshin gjatë martesave në kisha, apo në komunë, në regjistrimet e lindjeve dhe të pagëzimeve në kisha, të regjistrimit të fëmijëve në shkolla etj.

Mbiemëri Albanese përdorej jo vetëm për të treguar origjinën e familjeve të reja, që shtoheshin, por dhe për ta diferencuar nga pjesa tjetër e popullatës, në veçanti, për ta diferencuar këtë popullatë të

ritit ortodoks, nga pjesa tjetër katolike vendase. Përdorimi i mbiemërimit Albanese, u praktikua nga kisha katolike, e cila fillimisht nuk pranoi t'i pagëzonte femijët e lindur nga prindër të ritit ortodoks, kësaj me kalimin e viteve regjistroheshin me emërin e atdheut të originës, që arbëreshët e pranonin me krenari.

Numeri i familjeve arbëreshe, që janë regjistruar me mbiemërin Albanese dhe Kastriota, sipas rajoneve italiane (Censimenti 2015).

	Mbiemëri Albanese	Mbiemëri Kastrioti
Val d'Aosta	16	-
Piemonte	316	13
Lombardia	413	11
Liguria	139	1
Emilia Romagna	75	2
Trentino Alto Adige	22	-
Veneto	291	1
Friuli Venezia Giulia	42	-
Toscana	122	4
Umbria	11	5
Marke	23	13
Abruzzo	54	1
Molise	85	20
Lazio	328	3
Campagna	489	52
Puglia	898	14
Basilicata	81	1
Calabria	465	2
Sicilia	546	2
Sardegna	9	1

Nje mbiemër tjetër i shpeshtë arberesh është **Albanito**, që u përdor nga administrata mbretërore, në regjistrimin kryesisht të familjeve arvanite, të ardhur nga Morea dhe ishujt grekë.

Krahas mbiemërit Albanese dhe Albanito, për arbereshët u përdorur masivisht dhe mbiemëri Esopsito, mbiemër i neoformuar në kontekstin *ex – esposito*, që do të thotë jasht martese, që u përdor nga kisha katolike, në regjistrimet e fëmijëve të lindur nga prindër të ritit ortodoks, pra nga çifte të martuar, por me martesë të pa celebruara dhe që nuk legalizohej nga kisha katolike.

*“Në se shtohen dhe banorët me mbiemër Esposito, sigurisht numëri i arbëreshëve është shumë më i madh, se ato që referojnë statistikat e ISTAT”*, më tha miku im, shkrimtari, publicisti dhe prifti arbëresh Franko Esposito.

Këto rrethana e kanë ndërlikuar saktësinë e të dhënave për numërin e banorëve arbëreshë në Itali.

Dua t’i rikujtoj lexuesve, se në arkivat e shumë kishave ortodokse dhe katolike, ende ruhen regjistra me emëra e mbiemëra te familjeve arbëreshe dhe italo-arbëreshe.

Megjithë vështirësitë në deshifrimin e shkrimeve, që janë zvenitur nga koha, është mundësuar të njihen shumë familje dhe disa prej tyre po i prezantoj në vazhdim dhe me siguri do të ngjallin shumë kuriozitate dhe surpriza të bukura, kur të lexojnë, se këto mbiemëra arbëreshe janë dhe në Shqipëri.

Theksoj një fakt të rëndësishëm: Arbëreshët, nuk e njihnin gjuhën italiane, kështu nuk arrinin të kuptoheshin me banorët vendas dhe me priftërinjt italianë, andaj shpesh herë, emërat dhe mbiemërat deformoheshin, si pasojë disa u regjistruan me gabime, p.sh kur arbëreshi shqiptonte mbiemërin Kurtiqi, me që gjuha italiane nuk ka ne alfabet germën **K** dhe as tingujt **q** apo **dh**, në këto raste prifti e shkruante Curtichi dhe sipas fonetikës të gjuhës italiane shqiptohet Kurtiki.

E njëjta dukuri ndodh me mbiemërin Mazi. Në italisht tingulli i germës **z** – formohet me germën **s**, të vendosur para zanores, pra kur arbëreshi shqiptonte Mazi, prifti e regjistronte Masi.

Po kështu ndodhte me mbiemërin Kuçova, që në italisht shkruhet Cuciova etj.



I rikujtoj lexuesve, se disa fjalë të gjuhës italiane, nuk shqiptohen ashtu si shkruhen, p.sh shkruhet *ciao*, por shqiptohet *çao*, pikërisht kjo dukuri ka ndodhur me shumë emëra e mbiemëra albaneze.

Megjithë këto inkonvenienca të vogla ortografike dhe fonetike mes gjuhës italiane dhe gjuhës shqipes, nuk gjetëm vështirësi për identifikimin e emërave dhe mbiemërave të arbëreshëve.

**Në regjistrat e famullive në Katanzaro dhe Mezzojuso -  
Siçili, janë mbiemëra familjesh albaneze, ose italo-  
albaneze, të lidhur me emigracionin e familjes Reres në  
vitet 1444 -1448.**

- B:** Barbati, Barci (Barçi), Barcia (Barçia), Bardusci (Bardushi),  
Barlezi (Barleci), Balla, Barresi, Barsetti, Bersi, Bidati, Bilotta,  
Blasco (Blasko), Boccula (Bokula), Borci (Borçi - Borshi), Boria,  
Borgia (Borshi), Borgi (Borxhi), Borshi, Braillo, Bue, Buba,  
Branciti (Brançiti), Brunarello, Buccola (Bukola), Buschi (Buski  
- Bushi), Burescia (Burreshia), Burnacasa (Burnakaza).
- C:** Cacossa (Kakoza), Cacoza (Kakoca), Coccuzza (Kokuca), Calvaj  
(Kalvaj), Calfi (Kalfi), Calidaj (Kalidaj), Camarda (Kamarda),  
Camera (Kamera), Camizzi (Kamixi), Candiota (Kandiota), Carci  
(Karçi), Carnessi (Kamesi), Chiara (Kiara), Cicco (Çiko), Cirillo,  
Ciuglia (Çiulia), Ciulla (Çiulla), Celejaro (Çelejaro), Comitascia  
(Komitashia), Conte (Konte), Costa (Kosta), Crapisi (Krapizi),  
Costantino (Kostantino), Crepsi (Krepsi), Crialesci (Krijaleshi),  
Criesci (Krieshi), Crisia (Krizia), Crispi (Krispi), Cucci (Kuçi),  
Cuccia (Kuçia), Curtichi (Kurtiki)
- D:** Damiano, Despoti (Dhespoti), Dorengrichi (Dorengriki), Djani  
(Xhani), Dragoti
- F:** Ferrante, Ferrara, Figlia (Filia), Foco (Foko), Franzi (Franci).
- G:** Ganaci (Ganaçi), Glaviano, Glesci (Gleshi), Glioscia (Losha),  
Gori, Greko, Groppa, Gulemi, Golemi, Gugliotta (Gulota),  
Guzzetta (Guxeta).
- J:** Jers, Jessi
- L:** Lagresia (Lagrezia), Lala, Lecursiu (Lekurziu), Lesci (Leshi),  
Lescari (Leskari), Lojacono (Lojakono), Lopez, Luca (Luka), Luci  
(Luçi), Lugli (Luli).
- M:** Macaluso (Makaluzo), Mancusi (Mankuzi), Manay (Manaj),  
Mandalà, Manesi, Manisi, Manisci, (Manishi), Masi (Mazi),  
Matranga, Mezzaracchio (Mexarakio), Mirditi, Mauro, Miceli,

(Miçeli), Minisci (Minishi), Musacchia (Muzaka).

**P:** Parrino, Parrococchia (Parrokokia), Pachini (Pakini), Petta, Plescia (Pleshia), Pirri, Pravata, Proffera.

**R:** Rabalaj, Rafsi, Reppa, Rende, Rennis, Rennes, Rjebalati, Rùbesi

**S:** Scariani (Skariani), Sciglia (Skilia), Schirò (Skirò), Sochijpis (Sokjipis), Scurta (Shkurta), Schioza (Shkoza), Staffa, Standila, Stanizzo (Stanico), Spata, Stassi, Sugli (Suli).

**T:** Teorga, Torga, Trajilla, Trapuzzano (Trapuxano), Thaminiti, Toja, Thana.

**V:** Vartusa, Veschio (Veskio), Vonazzo (Vonaco), Vrena, Vuoccola (Vuokola).

**Z:** Zacca (Zaka ose Xaka), Zaccheo (Zakeo), Zimbi, Zingana, Zenga.

**Mbiemëra familjesh albaneze ose italo-albaneze në  
vendabanime të tjera arbëreshe.  
Famullia e San Benedetto Ullano.**

Regjistri i martesave në dekadën 1760-1769

Martesa ndërmjet albanezëve dhe të përziera italo-albaneze:

**A:** Angotti, Ainello, Amato, Aquino (Akuino), Aloe.

**B:** Barci (Barçi), Basile, Bellusci (Bellushi), Brisci (Brishi), Bevacqua (Bevakua), Bastone.

**C:** Como (Komo), Carci (Karçi), Caputo (Kaputo), Cittadino, Cesario, Candreva (Kandreva), Capparelli (Kaparelli), Caruso (Karuzo), Candia (Kandia), Cervo (Çervi), Cucinelli (Kuçinelli), Caravello (Karavello).

**D:** Does, Dorsi, De Luca (Luka), Doma, De Rose, Di Franco (Franko), Dragone, Di Linardo, Diciancio (Diçiançio), Di Rosa, Di Muccio (Muçi), Draga, De Seta, De Marchi, Di Luca (Luka), De Francisci (Francishi), Docimo (Doçimo).

**E:** Elmo

**F:** Fortino.

**G:** Greco (Greko), Grisolia (Grizolia), Guma, Gliosci (Loshi), Gentile (Xhentile).

**I:** Iacotante, Iaconante, Iannuzzi (Januci).

**L:** Lambré, Lavallo, La Rosa.

**M:** Mosciaro (Moshiaro), Marchese (Markeze), Milano, Musacchio (Muzaka), Mele, Muratori, Migliano (Miliano), Maio, Marano, Mustacato (Mustakato), Malito, Manesi, Masci (Mashi), Molla.

**N:** Napolitano.

**O:** Ortino.

**P:** Pazzia (Pacia), Petruzzo (Petruco), Petrucci (Petruçi), Pinnola, Petrelli, Patitucci (Patituçi).

**R:** Rodotà, Russo, Russi, Ringa.

**S:** Sarpa, Sarro, Suriano, Salerno Tavolaro, Scovino (Skovino),

**T:** Tavolaro, Trotta, Tocci (Toçi).

**U:** Urgente

**V:** Vilotta, Votini, Vilecco (Vileko)

### **Registri i albanezeve të vdekur në vitet 1750-1759, në famullinë e San Benedetto Ullano.**

**A:** Alfano, Angotti.

**B:** Brisci (Brishi), Becci (Beçi), Bellusci (Bellushi), Barci (Barçi), Buscio (Bushi), Bramuglia (Bramuglia), Biffa, Baffa, Blumetto, Bianco (Bianko), Bonanno, Bitri.

**C:** Calimà (Kalima), Chimento (Kimento), Candreva (Kandreva), Costabile (Kostabile), Coma (Koma), Cittadino, Caracciolo (Karaçiolo), Cesario, Daniele Cannizzaro (Kanixaro), Carci (Karçi), Capparelli (Kaparelli), Caratelli (Karatelli), Caravelli (Karavelli), Caputo (Kaputo), Calimanni (Kalimani), Costanzo (Kostanco), Cavaliere (Kavaliere), Cavallo (Kavallo), Caroppa (Karopa), Collina (Kolina).

**D:** Di Ciancio (Çiançjo), De Franco, Dores, Se Sabato, De Buono, Di Tommaso, Di Mucio (Muçjo), Di Cuoco (Kuoko), Doma, Domo (Domi), Di Buono, Di Segno (Senjo), Draga, Di Micieli (Miçieli), Di Buscio (Bushi), Di Leonardo, Dramis, Di Nicastro (Nikastro), Dome, De Luca (Luka), De Fabio, De Tommaso, Donnici

(Donnici), De Alexandro, Di Cerva (Çerva), Di Luca, Di Santis, De Linardo.

**E:** Elmo.

**F:** Fortino, Falvo, Fionda, Fato.

**G:** Greco (Greko), Gentole (Xhentole), Grisolia, Gliosci (Loshi), Gendole (Xhendole), Guma, Gambinigo (De Niro).

**I:** Iaconante, Iannone, Iannuzzi, Iuliano, Iannotta, Lucci (Luçi).

**L:** Lancelotti, Longo, Lopez, Le Rose, Lazzari, Presti, Lambre, Lavalle, Leonardo, Li Donnici, Lancellotta, La Rosa, Le Caio (Kaio), Linardo, Lagano.

**M:** Mosciaro (Moshiaro), Musacchio (Muzaka), Marchese (Markeze), Migliano (Miliano), Masci (Mashi), Manes (Manesi), Mele, Mauro, Massimilla, Miceli (Miçeli), Morello, Malopera, Mannara, Migano, Marcilia (Marçili), Mosacchio (Muzaka), Mosciaro (Mosharo).

**N:** Napolitano, Nicastro (Nikastro), Naticello (Natiçello).

**O:** Ortino, Ordino.

**P:** Petrone, Pinnola, Pati, Pazzia. Patitucci, Pellicano (Pelikani),

**R:** Russo, Rodotà, Ringa, Riggio (Rixhio).

(Shënim: Mbiemëri Rodotà, në tekstet ekleziastike të viteve 1750 – 1754, rezulton i shkruar dhe RODATA. Kjo formë konstatohet dhe në një shtese të Bullarium të shekulli XIX, ku mbiemeri Rodata perseritet disa here, si e ka verifikuar Italo Sarro në disa studime të kujdeseshme, të cilat i ka publikuar kohet e fundit).

**S:** Sarro, Spallato, Scarlato (Skarlato), Sarpa, Soriano, Sproviero, Stamile, Santoro.

**T:** Tavolaro, Tocci (Toçi).

**U:** Urgente.

**V:** Vilotta, Villano, Vetere, Vilecco (Vileko), Valente.

## **Komuna e Falconara ALBANESE (FALKONARA).**

Ditën e 10 Janarit 1741, në trojet e Falconara janë këto 9 lagje (kuartiere) arbëreshe: Manësit; Mbi Krua; Keshtjella; Nën Timpa dhe Sheshi i Muzakeve; Zonja e Papërlyme, Koliadola; Rreth Kishës; Kisha e Re; Kisha Nënë dhe Piazza (Piacca - Sheshi qendror). Këto lagje te banuara nga arbereshet, janë regjistruar në kadastrën e mbretërisë të Napolit të Karlit III Borbone.

### **Abruceze (Abbruzise).**

**A:** D'Aniello, D'Amico di Bucita (Amiko di Buçita).

**B:** Bucieri (Buçeri), Bacca (Baka), Barone, Balella, Bundo, Brisci (Brishi), Bruzzato (Bruxato), Fionna, Barbato, Borgia (Borxhia – Borshi), Belluccio (Belluçi), Balella Manes, Baffa, Baffo, Basta, Barone, Bruno, Bianco (Bianko), Bonante, Bonnace (Bonaçe), Britia (Briti), Bitri.

(Giorgio Baffo, ishte i biri i Andrea Baffo dhe Chiara Querini Cecilia Sagredo , e lindur me 28 marzo 1711, ishte klaviceballiste dhe ne vitin 1771 takoi Wolfgang Amadeus Mozart , i cili e admiroi per aftesite ne interpretimin ne klavide mbel, si rezulton nga letra, qe Moxarti , i dergonte te atit Leopold).

**C:** Canata (Kanata), Candreva (Kandreva), Carce (Karçe), Caccopa (Kakopa), Cavallo (Kavallo), Como (Komo), Conte (Konte), Camodeca (Kamodeka), Coraggio (Koraxhio), Curcio (Kurçio), Candreva Stamato, Karnevale, Camda (Kamda), Canda (Kanda), Di Banola, Di Cerisano (Çerizano),

**D:** Del Gesù.

**F:** Fionna, Franzese (Franceze), Fionna Meccica (Meçika), Formosa, Fortino.

**G:** Greco (Greko), Greci (Greçi), Gangalasco (Gangalasko), Gliosci (Loshi), Giancarlo (Xhiankarlo), Giamarco (Xhiamarko), Goliasco (Goliasko), Genovese (Xhenoveze). Gambanero.

**I:** Imbardello.

**J:** Jodice (Jodiçe).

**M:** Morelli, Manes, Morello, Masci (Mashi), Marino di Cerisano (Çerizano), Musachio (Muzaka), Mustamato Manesi, Manzaro, Manes Morello, Manes Panbindo, Manes Mustanato, Mancino, Mosciaro (Moshiaro), Mannarino, Micieli di Longobardi, Mungaro, Manisco (Manisko), Miele, Manes Pacebinolo, Manes Cazzola (Kacola), Marchese (Markeze), Manes Bonante, Massara, Manca Balella (Manka Balella), Mustaccato (Mustakato).

**N:** Natale, Nesci (Neshi).

**P:** Pitta, Petrasso, Petruzzo (Petruco), Pacebindo (Paçebinda), Pinnola, Pellegrino di Belmonte, Panbindo, Pedimolla, Petrazzo, Pantanella.

**R:** Rocco (Roko), Rossato, Ragona, Riposo, Rippa, Rita, Ricchio (Rikio), Rusco (Rusco), Rosa, Russo, Rotodà, Ristuccio (Ristuçio), Razza (Raca), Rizzo (Rico).

**S:** Staffa, Scaglione (Skalione), Staringi (Starinxhi), Stamato, Sacco (Sako), Salomone.

**T:** Tocci (Toçi).

**V:** Valente, Valle, Vela di Cerisano (Çerizano).

**Z:** Zappa.

### **Kleri arbëresh i San Mikele Arkangelo në Falkonara:**

Reverendo Don Emanuele Manes,

Rev.do D. Geniale Sacco (Gjeniale Sako),

Rev. do Don Domenico Sacco (Domeniko Sako),

Rev.do Don Francesco Ricchio (Franðesko Rikio),

Dhjaku Don Valentino Petruzzo (Petruco),

Rev.do Don Giovanni Candreva (Xhiovani Kandreva).

Këto janë emërat e klerikëve të famullisë, shkruara me dorën time dhe të vuolsura me vulën time.

Falconara 28 shkurt 1742. Prifti Don Nicolò Barone.

## **San Giacomo (Shen XHIAKOMO).**

Shtëpitë albaneze në Shen Xhiakomo, dioqeza e Bisignano, regjistruar më 30 gusht 1753, në librin e Kishës San Giacomo Maggiore.

Kleri: Prifti Don Tommaso Smiriglio (Smirilio);

Rev. Sac. D. Giuseppe Sarro

Rev. Sac. D. Filippo Parise da Torano - Ekonomat i famullisë.

Mbiemërat e familjeve arbëreshe në këtë regjistër:

**A:** Albanito

**B:** Barci (Barçi), Bersito, Baffa

**C:** Capparelli (Kaparelli), Custo (Kusto), Candreva (Kaandreva), Cavallo (Kavalla).

**D:** Di Fazio, Di Sancti, Dramis, Dammis, Diano

**F:** Ferrara, Ferro, Ferra

**G:** Golemme (Golemi), Galetta

**I:** Iani (Jani) **J:** Juliano, Juliana

**L:** Licursi (Likursi), La Croce (Kroçe), Lidonnici (Lidoniçi),

**M:** Mazzei (Macei), Maffei, Malicchio (Malikio), Musacchio (Muzaka).

**P:** Pinnola, Percacciante (Perkaçiante), Pace (Paçe), Pucci (Puçi).  
Pera.

**R:** Rizzo (Rico), Rotondò, Ritondò, Russo.

**S:** Sarro, Smiriglio (Smirilio), Stamile.

**T:** Tocci (Toçi), Talarico (Talariko), Tudda, Trotta.

## **Famullia e Cavallerizzo (KAVALLERICO)**

Familje albaneze të regjistruara në "Aktet preliminare" në kishat e San Giorgio dhe San Marku, famullia e Kavallerico:

sipas dëshmive të nëpunësit të kadastrës Dioguardi (Dio Guardi).

**A:** Audino

**B:** Barci (Barçi), Becci (Beçi), Baffa, Bagano, Becce (Beça).

**C:** Caparello (Kaparello), Cappellano (Kapellano), Candreva (Kandreva), Catroppa (Katropa), Cavallo (Kavallo).



**F:** Ferrara, Ferro, Franzese.

**J:** Jerbis.

**K:** Calo (Kalo).

**L:** Lata, Lento, Licursi (Likursi).

**M:** Melicchio (Melikio), Mosciaro (Moshiario), Grimano.

**P:** Pirrotta, Pinnola, Petta, Parise, Posteraro, Parrotta.

**R:** Ricioppo (Riçiopo), Rizzo (Rico), Russo, Romeo.

**S:** Staffa, Santo.

**T:** Tuoto, Tudda, Tuota.

Prifti i famullisë në Kavallerico është Don Antonio Luce (Luçe).

### **Spezzano Albanese (SPECANO ALBANEZE).**

Emërat e klerikëve në Spezzano Albanese, për vitet 1598 – 1620, të shkruara në librin më të vjetër të kësaj famullie.

Janë priftërinj ortodoks, andaj kanë përkrah dhe emërat e grave.

D. Martino Barbati – Kapelan; bashkeshorti i Viena Lanna, rezulton i regjistruar në faqet 3.18.27.43.58.132.148.

D. Andrea Magnicavallo bashkëshorti i Carolina Tuccio (Karolina Tuçi), regjistruar ne faqet 21.27.30.37.43.65.76, 76.88.92.

D. Antonio Ribecco (Ribeko), bashkeshorti i Domenica Capparella (Domenika Kaparella); faqe 1.7.55 dhe 80.

D. Paulo Tocci (Pal Toçi), bashkeshorti i Baba Barcia, (Barçia), faqe 2, 23.

### **Treguesi alfabetik i emërave, ose i mbiemërave të fëmijëve arbëreshe të pagëzuar në kishat e Spezzano Albanese në vitet 1598 – 1620. Vëllimi i parë i regjistrit.**

**A:** Andropoli

**B:** Basta, Barbati, Baccaro (Bakaro), Brunetti, Borsci (Borshi), Belluccio (Belluçi), Barbato, Barci (Barçi), Bulmetta, Blanga, Bellezza (Belleca), Blundo, Buono, Buzzo, Basilacchio (Bazilaki).

**C:** Camodeca (Kamodeka), Conti (Konti), Cuccio (Kuçio), Cassiano

(Kasiano), Como (Komo), Candreva (Kandreva), Collissa Kolisa), Caparello (Kaparello), Cuccia (Kuçia), Chiurca (Kiurka), Chiurco (Kiurko), Cucci (Kuçi), Corifa (Korifa), Colliffa (Kollifa), Cucia (Kuçia), Colista (Kolista), Cantreva (Kantreva), Cuomo Kuomo).

**D:** Dorssa, Dorsa, Delli Preti, Drachina (Drakina), Dellipira, Drachino (Drakino), Draga, Dorrisa, Dorsa Stefano.

**E:** Elmo, Elma.

**F:** Frascino (Frashino), Franzino (Francino).

**G:** Goronezza (Gorenca).

**J:** Jerjanni.

**K:** Krea.

**L:** Lanza, Luci (Luçi), Latti.

**M:** Magnicavallo (Manjikavallo), Melicchio (Melikio), Manese, Manesi, Morffa, Molfa, Marches Marchese (Markes Markeze), Mesuca (Mezuka), Marco (Marko), Melicchia (Melikia), Manasi, Mapasi.

**N:** Nemojani, Nemojanni.

**P:** Potto Jano.

**R:** Ribecco, Ribeco, Rebecco, Rebecchi (Ribeko, Rebeko, Rebeki).

**S:** Staffa, Saracco (Sarako), Siracco (Sirako), Scura (Skura), Salo. Sciamaro (Shamaro), Squillizza (Skuilixa), Scilizzo (Shilixo),

**T:** Toccio (Toçi), Turco (Turko ose Turku), Trofano.

**V:** Vaccaro (Vakaro), Vascia (Vasha).

### **Mbiemëra të fëmijëve të lindur dhe të pagëzuar në shekullin XVII në komunën e FAXHIANO (FAGGIANO).**

Fëmijë të lindur nga familje albaneze si dhe italo – albaneze dhe të pagëzuar në vitet 1663 - 1664:

Pichierri (Pikieri), Palumbo, Marseglia (Marselia), Fumma, Assi, Magagnino (Maganjino), Canarile (Kanarile), Pellicaro (Pellikaro), Aramte, Grebiscia (Grebishia), Manesi, Pansera, Motulese, Arianiti, Decarlo (Dekarlo), Tripaldo, Chirana (Kirana), Scirbisci (Shirbishi),

Scorrano (Skorrano), Arirpoli, Colluccia (Koluçia), Grusi, Herri, Gollemmi (Golemi).

1637 - 1670: Ne regjistrit e Famullise te Faxhiano jane regjistruar disa martesat arberëshesh, sipas ritit latin:

1637: Arbereshi Demetrio Muzaka nga Belvedere, martohet me arbëreshen Adriana Panikio nga Faxhiano.

18 mars 1640, martesat e arbëreshëve Karlo Savino nga Foxhia me Dionora Kervina nga Belvedere.

1670: Arbereshi Françesko Spada nga Monteparano, martohet me arbëreshen Adriano Ariero nga Faxhiano

Viti 1670: Lista e mbiemërave të familjeve arbëreshe, sipas regjistrit të famullisë të Faggiano (Faxhiano):

Vitale, Maurichio (Maurikio), Castriota (Kastrioti), Manesi, Borsci (Borshi), Barletta, Bociari (Boçari), Allisto, Cresci (Kreshi), Pissarri, Likamati, Pinto, Cusano (Kuzano), Vallari, Groppa, Lombardo, Zacca (Zaka), Sollegati, Gallucia (Galluca), D'Angelo (Engjelli), Macripodi (Makripodi), Rois, Lanza, Moncello (Monçelo), Rochera (Rokera), Delli Ponti, Rubica (Rubiku), Coso (Kozo), Matarante, Chirama (Kirama), Battamule, Abbate, Sarruca (Sarruka), Daloye, Mataranga, Ragale, Coxa (Koksa), Pulieri, Mathes, Mosca (Moska), Cavallo (Kavallo), Mosciocchio (Moshokio), Airo, Galeone, Plescia (Pleshia), Mazzarocchi (Maxarroki), Chirano (Kirano), Mazzarrea (Mazreka), Salligati, Lilo, Venneri, Cella (Çela), Papari, Savina, Becci (Beçi), Pissarra (Pizara), Brigante etj.

## **LISTA E MBIEMËRAVE TË ARBËRESHËVE, TË MBLEDHURA NGA G. LAVIOLA.**

Studiues të shumtë arbëreshë, kanë botuar emëra e mbiemëra familjesh arbëreshë në treva të shumta të Italisë.

Një ndër ata studiues është Giovanni Laviola (Gjon Laviola), i cili në një letër dërguar historianit arbëresh Raffaele Patitucci D'Alfiera Patitario, i shkruan:

*Carissimo Patitucci.*

*Eccoti servito! In parte, perché tra le mie carte dovrei trovare gli elenchi dei cognomi di altri nostri paesi arbëreshë.*

*Ti abbraccio. Tuo Giovanni Laviola.*

Shumë i dashur Patituçi.

Ja të shërbeva, pjesërisht, sepse ndërmjet letrave të mia do të gjeshtë mbiemërat e vendeve tona arbëreshe.

Të perqafoj.

I joti Gjon Laviola.

Në studimin “Casati albanesi in Calabria dhe Sicilia”, botuar në “Rivista Storica Calabrese. Anno 1990”, historiani Raffaele Patitucci D'Alfiera Patitario, falenderon të gjithë ata, që kontribuan në mbledhjen dhe publikimin e emërave dhe të mbiemërave të diasporës arbëreshe dhe në vazhdim prezanton listën e emërave dhe sidomos të mbiemërave të arbëreshëve dhe arvanitëve, që prej shekujsh banojnë në Itali.

Në veçanti ai falenderon arbëreshin Angelo Bugliari (Bujari) për mbledhjen e mbiemërave arbereshe (albanezeve) dhe studiuesin Gerald Rohlfs, i cili mblodhi emëra dhe mbiemëra arvani-tase, pra të albanezëve me origjinë nga Morea, që banojnë në trojet jugore të Italisë.

Ne kete botim, Patitucci ka shfrytëzuar dhe materialet e studimit të historianit Domenico Zangari, rreth kolonive albaneze në Kalabri.

**Mbiemëra albaneze, ose të italianizuar në KOZENCA dhe në periferitë kozentine, të banuar nga arbëreshët nga viti 1468 dhe në vazhdim.**

- A:** Alescia (Aleshia), Archispoli (Arkispoli), Aricciopoli (Ariçiopoli), Arcuri (Arkuri), Argondizza (Argondica), Arianite, Avati.
- B:** Baffa, Barca (Barka), Barci (Barçi), Barducci (Barduci), Barletti, Barlezio (Barleci), Basile (Bazile), Basta, Bavasso, Bellizzi (Belixi), Braile, Bellucci (Belluçi), Belluscio, Bellusci (Bellushi), Bianchi (Bianki), Bilotta, Blaiotta, Blasciotta (Blashiota), Blascetta (Blasheta), Blutetti, Berrescio (Berreshio), Brescia (Breshia), Bue, Buono, Buso (Buzo), Bruna, Brunella, Brunettio.
- C:** Cacossa (Kakoza), Camodeca (Kamodeka), Canale (Kanale), Candie (Kandie), Candreva (Kandreva), Castriota (Kastrioti), Cantisani (Kantizani), Capparelli (Kaparelli), Ciriaco (Qiriako), Cassiani (Kassiani), Chefalo (Kefalo), Chiurco (Qirko), Clausi (Klauzi), Cavalso (Kavalso), Chembesemi (Këmbëzemi), Csula (Ksula), Comneno (Komneni), Concistré (Konçistre), Cucci (Kuçi), Cortese (Korteze), Cumano (Kumano).
- D:** Damis (Damsi), Deragò (Drago), De Luca (Luka), De Marco (Marko), De Mari, De Marchis (Markis), De Metre (Metra), De Rada, Diodati, Dorsa, Dremia.
- E:** Eramisino, Epifanio, Elmo.
- F:** Fazio (Facio), Fareco (Fareko), Ferec (Ferek), Ferrara, Ferra, Fezzari (Fexari), Flocca (Floko), Forte, Frascines (Frashëni), Fronzini (Fronxini).
- G:** Gervasi, Gramisci (Gramshi), Ghega (Gega), Groppa, Gulemi, Gullo, Gurasci (Gurashi).
- I:** Irianni, Jannuzzi, Jerovaste
- L:** Lanza, Laràs, Laurito, Leca (Leka), Lesci (Leshi), Lugli (Luli), Leucedito (Leuçedito), Licursi (Likursi), Locito, Lopez, Loprete.
- M:** Majerà, Manaj, Manes, Manesi, Marco, Mjeda, Mele, Marchianò (Markianò ose Marcianò), Masereca (Mazreka), Masi (Mazi),

Marcovicchio (Markovikio), Masci (Mashi), Mastrange (Mastranxhe), Matranga, Matrangelo (Matranxhelo), Matanà, Mauro, Maurello, Milicchio (Milika), Minisci (Minishi), Miracco (Mirako), Molfe, Mortati, Muricchio (Murikio), Musacchio (Muzaka).

**N:** Nemojanni, Nociti (Noçiti)

**P:** Pece (Peçi), Papadè, Parrotta, Pellicano (Pelikani), Perrone, Petta, Picchjicchie (Pikjikie), Pisarra, Pisarri (Pizarri), Placco (Plaku), Policastro (Polikastra), Pristi (Prista), Placa (Plaka).

**R:** Rade (Rada), Rafti, Rennis, Riccioppo (Riçiopo), Rinaldi, Rodotà

**S:** Samengo, Santojanni, Sciroca (Shiroka), Scirchio (Shirkia), Scura (Skura), Serseo, Scuracchio

(Skurakio), Scuteri (Skuterra), Sisce (Sishe), Smilari, Spada, Spata, Spàno, Spanò, Staffa, Straticò (Stratikò)

**T:** Tamburi, Tamburino, Todaro, Toma, Totarello, Toto, Totaro, Tocci (Toçi), Tosca (Toska), Toia, Trifiglio (Trifili), Turchio (Turku).

**V:** Vaccaro (Vakaro), Vecchio (Vekio), Vicchio (Vikio), Vrana.

**Z:** Zacca (Zaka), Zaccaro (Zagari), Zaccaria (Zagaria), Zappa.

### **Familje arbëreshe dhe arvanite në komunën e Fuscaldo (Fuskaldo) në Kozentino.**

Nikolin Lattari, Gino Oliviero (Xhino), Ciccio Lattari (Çiço), don Alonso Vacari (Vakari), don Gennaro Valenza (Xhenaro Valenca), don Domenico Mazzei (Domeniko Macei), arvaniti Gioacchino Mayerà (Xhoakino Majerà), Raffaella Smiriglio di Antonio (Smirili), Anna Felice d'Andrea (Feliçe), Tommaso Smiriglio (Smirili) Teresa Lattaro (Latari).

Joannes Patitucci (Gjon Patituçi), Antoni Prancisci (Frañçishi), Salvatore a Tarsia, Isabella Casolino (Kazolino), Anna Isabella Amerise, Elena Corrado (Korrado), Hieronymo Patitutti (Jeronim Patituti), Elissabetta Grasso. etj

## **Mbiemëra arbëreshe, karakteristike në Salento albaneze, në Provincën e Taranto.**

- A:** Airò, Alitri, Anastasia, Aranite, Ariciopoli (Ariçiopoli), Archiopoli (Arkiopoli), Anciopoli (Ançiopoli)
- B:** Barbuzzi (Barbuci), Barletta, Basta, Bianca (Bianka), Biasca (Biaska), Bischettini (Bisketini), Blaschi (Blaski), Borsci (Borshi), Briganti, Brois, Buba
- C:** Capuarimathi (Kapoarimadhi), Calegna (Kalenja), Camera (Kamera), Candieta (Kandieteta), Carci (Karçi), Capece (Kapeçe), Castriota (Kastrioti), Cella (Çela), Chirama (Kirama), Cocsà (Koksa), Conte (Konte), Csàfilo (Ksafili), Curano (Kurani).
- D:** Damiano, Dello Vuolo, Di Comite (Komite), Di Lia
- E:** Ela
- F:** Fischietti (Fiskietti), Friuli.
- L:** Lanza, Licomati (Likomati), Luca (Luka).
- M:** Macripòdi (Makripodi), Manes, Massareca (Mazreka), Mathea, Matres, Mazzeracchio (Mazeraka), Mauricchio (Maurikio), Mauro
- P:** Panico (Paniko), Panuzio (Panucio), Pascadopoli (Paskadopoli), Pinto, Pisarri, Picchierri (Pikieri).
- R:** Renesi, Rennes, Renisi.
- S:** Saracò (Sarako), Sarrùca (Sarruko), Savino, Schivona (Skivona), Sollegati, Spanò, Saconi (Sakoni)
- Z:** Zacca, Zaccari (Zagari), Zaccheo (Zakeo).

## **Provincat e Foxhia dhe Kampobasso.**

- Disa mbiemëra albanezë ne familje të italianizuar: Clescia (Kleshia), Geneci, Gleve, Intrevedi, Licursi, Neri, Muzachi (Muzaka).
- Disa mbiemëra fisesh dhe familjesh albaneze në shekujt XV-XVI.
- B:** Brianite, Bua, Balscia (Balsha), Besta, Bjescka (Bjeshka), Blauka, Blasciete (Blashiete).
- C:** Commani (Komani).
- D:** Dregopsa, Damis, Ducagjini (Dukagjini), Dushmani.

**G:** Grops.

**F:** Frasseri (Frasheri)

**G:** Ghega (Gega), Golemi, Gramsci (Gramshi).

**C:** Castriota (Kastriota), Cuciova (Kuçova).

**K:** Kuqi, Lera, Lopez.

**M:** Mati, Muzaqi (Muzhaqi – Muzaka), Masereka (Mazreka).

**P:** Perroni, Peta, Progoni.

**SH:** Sciroca (Shiroka), Sharruna, Sapati (Shpati), Scura (Skura), Spanoi (Spani).

**T:** Tosca (Toska), Thopia (Topia).

**V:** Vrana.

**Z:** Zaccaria (Zagaria).

### **Lungro.**

**A:** Arari.

**B:** Baffa, Barci (Barçi), Battaglia (Batalia), Bavasso, Belleza (Beleca), Belluscio (Belushi), Bolnetto, Buono, Baccaro (Bakaro).

**C:** Cagliolo (Kaliolo – Kaliola), Camisdeca (Këmishdeka), Candreva (Kandreva), Chiurca (Kurka), Calò (Kalo), Coccozza (Kokoca dhe Kokuca), Conte (Konte), Cortese (Korteze), Cuccia (Kuçia),

**D:** D'Agostino, D'Urso, Denise, De Marco (Marko), De Pace (Paçe), Domestico (Domestiko), Dorsa.

**E:** Elmo.

**F:** Fida, Flescia (Flesha), Frascino (Frashino-Frasheri), Frega.

**G:** Gramsci, (Gramshi).

**J:** Jurcianne (Jurçane).

**L:** Lardico (Lardiko),

**M:** Manes (Manesi), Massarecchia (Mazreka), Matano, Matino, Mercatante (Merkatante), Mezzacapo (Mexakapo), Mirditi, Murone, Mattinò.

**P:** Paladino, Pantosa (Pantoza), Parapugna (parapunja), Petta,

**R:** Ragona, Reres, Rere, Rizzo (Rico),

**S:** Solano, Scarparito (Skaraprito), Sgura (Skura).



## **Rota Greca (Rota GREKE).**

Andronico (Androniko).

Belluscia (Belushi), Baudo, Blanette.

Caparello (Kaparello),

Golè.

De Paccia (Paçia).

Mangiacavallo (Manxhiakavallo), Maza (Maca).

Platasco (Platasko).

Russo. Russi (Ruso, Rusi).

Scarano (Skarano), Scura (Skura), Spàlato.

Tocci (Toçi).

## **San Martino Di Finita.**

Basti, Bua.

Cali (Kalì), Camodeca (Kamodeka, kjo familje themeloi qendrën e banuar të Castroregio - Kastroregio), Cartofiloca (Kartofiloka),

Clavaro (Klavaro), Coppola (Kopola).

Dardes, Di Crisci (Krishi), Dramis.

Cunissi (Kunisi),

Ferraro.

Gliescia (Lesh), Golè, Greco (Greko).

Lanzillotta (Lançilota).

Melicchio (Melikio), Migliano (Miliano), Musacchio (Muzaka),

Marchese (Markezi).

Namila.

Pillora.

Radi, Rotundo.

Silves, Spata, Sulla (Sula).

Tozio (Toco), Tocci (Toçi).

**San Giacomo Di Cerzeto.**  
**Arbereshet e quajne Shën Japku i Qana.**

Bua, Burra – Burri.

Cenestabulo.

Franci.

Greco (Greko).

Migliano (Miliano).

Patitucci (Patituçi), Petta, Pistoja (Pistoja).

Soriano, Smiriglio (Smirili).

Trotta.

**Serra Di Leo.**

Bua,

Capparello,

Lata,

Tavolaro.

**Cavallerizzo.**

**Është themeluar nga arbëreshët në vitin 1478 dhe e quajnë Kajverici.**

Basta.

Capparello (Kaparello).

Lata,

Migliano (Milano), Rotondò.

**Mongrassano.**

Arrigoni, Aragona, Ayerbes.

Capparello (Kaparello), Cingaro (Çingaro).

Dramis.

Migliano (Milano), Mosciaro (Mosharo).

Petta,

Rotundo, Russo.

Smilari, Tavolaro.

### **Sartano.**

Aresci (Areshi).

Brayosta (Brajosta).

Corbi (Korbi), Corbelli (Korbelli).

Grisonisi (Grizonizi).

Leza, Nella, Pistoya (Pistoja).

### **San Lorenzo Del Vallo.**

Alfano.

Barbato, Barbati, Blances (Blance), Brescia (Breshia), Bretta, Chiodo (Kiodo), Camodeca (Kamodeka), Como (Komo), Coranezi (Koraneci), Costrono (Kostrone), Costa (Kosta).

Dorsa.

Lanza (Lanca).

Mangiacavallo (Manxhiakavallo), Manisi (Manësi), Melicchio (Meliko), Misuraca (Mizuraka), Molfa.

Osmato (Ozmato).

Piza (Pica – Pici)

Ribecca (Ribeka). Rotondò.

Scalera (Skalera), Sgroi, Staffa.

Yelma.

Tucci (Tuçi), Turchio (Turku).

### **San Giorgio Albanese – Shen Gjergji i Albanezeve.**

Bardi (Bardhi), Bellizo (Bellico), Buscia (Bushi),

Camodeca (Kamodeka), Camiscia (Kemisha), Ceri (Çeri), Cerriconi (Çerrickoni), Chirigò (Kirigo), Cuccia (Kuçia), Canavè (Kanavè),

Cadicamo (Kadikamo).

Dramis.

Gorchilan (Gorkilani).

Masci (Mashi), Masi (Mazi).

Pangrati (ndofta Progonati), Posito (Pozito).

Scandera (Skandera), Scura (Skura), Stancati (Stankati).

### **San Demetrio Corone.**

Bellusci (Bellushi), Bunetto, Buscia (Bushi), Baffa, Bellucci (Belluçi), Bloise, Braile, Bua.

Candrea (Kandrea), Candreva (Kandreva), Cucchia (Kuka), Cuccia (Kuçia), Chiodi (Kiodi), Chiurco (Qirko), Calenzi (Kalenci).

Dayena, Deavolizo (Deavolici), De Rada (nga Makia Albaneze).

Flocca (Floka).

Loscifo (Loshifo), Lopez.

Marcianò (Marçianò), Matranga,

Saracino (Saraçino), Sarro, Sarrachino (Sarrakino), Saraceno (Saraçeno), Stamato.

Tocci (Toçi).

Papada

Patitucci (Patituçi), Strigari.

Yanizza (Janica, ose Jannuci).

### **Santa Sofia D'Epiro.**

Argondizzo (Argondico – kjo familje është shuar).

Baffa, Barci (Barçi), Brescia (Breshia), Bisulera, Bugliari (Bujari),

Becci (Beçi).

Clanaro (Klanari), Curcio (Kurçi – familje e shuar), Como (Komo),

Camidè (Kamide)

Elmo.

Guido.

Maierà, Macri (Makri), Marchianò (Markiano), Masci (Mashi),

Miracco (Mirako).

Scorza (Skorca).

Fise të shuara: Andropulo, Argondizzo, Blescior (Bleshi),

Candiopulo (Kandopulo), Cucci (Kuçi), Dandes, Archipoli

(Arkipoli).

Familje fisnike: Bugliari (Bujari), Baffa-Trashi, Masci (Mashi).

## **Spezzano Albanese – Specano Albaneze.**

Avato.

Barbato, Basta, Bellusci (Bellushi), Brunetta, Barci (Barçi), Blundo (Bundo ?).

Candrea (Kandrea), Cucci (Kuçi), Cacosca (Kakoza), Camodeca (Kamodeka), Cassiani (Kasiani), Cadicamo (Kadikamo).

Dorsa.

Fraschino (Frasheri).

Liguori, Luci (Luçi).

Mortati, Molfa, Yora (Jora), Manes, Marchianò (Markianò), Masci (Mashi), Marini, Melicchio (Meliki), Musacchio (Muzaka).

Nemoianni, Nociti (Noçiti).

Occhineri (Okineri).

Patitucci (Patituçi).

Ribecco (Ribeko), Reris.

Staffa, Scorza (Skorca).

Tocci (Toçi).

Famiglie fisnike: Amerise, Candrea (Kandrea), Cassiani (Kasiani), Corrado (Korrado), Cucci (Kuçi), Reris, Manesi, Mortati, Musacchio (Muzaka), Nociti (Noçiti), Staffa, Tocci (Toçi).

## **Frascineto.**

Arcuri (Arkuri), Blaiotta, Braile, Bellizzi (Belici), Barbati, Buono, Colacino (Kolaçino), Cantisani (Kantizani), Copparelli (Koparelli), Chidichimo (Kidikimo), Camodeca (Kamodeka), Ferrari, De Paola, De Marco (Marko), Ghesce (Geshe), Dorsa, Di Pace (Paçe), Di Tommaso, Frascino (Frashino), Groppa, Jeronimo (Jeronimi), Laurito, Lateano, Laleinna, Masci (Mashi), Maurello, Mirante, Pace (Paçe), Nocito (Noçito), Patitucci (Patituçi), Parapugna (Parapunja), Rinoli, Rodotà, Scutari (Skutari), Sculacchio (Skulakio), Spata (Shpata), Todaro, Troiano, Tocci (Toçi), Zuccaro (Xukaro), Zinnara (Xinara).

Frashinotë të shquar në historinë e Italisë:

- Bellusci Michele: prift, shkrimtar dhe poet.
- Imzot. Bellusci 1774-1833, I peshkev i ngarkuar per albanezet e rritit ortodoks.
- Dorsa Vincenzo, profesor, filosof e filologo, pedagog i gjuhëve latine e greke në Liceun "Telesio"
- Bilotta Bernardo: prift, shkrimtar, poet, 1843-1918.
- Arcuri Costantino (Kostantin Arkuri): Poet, 1810-1871.
- Parapugna Achille (Akile Parapunja): Shkrimtar 1855-1883.
- Pace Muzio 1797-1865: Patriota, deputet ne parlament.
- Pace Vincenzo: Patriota, keshilltar i provinces, deputet ne Parlament.
- Arcuri Peppino (Pepino Arkuri): avokat penalist dhe civilist etj.

## **MBIEMËRA ALBANEZËSH DHE ARVANITËSH KORONEI TË ARDHUR NGA MOREA NË VITIN 1534.**

Airò, Altimati, Archipoli (Arkipoli), Aricciopoli, Arcuri (Arkuri), Argandizza (Argandica), Avet

Beffa, Bariha

Cabiceli (Kabiçeli), Cacossa (Kakosa), Codra (Kodra), Camarda (Kamarda), Camodeca (Kamodeka), Cenadè (Çenade), Chefalo (Kefalo), Chiafadriza (Qafdriza), Chinigò (Kinigò), Ciriaco (Qirjako), Clemendi (Kelmendi), Cuchisi (Kukesi), Culla (Kulla), Cortese (Korteze).

Damis, De Marco (Marko), De Marchis (Markis), Deragò, Despoti (Dhespoti), Dregòti (Dragoti), Dremis, Grimolizza (Grimolica).

Hekali.

Jannuzzi, Jerovante

Lara, Lascari (Laskari), Laurito, Leucadito (Leukaditi), Licomati (Likomati), Loprete, Lopez, Luràsi (Lurasi – ose Luarasi ??).

Macripòdi (Makripodi), Majerà, Majda, Melizì (Melici), Marchianò (Markianò), Matranga, Metrangolo, Mauro, Mauricchio (Maurikio), Metanò, Mazzuca (Maxuka).

Papalà, Pancrezio (Pankrecio), Pescadòpoli (Peskadopoli), Pizarra (Pizarra), Pizarri (Pizarri), Provetà, Policastro (Polikastro).

Rada, Rodotà, Schirò (Skirò), Santojanni, Siròpoli, Straticò (Stratikò), Stratigò (Stratigò).

Tocci (Toçi), Traggina (Traxhina ose Tragjasi ???), Virga, Zaccaro (Xakaro – ose Xagari).





## KOSTANTIN ARIANITI – KOMINATA – KOMNENI

Historia e jonë nuk kufizohet vetëm në trojet ballkanike të banuara nga albanezo-shqiptarët, por ka qene dhe është e pranishme e aktive nëpër botë, në shumë vende fqinje dhe të largëta, çka dëshmohet me historitë e popujve, që i kanë bujt bashkatdhetarët tanë.

Në periudhën e mesjetës bizantine, gjatë invazionit sllav dhe pushtimit turk, shumë albaneze emigruan në vendet fqinje, ku u sistemuan, mbijetuan dhe u organizuan duke ruajtur identitetin, kulturën, gjuhën dhe traditat e vendit të origjinës, madje nuk kanë reshtur të mbrojnë çështjen tonë kombëtare dhe njekohësisht, kanë qenë protagonistat të historisë të vendeve bujtëse.

Albano – shqiptarët e emigruar kanë dhënë kontribute në historinë e Anglisë, Argjentine, Australisë, Austrisë, Bullgarisë, Egjiptit, Francës, Greqisë, Italisë, Irakut, Jemenit, Jordanisë, Libanit, Libisë, Kanadas, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Rumanisë, Sirisë, Sllovenisë, Spanjës, Tunizisë, Turqisë, Ukrainës, USA, etj.

Pas pushtimit turk, në shekujt XIV - XVII, trojet tona u tronditën nga eksode masive, që çuan në largimin nga vendlindja të më shumë se 300 000 albanezëve, të cilët kryesisht u vendosën në Itali.

Fisniket dhe një pjesë e popullit, që i kundërshtoi pushtuesit otomanë, u detyruan të emigrojnë, për t'i shpëtuar persekutimeve dhe masakrave barbare të turqeve, por dhe për të ruajtur besimin e krishterë.

Komuniteti arberesh, që jeton prej mbi 5 shekuj në Itali, i ka ruajtur traditat, kulturën dhe gjuhën e bukur albaneze, që me të drejtë Prof Françesko Altimari e quan *dialekti arbërisht*, pasi është gjuha, që e flasin albanezët në shekujt XIV – XV dhe vazhdojnë ta flasin e ta shkruajnë arbereshët. Pra arbërishtja ka ekzistuar krahas dy dialekteve gegënisht dhe toskënisht.

Arbëreshët kanë nxjerrë figura të shquara, me kontribute në historinë e Italisë dhe ndërmjet tyre shquhet Kostantin Arianiti – Kominata – Komneni, pinjoll i familjes fisnike të Arianitëve.

## **Kush janë Arianitët?**

Arianitët, përmenden në kronikat bizantine të shekullit IX, si fise malësore, që jetonin në lindje të Themës së Durrësit.

Në shekullin XI, Arianitët rezultojnë zotëtrite trevave në rrjedhen e sipërme të Shkumbinit, në të dy anët e rrugës Egnacia, pra te Çermenikes, Polisit dhe Shpatit, por në shekujt XII - XV u zgjeruan dhe përfshinë Tomadhean, Dibrenë, Librazhdin, Mokrën (Mochino), Manastirin, Follorinën e më pas Mallakastrën, Vlorën dhe Kaninën.

Për sa i përket etimologjisë të emërtimit *Arianiti*, disa historianë mendojnë se e ka origjinën në fjalën indoeuropiane “*arya - fisnik*”, të tjerë thonë se rrjedh nga fjala albaneze “*ara*”, por me bindës është mendimi se lidhet me emërin e tribuve ilire *Arinstae* (Ariste), që në periudhën helene dhe romane, banonin në trojet e shtrira në pjesën e sipërme dhe në të dy anët e segmentit qendrorë të rrugës antike Egnacia.

Në shekullin e XIV, rezulton se familja Arianiti filloi të përdori dhe mbiemërin Komneni, homonim i familjes perandorake bizantine të Komnenëve, por kanë përdorur dhe mbiemërin Shpata, si shprehje e të drejtës si zotërit e trevës malore të Shpatit.

Disa pjestarë të familjes Arianiti, në shekullin e XIII përdorën mbiemërin Golemi, si rezultojnë në dokumentat e kohës fisnikët *Arianit Golemi de Albania dhe Arianites Thopia Golemus* e më pas *Miosi Golemi* i biri i Muzak Arianitit.

Një pjesë e medievalistave mendojnë se mbiemëri Golem është me origjinë greke Golemis, por pa spjeguar lidhjen, disa thonë është me origjinë sllave, që do të thotë “i madh”, të tjerë e spjegojnë me prejardhje nga ebraishtja Golem – gjigand, por shumica insistojnë se është deformim popullor i emërit Gulielm, mendim më bindës ky, sepse në dokumentat e shekullit XIII zot i Arbanon quhej Gulem Arianiti dhe nga kjo kohë, pasardhësit e tij, mbajnë këtë mbiemër.

Dihet se populli ynë e ka në traditë, që emëri i babait të bëhet mbiemër i djemëve, kështu Gulielm – Gulemi – Golemi, u trashëgua në gjeneracionet e tjera të dinastisë si mbiemër shtesë.

Eksponenti i parë i kësaj dinastie, i dokumentuar në shekullin e XI është David Arianiti, i cili në vitet 1001 - 1018, ishte strategu i Thema te Selanikut (Maqedonise), ne sherbim te Perandorit bizantin Bazili II, i cili më pas e transferoi strateg të Shkupit, ku organizoi rezistencën kundër sulmeve të barbarëve bullgarë.

Në vitet 1049 - 1050 në shërbim të Perandorit të Bizantit, rezulton dhe Kostantin Arianiti, ndofta i biri, ose kusheri i Davidit.

Kostantin Arianiti u shqua në luftën kundër Pecenegheve, një tribu nomade turke, e cila në shekullin e XI, zbritën nga stepat dhe sulmuan trojet verilindore të Pernadorisë Bizantine.

Në vitet 1190 - 1255, Arianitët u bashkuan me Shtetin e Albanisë të dinastisë Progoni. Në këtë kohë, sipas ipeshkevit dhe historianit William of Tyre (1130 – 1189), nga familja e Arianiteve permendet fisniku Iohannes Carianica, pra mbiemër, që më pas u shndërrua në emërin e trevës Çermenika.

Në vitin 1253, në kronikat bizantine përmendet Gulem Arianiti, zoti i Albanon, i cili ishte i martuar me Irena Komnena, kushërira e gruas të perandorit të Bizantit Engjëll Komnenit, për çka mendohet se ky është motivi, pse kjo familje përdori mbiemërin perandorak Komneni. Nga kjo martesë u perdor më pas dhe mbiemri Golemi.

Në vitin 1300, princi Budares (*Comneni Budaresci princeps*), u martua me një vajzë të familjes Golemi të Krujës dhe në vitet më pas, rezulton se familja Arianiti përdori dy mbiemërat, Komneni dhe Golemi, si rezulton në kronika dhe dokumentat e shekullit XV.

Në vitin 1452, në një dokument të kancelarise te Mbretit Alfonsi V Aragona, rezulton emeri *Aranit Golem de Albania*, ndersa Marin Barleci (1506 – 1510) permend fisnikun *Arianites Thopia Golemus*. Në dokumenta të ndryshe, familja Arianiti perdor disa mbiemera: *Komneni, Golemi (Gulemi), Topia, Shpata dhe Carianica (Çermenika)*, të shoqëruar me titujt e fisnikërisë, sidomos me titullin princ.

Në vitin 1267, Arianitët janë ndërmjet 17 familjeve fisnike arbërore, që bashkëpunuan me Karlin I, për themelimin e Mbretërisë të Albanisë (1267 – 1373).

Në vitin 1274, në marrëveshjen e Karlit I, me fisnikët albanezë, ndër firmëtarët e aleancës rezulton dhe Aleks Arianiti, me titullin sebast. Në dy dokumenta të viti 1304, të Princit Filipi Anzhù i Tarantos - Dominus Regum Albaniae (1294-1331) dhe Karli II Anzhù, Arianitët janë në listën e 16 fiseve kryesore arbërore, të cilëve u njiheshin privilegjet dhe e drejta e vetëqeverisjes në trojet e tyre: *“Filippi, princi i Tarantos ... i garanton privilegjet fiseve albaneze: Albët, Aranitët, Kotarukët, Shpatët, Buzezijët, Markezët, Turbacejt, Lecenët, Skura, Zenevisët, Logoreskët, Matesët ... etj”*.

Në vitin 1319, Papa Gjoni XXII, u dërgoi një letër fisnikëve albanezë, ndërmjet tyre edhe protolegatit Gulielm Arianiti, ku iu bënë thirrje të bashkohen për organizimin e kryqezatës antiserbe.

Kjo letër e Papës, dërguar Gulielmit, dëshmon pozicionin e lartë politik, administrativ, shoqëror dhe fetar të Arianitëve.

Në vitin 1373, emëri i një pjestari të familjes Arianiti, gjëndet i qendisur në epitafin e Gllavinicës. Ky epitaf është i rrallë, një ndër tre punimet e këtij lloji të njohura deri sot në botë.



Epitafi i Glavenices – mars 1373

Në qendër të epitafit është i qendisur trupi i Krishtit të vdekur, i shtrirë mbi një çarçaf, i rrethuar nga shenjtorë, serafinë dhe engjëj.

Ky epitaf ka mbetur mister për studiuesit, të cilët po perpiqen të zbulojnë diçka më shumë rreth historisë së krijimit të tij, por edhe të teknikës të realizimit.

Epitafi i Gllavinicës është objekt me vlera i kulturës mesjetare shqiptare, është një margaritar i krishtërimin, i historisë, i artit dhe i mjeshtrise artizanale albaneze.

Epitafi është i konceptuar si pikturë, andaj mjeshtri i ka përdorur të gjitha elementët e pikturës, si larminë e ngjyrave, dritë-hijet, madje dhe një pikë imagjinnare drite, që e ndriçon gjithë epitafin duke i dhënë vezullim qiellor.

Në buzët e epitafit është shkruar: *"U plotësua (u qëndis) ky areas (epitaf) i gjithë nderuari dhe i hyjshëm i së mbishenjtës Hyjëlidësë të patundur, me shpenzimin dhe mundimin e episkopit të gjithëhishëmit Kalisi i Glavinicës dhe Beratit, në muajin mars 22, viti 6881 (1373). Ti që zotëron jetën, ah! Si je trup i vdekur pa frymë. Në kohën e zotërimit të zotëve të shumëlartë të Serbisë, Rumanisë dhe gjithë Albanit dhe të vëllezërve Gjergjit dhe Balshës. Dora e Gjergj Arianitit dhe arëqëndisësit".*

Si kuptohet, një ndër mjeshtrit e punimit të epitafit është murgu Gjergj Arianiti, i cili ka vënë të qendisur emërin dhe njëkohësisht dëshmon përkatësinë nga familja Arianiti.

Emërtimi i këtij monumenti si "Epitafi i Glavinicës" nuk është i saktë? Vetë mbishkrimi i Epitafit nuk e mbart aspak këtë emërtim. Emërtimi ka lidhje me ipeshkevin Kalis, të ipeshkëvisë së Glavinicës dhe Beratit, pra nuk ka të bëjë me vendin ku u thur dhe u ekspozua për të parën herë Epitafi. Emërtimi i Ipeshkëvisë nuk dikton emërtimin e objektit.

Në mbishkrim del qartë që Epitafi është porositur në vitin 1373, në kohën e zotërimit të dy princërve shqiptarë të familjes princërore Balshaj, Gjergjit dhe vëllait të tij Balsha i Dytë. Pra ky Epitaf mund të quhet në mënyrë llogjike si "Epitafi i Balshajve".

Nga mbishkrimi dimë se kisha ku është vendosur Epitafi dhe e ka poseduar këtë kryevepër i kushtohet Shën Marisë, "Hyjëlidësë së

*patundur*”, si thuhet në mbishkrim. Padyshim që kjo kishë e Shën Marisë ishte shumë e rëndësishme, por ne nuk e dimë ku ndodhej? Dimë me siguri se kisha titullare e Ipeshkëvisë në shekekullin XIV ndodhej pikërisht në Berat dhe nuk përjashtohet mundësia të jetë e kësaj kishe. Dokumentet heshtin për Glavinicën si qendër kishtare në shekekullin XIV.

Nga pikëpamja stilistike ikonografia e Epitafit i takon risisë artistike të stilit paleolog, por përmban disa veçori, që sugjerojnë se mund të jetë punim autokton albanez

Përgjithësisht është normë ikonografike që në epitafët bizantinë, mbi kokën e Krishtit të zbritur nga kryqi të jenë figurat e tri Marive, me afërsia hyjnore dhe intime të Shën Marisë Nëna me të Birin, Krishtin. Kjo formulë ikonografike ka një element të theksuar femëror, gjë që lidhet me kultin Marian, karakteristikë e Kishës Lindore, me një ndryshim konceptual ikonografik me Kishën Perëndimore.

Në Epitaf, figura e Shën Marisë është vënë në një medaljon të vogël anash dhe simetrikisht në një medaljon tjetër të vogël, është vënë Maria Madalena dhe në tjetrën Maria Salomë.

Figurat kryesore mbi kokën e Krishtit janë mashkullore, Moisiu në moshë të re, Profeti Isaia dhe Josifi i Arimatesë. Mungon në këtë kuadër figura e Gjonit Ungjillor, që është gjithnjë i pranishëm pranë tri Marive në Epitafet me formula ikonografike bizantine.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm ikonografik është se fytyra e Krishtit është e një djali të ri, me pak mjekër dhe me mustaqe të holla, jo sipas arketipit të rëndomtë të ikonografisë të fytyrës së Krishtit në ikonat e stilit Bizantin.

Fytyra e Krishtit në këtë Epitaf, sipas Moikom Zeqo, të kujton ikonografinë e Krishtit në miniaturat e kodikëve francezë koraliane. Është harruar fakti se dy kodikë me origjinë nga Vlora, shekullit XII, që ruhen në AQSH, kanë miniatura, që lidhen me artin e Europës Perëndimore, si i ka klasifikuar shkencëtari Theofan Popa.

Persa i perket murgut Gjergj Arianiti ka mundësi të ketë qenë si mjeshtri i prodhimit të epitafit dhe formuluesi i mbishkrimit.

Bazuar në këto veçori, është më e sakte te quhet Epitafi i Balshajve, sepse ata janë zotërit politikë të zonës, apo të Kishës ku është vendosur për herë të parë Epitafi.

Emërtimi i Epitafit si i Glavinicës është bërë nga Theofan Popa, bazuar në një legjendë popullore në fshatin Breshtan në fillim të shekullit XX. Është e pa saktë, që ky Epitaf të vazhdoi të emërtohet në mënyrë rutinore, pa asnjë bazë, si Epitaf i Glavinicës.

Epitafi ka një varg poetik, që i drejtohet në vetën e dytë Krishtit, një varg që mban dhe një pasthirmë: *“Ti që zotëron jetën ah! Si je trup i vdekur pa frymë!”*

Në fillim dhe në mbarim të këtij vargu është vendosur nga një kryq, por jo thjesht si ndarje ortografike. A është ky varg i kopjuar nga poezia kishtare biblike apo është original? Këtë gjë nuk e dimë.

Analizat laboratorike dhe kimike e ndriçojnë strukturën e këtij objekti; por nuk dimë origjinën e mëndafsheve të Epitafit, por dimë se teknologjia e qëndisjes me ar është e nivelit të lartë, siç është një stil i shkëlqyer realizimi me ndjeshmëri i strukturës ikonografike. Si rezulton nga mbishkrimi, kjo veper është prodhuar mjeshterisht nga murgu Gjergj Arianiti dhe nga një mjeshter tjetër, që ka realizuar punimet me fije ari, pra nga *arëqëndisësi*.

Aktiviteti politik i familjes të Arianitëve, është i mirë dokumentuar në shekullin e XV, kur u shquan në organizimin e rezistencës antiturke, e kurorëzuar me çlirimin e trojeve të gjëra të principatës nga pushtuesit osmanë.

### **Princi Gjergj Arianiti Komneni Spata.**

Figura qendrore e me rol në këto vite të vështira, nën kërcinimet e vazhdueshme të hordhive osmane, është:

*Princi Gjergj Araniti Komneni Spata (1376 – 1462).*

Sipas Marin Barleci dhe Gjon Muzaka, i ati i Gjergj Arianiti ishte *Kommen Arianiti* dhe nëna e bija e Nikolla Zakaria, zoti i qytetit-port Budua.

Ne disa nder burimet historike bizantine, thuhet se i ati Komnen Arianiti, mbante dhe mbiemërin Spata (*Arianit Spatensis*)

Gjergji kishte dy vellezër Muzaka dhe Vlladani, si dhe një motër, që ishte e martuar me Pal Dukagjinin.

Gjergji u martua me konteshën Maria Muzaka, e bija e Andrea III Muzaka, dhespoti i Epirit, Zoti i Devollit, Muzakisë dhe i Himarës. Nga kjo martesë, Gjergji mori pajë trojet nga Mallakastra deri në det, përfshi Vlorën dhe Kaninën.

Principata e gjërë e Arianiteve kishte dy kryeqendra, njera më e vjetra ishte Sopoti i Polisit dhe tjetra, ishte Kanina.



Shen Angjelina Arianiti – Muzaka – Brankoviç.  
Shen Nena Angjelina.

Nga martesja e Gjergj Arianitit me Maria Muzaka, lindën 6 vajza:

- Andronika Arianiti, u martua me Gjergj Kastriotin.
- Vojsava, u martua me princin Crnojević të Malit të Zi.
- Kirana, u martua me Nikolla Dukagjinin.
- Helena, u martua me Gjergj Dukagjinin.
- Angjelina, u martua me Car Stefan Brankoviçin e Serbisë.



Angjelina ishte besimtare e devotehme, frekuentonte rregullisht kishen dhe impenjohej në vepra bamirësie, në ndihmë të varfërve. Kisha ortodokse e ka shpallur shenjetore dhe nderohet si Shen Nëna Angjelina.

Në 4 dekadat e para të shekullit XV, Principata e Arianitëve, me në krye Gjergj Arianitin u bë epiqendra e luftës antiosmane.

Në vitet 1430-1436, Princi Gjergj Arianiti organizoi kryengritjen antiturke, që u kurorëzua me çlirimin e trojeve të principatës të Arianiteve dhe me largimin e spahinjëve dhe timarlinjëve osmanë. Për shtypjen e kesaj kryengritje erdhi vete Sulltan Muratin II, i cili organizoi disa ekspedita kundër Arianitëve.

Në vitin 1430, në betejën e parë në Byshek të Elbasanit, ushtria turke e komanduar nga Ali Beu, ish sanxhakbeu i Arbërisë, u shpartallua nga luftëtarët e Gjergj Arianitit.

Kjo ishte fitorja e parë e albancëve kundër ushtrisë së fuqishme osmane, për të cilën kronisti bizantin Halkokondili, shkruan: *“Kjo fitore i sollti lavdi të shkëlqyer organizatorit të saj, Gjergj Arianitit, që u bë figura qendrore e jetës politike shqiptare e viteve ‘30”*.

Kryengritjet e Gjergj Arianitit, nxitën dhe princat e tjerë të ngrihen kundër pushtuesit turk.

Në veri, luftëtarët e Nikollë Dukagjinit morën kështjellën e Dëjës, në qendër Andrea Topia nuk mundi ta çliroi Krujën, kurse në jug Depë Zenebishi, zoti i Gjirokastrës, pësoi disfatë dhe komandanti i ushtrisë arbërore, u kap rob dhe turqit e varën.

Gjatë vitit 1434, Gjergj Arianiti korri fitore të tjera. Në shkurt shpartalloi forcat e Sinan Pashës, bejlerbeut të Rumelisë dhe në dhjetor ushtrinë e Isak Beut, sanxhakbeut të Shkupit, ndërsa më 20 prill 1435 korri një fitore të re, pas së cilës sulltan Murati II i ndërpreu ekspeditat kundër tij.

Fitoret e Gjergj Arianitit, e rritën besimin dhe vendosmërinë e albancëve për të mbrojtur lirinë e për të luftuar kundër pushtuesit të fuqishëm otoman.

Këto fitore kundër turqëve, patën jehonë të gjerë në Europë dhe

sidomos në Vatikan. Mbreti i Hungarisë, Sigismundi, bëri marrëveshje me Gjergj Arianitin dhe me Andrea Topia, për të luftuar kundër pushtuesve osmane, por përpjekjet e tyre për organizimin e një kryengritje të përgjithshme antiosmane, nuk patën jehonë në vendet e tjera të Ballkanit dhe të Europës.

Më 2 mars 1444, Princi Gjergj Arianiti mori pjesë në Besëlidhjen e Arberit në Lezhë, ku mbështeti fuqishëm Gjergj Kastriotin me aleancën me princat albanezë dhe luftoi krah tij, në të gjitha betejat kundër pushtuesve osmanë.

Ne vitin 1449, i vdiq gruaja Maria Muzaka.

Pak kohë më pas, Princi Gjergj Arianiti u martua me baroneshen italiane Petrina Frankone, e bija e Oliviero Frankone, baroni i feudit Taurisano - Pulja dhe mëkëmbës i Mbretit të Napolit në Pulja.

Nëna e Petrinës ishte arbëreshe, e bija e Zakarias, princi i Mores.

Nga martesë me Petrinën (disa e quajne dhe Despotina), lindën katër fëmijë, tre djem: Tommasi, Kostantini, Arianiti dhe një vajzë Maria Arianiti.

Gjergj Arianiti dhe pse i moshuar, vazhdoi të komandoi malësorët në luftimet kundër sulmeve turke, si shprehet raspodi në sagen e Gjorg Arianitit, e cila këndohet prej 550 vite nga banorët e Sopotit (Polisit), të Librazhdit, të Shpatit, të Çermenikës e më gjërë, duke evokuar heroizmin e Princ Arianitit dhe të malësorëve trima.

*Ky Sulltani qan me lot,  
Kam dhe një Skender në Sopot,  
Flakë në mal dhe flakë në breg  
Gjorg Golemi thotë jam mbret...*

Historiani J. De Lavardin në veprën “*Histoire de Scanderbeg*” botuar në vitin 1621 shkruan: “*Gjergj Arianiti ishte burrë i mençur, me rrënjë të lashta fisnikërie, me autoritet të madh, i aftë dhe me sens praktik në artin ushtarak. Ai kishte trup të fortë dhe bukuri të fytyrës, që çmoheshin shumë nga populli. Gjergj Arianiti konsiderohej me i madhi ndërmjet albanezeve dhe maqedonasve*”.

Principata e Arianiteve nuk u pushtua, andaj ishte objekt i sulme-

ve të vazhdueshme të ushtrisë Osmane. Ne ato vite, nje nga ekspeditat turke kunder Principates te Arianiteve, u thye rëndë në Shalës të Elbasanit. Për të festuar këtë fitore, Princ Gjergji dhe luftëtarët e tij, shkuan në kishën e Shen Marisë në Galigat të Shpatit, ku më 8 shtator organizohej panairi i të premtës të Shen Marisë, si tregohet dhe në sagën e Gjergj Arianitit:

*Gjergj Golemi trim me fletë,*

*N'Galigat shkon dy net,*

*N'Galigat, për Shen Meri*

*Do të shkoi me gjithë ushtri.*

Komandanti i ushtrisë turke, i informuar nga një tradhëtar albanez për largimin e luftëtarëve, u kthye nga rruga e ikjes dhe e sulmoi Sopotin e pambrojtur, duke e djegur, plaçkitur dhe masakruar të gjithë banorët. Gratë dhe vajzat e Sopotit, për të mos rënë në duart e turqeve u vetesakrifikuan, duke u hedhur nga shkemb i në humnerë.

Këtë ngjarje tragjike, populli e ka mishëruar në këngën heroike të Gjergj Golemit.

Historiani Oreste Parisi, në një studim të vitit 2013, rreth kësaj sage shkruan: *“Kjo këngë nuk është vajtje për tragjedinë e madhe, që e goditi popullin e Sopotit, por është këngë krenarie, gati një sfidë, është guximi i malësoreve, heroizmi i tyre ..... dhe nga ana tjetër perçmimi për pushtuesit ....”*

Në këtë këngë epike me 55 vargje, janë ndërthurur faktet historike me rrëfenjat popullore, që së bashku na ofrojnë të dhëna interesante rreth familjes fisnike të Arianitëve.

Pasi evokon meritat e Princit Gjergj Arianiti në luftën kundër pushtyesve turqë, por dhe për paqen e miresine, që mbreteronin në Sopot, rapsodi flet për ngjarjen tragjike, që goditi Sopotin dhe këtë e tregon nëpërmjet fjalëve të Maria Arianiti, vajzës së vogël të Gjergj Arianitit.

.....

*Zot, Maria ka nje fjalë,*

*Mu te mani paska dalë,*

*Ti o princ, mos hyp në kal,  
Do vij turku me na marrë.  
Ndal o At, ku po shkon,  
Do vij turku, na pushton,  
N'Mollë të Kuqe ai na çon.  
Pashë një ëndërr këtë natë,  
Sopotit na mori flakë,  
Ti o At degjomë këtë herë,  
Se vjen turku e na ther.*

Me fjalët e Marie Arianitit, rapsodi ka përdorur mjeshtërisht elementet Homeriane të Iliadës, pikërisht profecinë ndjellakeqase të Andromakës. Maria, ashtu si Andromaka, parathotë tragjedinë, që do të godasi rëndë malësorët e pambrojtur të Sopotit.

Gjithëçka ndodhi atë ditë të shtunë.

Masakrën makabre të barbareve turq, poeti popullor na e tregon thjesht, por dhimbshëm nëpërmjet thirrjes dëshpëruese të prince-shës Maria Arianiti, drejtuar të Atit, në vazhdim kuptohen pasojat.

Në kontrast me tragjedinë, poeti popullor shpreh dhe guximin e malësorëve, burrave dhe grave sopotare, që luftuan me heroizëm kundër turqëve, madje e tregon me krenari si një sfidë të rrallë.

*Mark Milloshi në Liqe,  
Luan shpatën posi dre,  
Luan shpatën si dragoji,  
Dhe turqit i coptoi.  
Sopotare moj të ngrata,  
Rrokni thika, rrokni shpata....*

Në këtë fund tragjik, Maria Arianiti, duke i u drejtuar të Atit, shpreh dhimbjen dhe mallin për të vëllanë, i cili nuk ishte në Sopot e pas kësaj ngjarje, rapsodi thotë se nuk do të takohen kurrë, pasi ai ishte në Itali, ndërsa Maria u mor robinë nga turqit.

*Gjel Çelikun, foshnje të ri,  
Na e çove në Itali....*

Tragedia e Sopotit, kujtohet me dhimbje të thellë dhe si mallkim

nga sopotaret që në ato vite emigruan në Itali, si tregon Antonio Bellusci, duke komentuar një këngë popullore të kënduar nga arbereshët, që banojnë në komunën e Santa Sofia di Epiro ne Kalabri. Pas masakres të turqeve në Sopot, emeri i Maria Arianitit nuk përmendet, por nga kënga kuptohet se ajo ishte robinë kur thotë: “*N’Moll të kuqe ai na çon*”, pra në kuptimin se do ta dergojnë prapa diellit (Molla e Kuqe në traditën popullore është dielli).

Sipas legjendave, komandanti turk e dorëzoi Marien në oborrin e Sulltan Mehmetit II, madje thuhet se u bë Sulltaneshë dhe lindi një djalë, i cili u bë Sulltan Bajaziti II, pra ky sulltan mizor, rezultoi se duhej të ishte i nipi i princit Gjergj Arianiti. Në fakt këto janë vetëm legjenda të stisura nga populli, pasi e verteta është ndryshe.

Si theksova më sipër, Princi Gjergj Arianit kishte tre djeme, i dyti quhej Kostantini Gjergjit, por nga kjo sagë kuptohet se quhej dhe Gjël, që është forma e shkurtër dhe përkëdhelëse e emërit Gjergj.

Ekzistenca e dy emerave është dukuri e zakonshme në popullatën e krishterë albaneze, pasi njeri ishte emeri i parë pas lindjes, që zakonisht ishte emëri i njerit prej pararendësve më të shquar të familjes dhe i dyti ishte emëri i pagëzimit në kishë.

Kjo praktikë e dhënies të dy emerave, praktikohet rregullisht dhe në ditët e sotme si në Polis dhe në Shpat.

### **Kostantini Arianiti – Kominata – Komneni**

Pas vitit 1456, Princi Gjergj Arianiti, bashkëshortja Petrina dhe fëmijët u vendosën në Durrës, që si dihet ishte nën zotërimin e venedikasve, pra kaluan në mbrojtje të Republikës të Venedikut.

Në Durrës, në vitin 1456 lindi Kostantini, djali i dytë i Gjergj Arianitit me Petrina Frankoni, ku mori mësimet e para dhe më pas e dërguan të gjyshat në Itali.<sup>c</sup>

Tomasi nuk u martua, ishte shëndetlig dhe vdiq në vitin 1484, ndërsa Arianiti, pasi jetoi disa vite në Itali së bashku me të ëmën, preferoi të rikthehet në Albania, ku u konvertua në myslyman, duke u shpërblyer nga Porta e Lartë, me detyra të larta ushtarake, por

pati perfundim tragjik, pasi mbeti i vrarë nga bashkatdhetarët, gjatë një ekspedite ushtarake kundër malesorëve albanezë në Himarë.

Rrëfenjat popullore thonë se Gjergj Arianiti i kaloi vitet e fundit të jetës në malet e Principatës, duke luftuar kundër turqëve, ndërsa në realitet ai u vendos në Durrës, si rezultat nga burimet arkiviale veneciane (*ASVe, Senato Mar, vol. VII: c. 23*).

Në një dokument të vitit 1457, rezulton se Dozha i Venecies, i kishte dhënë urdhër të posaçëm Paolo Kuirini (Quirini), Bailò dhe Kapidani i Durrësit: "... të perkujdesesh me prioritet për familjen e Arianiteve".

Princi Gjergj Arianiti vdiq në vitin 1462 në Durrës dhe u varros në katedralen e Shen Maria të ipeshkevisë së Durrësit.

Baronesha Petrina Frankone Arianiti Komnena e mbetur e vë, së bashku me të tre djemt, në vitin 1463 u kthye në Itali, fillimisht në trojet e prindërve e më pas shkoi në Venecia.

Pra Kostantini jetoi në Itali, ku bëri emër të mire, si përmendet dhe në historinë e Italisë.

Historia e familjes Arianiti trajtohet në "*Dizionario Biografico degli Italiani*", volume 4 - Roma, i botuar nga Istituto della Enciclopedia Italiana e vitit 1962 (f. 141-143). Autorët *Franz Babinger* dhe *Giorgio Fiori*, e trajtojnë në veçanti figurën e *Kostantin Arianiti Komneni, i cili ka jetuar në pronat e tij, në keshjtjellën Monferrato Conca (Rimini)*. (*Rivista di storia, arte, archeologia per le Province di Alessandria e Asti, CVIII:1999, pp. 67 – 82*).

Baronesha Petrina me 3 shtator 1463, u prezantua para Senatit të Vendikut, ku u kërkoi senatorëve mbrojtje dhe mbështetje për djemt Tomasin, Kostantinin dhe Arianitin.

Më 13 maj 1464, Senati i Venecias, në respekt të miqësisë dhe marrëveshjeve të bashkpunimit me Princin Gjergj Arianiti, i njohu të tre djemëve të Gjergjit titullin *patric venecian*.

Familja e Arianiteve prezantohej publikisht me stemën e vet heraldike, me një strukturë karakteristike: Një mburojë rruzullake si e Akilit, me kornize me ornamente floerale – zambaku tresh, me në

qendër dy shqiponja: Njëra shqiponjë e madhe dy krenare, me krah të hapura gati për fluturim, që mban në kthetra skeptrin në anën e djathtë dhe sferën mbretërore majtas, pra dy simbole mbretërore. Dy kokat e shqiponjës, lidhen me kordon ngjyrë violet, që mbanë një kurorë mbretërore, me kryqin në pjesën e sipërme.

Në qendër, ndërmjet dy krahëve të hapura të shqiponjës, është një shqyt me sfond të arte dhe brenda tij një tjetër shqyt i vogël me një shqiponje me një koke, me veshtrim nga e djathta, me krahët e hapur gati për fluturim.

Ne sfond të shqytit, në anën e djathtë të shqiponjes janë dy arinj, ndërsa majtas tre luanë në ecje, si luani i Kunavise, apo si tre luanet e flamurit të Normanëve. Mbi shqytin qendror është një kurorë tjetër e arte, e zbukuruar me gure të çmuar dhe me perla dhe me kryqin në kulm. Te dy kurorat shprehin lidhjet e Arianiteve me familjen mbretërore bizantine.



Stema heraldike e dinastisë të Arianiteve

Shqiponja dy krenare e Arianiteve e shekullit XIV, gjendet e pikturuar në një ikonë në shpellën e Letmit në Çermenikë, e njohur si treva në zoterimin e Arianitëve.

E veja e Gjergj Arianitit, baronesha Petrina Frankone Arianiti Kominata Komnena, së bashku me djemtë, në fillim të vitit 1463 u kthye në Itali, fillimisht qëndroi në trojet e prinderve e me pas shkoi në Venecia. Më 3 shtator 1463, baronesha Petrina u prezantua para Senatit të Venedikut, për të kërkuar mbrojtje dhe mbështetje për djemt Tomasin, Kostantinin dhe Arianitin.

Ne 13 maj 1464, Senati i Venecias i njohu titullin patrica venecianë të tre djemëve të Gjergj Arianitit.

Pasi Senati Venecian i njohu të drejtat e fisnikerisë të tre djemëve, Zonja Petrina, donte të rikthehej në Salento, në pronat e prindërve në Leçe, por vdekja e Tommasit dhe vrasja e Arianitit e tronditën dhe e detyruan të ndryshoj mendim.

Në vitet 1484 – 1486 baronesha Petrina u transferua në Romë, e ftuar nga Kuria e Selisë së Shenjte, që i akordoi një mbështetje financiare asaj dhe Kostantinut.

Në Romë, Kostantin Arianiti hyri në shërbimin e Papa Sisto IV, ku për aftësi dhe merita, i dhanë detyrën e protonotario apostolik edhe pse nuk ishte klerik, jo vetëm kaq, por nuk kishte prirje dhe as dëshirë për t'i u dedikuar shërbimeve fetare.

Në vitin 1486, Senati i Venecias ia rikonfirmoi titullin e patricit venecian (ASVe, *Misti del Consiglio dei X*, vol. XXI, c. 117v, vol. XXXI, c. 228v, vol. XXXII, c. 229).

Më 11 korrik 1489 Perandori Federiku III, në një letër dërguar Papa Inoçencit III, i konfirmoi mbështetjen e tij në favor të Zonjës Petrina, si dhe të Kostantin Arianitit, i cili pas vdekjes të Papa Sisto IV (1484), i kishte lënë detyrat në Kuria të Vatikanit.

Kostantini u rrit dhe u arsimua në Itali. Në ato vite Italia ishte një shprehje gjeografike, e formuar me një mozaik shtetesh, që grindehin mes tyre, si për divergjencat politike dhe ekonomike dhe për mosperputhje mendimesh dhe kulturash.



Ne mesjetën e vonëshme, në Itali ekzistonin shume shtete të vegjël dhe të medha, të cilët provokonin konflikte, për të vendosur hegjemoninë dhe për të zgjeruar kufijt e trojeve të veta.

Kostantini u rrit e u formua në këtë mejdis social dhe politik, por me pragmatizmin, inteligjencën dhe aftësitë e tij, bëri emër te mirë dhe karriere, u shqua si fisnik, si kapidan dhe si diplomat, për çka hyri ne histori, i përmendur në të gjitha enciklopeditë e Italisë.

Kostantini, që në moshë të re u impenjua në funksione dhe aktivitete të rëndësishme, të shtrira në të gjashtë shtetet e medha të asaj kohe, kësisoj behet protagonist ne:

- Shtetin Papal, ku Papa kishte rolin qendror për Kishen dhe në vizionin e politikës të shtetit të Vatikanit;
- Mbretërinë e Napolit, fillimisht të drejtuar nga Anzhuinet e më pas nga dinastia e Aragonëve;
- Republikën e fisnikëve Medici të Firences;
- Dukatin e Milanos, fillimisht i drejtuar nga fisniket Viskonti e më pas nga Sforca;
- Dukatin e Savojës;
- Republikën e Venecias (Venediku).

Në vitin 1483 Senati venezian i rikonfirmoi djemëve Arianiti titutullin patrica venecian, (*Arch. S. Veneto, Misti del Consiglio dei X, vol. XXI, c. 117v, vol. XXXI, c. 228v, vol. XXXII, cc, 2, 29*).

Në vitin 1484, vdes Tomasi e më pas dhe Arianiti e në këto rrethana dhimbje e trishtimi, baronesha Petrina dhe Kostantini u transferuan në Romë, të ftuar nga Kuria e Selise së Shenjte, që i u akordoi të dyve një pension.

Pas pak muajsh, Kuria Papale e mobilizoi Kostantinin në sherbim të Papa Sisto IV, i cili i dha detyren e *protonotario apostolik*, pavarësisht se Ai nuk ishte klerik, madje nuk kishte as perkushtim fetar. Kur Kostantini u emerua në këtë detyrë, ishte 28 vjeç, çka tregon se Vatikani, ende shprehte respekt dhe nderim ndaj Princit Gjergj Arianiti, që ishte shquar në luftën kundër turqëve, por ishte dhe vlerësim për aftësitë kulturor dhe ushtarak të Kostantinit.

Në vitin 1486 u bashkuan në Itali, dy degët e dinastise Arianiti, Kostantini dhe mbesa e tij, e bukura dhe e mençura Maria Brankoviçi, e bija e të motrës Angjelina Arianiti Komnena dhe e Stefan Brankoviçit, që kishte qenë Cari i Serbisë, por në vitin 1459, pas protestave popullore e braktisi fronin e Carit dhe shkoi refugjat në Viene. Familja e Brankoviçeve u strehua ne oborrin Perandorak te Austrise, kësisoj Maria u rrit dhe u formua në Vienë.

Me nderhyrjen e perandorit Federiku III Habsburg, Marien e martuan me fisnikun e moshuar Bonifaci III Paleologu, Markezi i shtetit të vogël të Monferrato në Padania të Italisë veriore.

Në vitin 1484, Markezit Bonifaci III, i kishte vdekur gruaja e parë kontesha Elena di Bresse dhe po atë vit u martua me të bukurën Maria Brankoviç. Nga kjo lidhje martesore lindën tre femijë, nje vajzë Margarita (1485) e dy djem Gulielmo (1486) dhe Gian Giorgio (1488).

Markezia e re Maria ushtroi rol me rëndesi në drejtimin shtetit të vogël dhe të pasur të Monferrato. Markezi Bonifaci ishte i moshuar e nuk mund të ndiqte të gjitha aktivitete e shtetit te tij, andaj me propozimin e gruas Maria, i kërkuan Kostantinit, të bashkpunonte si administrator. Kostantini e pranoi menjëherë ftesën, kesisoj në vitin 1486 la detyrën e protonotario apostolik dhe kaloi në shërbim të mbesës Maria, markeza e Monferrato, madje u bë personi më i besueshem i Markezit Bonifaci III. Kjo besushmeri vërtetohet dhe në testamentin e vitit 1491 të Bonifaci III, i cili e emëroi regjent të dy djemëve, qe ishin ende të mitur. Markezi Bonifaci III, i vleresoi aftësitë e Kostantinit, kësisoj krahas detyrës të administratorit të shtetit të vogel Monferrato të Padanias, në vitin 1489 e martoi me vajzën e tij Franceska Paleologo, e cila ishte e bija e tij natyrale dhe jolegjitime, por e njohur zyrtarisht nga markezi.

Nga kjo martesë, Kostantini mori nga Françeska një dhunti të madhe, ku përfshiheshin keshtjella dhe troje, që i siguruan një mbeshtetje të fuqishme ekonomike dhe financiare. Besimi, që i dhanë mbesa Maria dhe burri i saj Bonifaci III Paleologo, sidomos

martesa me të bijën e markezit, e bënë Kostantinin figura kryesore e familjes, sa e ngarkuan të administronte drejtimin dhe financën e Monferrato.

Në kohë të shkurtër, Kostantini e forcoi dhe e zgjeroi shtetin e vogël Padan, pasi bleu pothuajse të gjitha trojet për rreth si Suardi, Refrankore, Rivalta. Ne vitin 1492 mori ne zoterim dhe Terruxhia e më pas Tonengo, Morasengo dhe Piazso.

Më 4 mars 1494 vdiq markezi Bonifaci III Paleologo, duke e lënë pushtetin në duart e Maries si regjente dhe të Kostantin Arianitit, i cili më 1499 mori të drejtat e feudalit të shtetit të Monferrato.

Pas vitit 1492, Kostantini krahas mbiemërit Arianiti - Komneni filloi të perdori dhe titullin Princi Maqedonisë dhe Duka i Akaja, çka i ka shtyrë historianet Babinger dhe Fiori, ta quajnë mashtrues, pasi sipas tyre, familja Arianiti nuk i kishte këto tituj.

Megjithë kritikrat për pervehtësimin e titujve nga Arianiti, të dy historianët theksojnë, se këto tituj dhe ofiqe, ia rritën prestigjin dhe shkëlqimin në rradhët e fisnikerisë italiane.

Në fakt, të dy këto historianë gabuan me gjykimet e tyre skeptike. Këto tituj nuk janë abuzive, perkundrazi dokumentohet se David Arianiti ne vitet 1001 - 1018, ishte strateg i Thema të Selanikut, pra i kryeqendrës të Maqedonisë. David Arianiti ishte në sherbim të Perandorit bizantin Bazili II, I cili më pas e emëroi Davidin strateg i Shkupit, ashtu si me vonë, një tjetër Arianit rezulton duka i Akaja. Sipas rregullave te fisnikerise europiane, keto tituj i trashegojne meshkujt pasardhesit te familjes dhe me qe Kostantini ishte i vetmi pinjoll mashkull i dinastisë Arianiti, me të drejtë i gëzonte keto tituj.

Perandori Frederiku III i Habsburgeve, i njihte titujt e fisnikërisë te familjes Arianiti, si rezulton në letrën e 11 korrik 1489, qe i dergon Papes Inocenti VIII, ku i kerkonte të ndihmohej baronesha Petrina, e veja e Gjergj Arianiti - Princit të Maqedonisë. Si kuptohet kemi nje precedent zyrtar, që deshmon njohjen e titullit Princ i Maqedonisë.

Në shumë dokumenta të më vonshëm, disa sovranë të kohës i shkruanin Kostantinin, duke e cilesuar me mbiemërin perandorak

Komneni dhe me titullin e princit të Maqedonise, si shkruan Dozha i Venedikut në letrën e 17 marsit 1509, apo Papa Klementi i VII në letrën e 25 janar 1528 ashtu si dhe Pernadori Karli V, në letrën e 06. shkurtit 1529, që i komunikonte Kostantinut, Princit të Maqedonisë imunitet dhe mbrojtjen nga ana e tij.

Studiuesja Simonetta Angelo Comnena, në librin, "*Storia e genealogia della Imperiale famiglia Angelo Comneno Ducas o Angelo Flavio Comneno Ducas*", botuar në vitin 2007, bazuar në shumë dokumentat të Arkivit të Vatikanit, Venecias, Kostantinopjes etj, tregon se nga familja perandorake Angelo – Komneno, rrjedhin - Jure sanguinis - tre familje fisnike albaneze dhe pikërisht Princi Gjergj Arianiti, Engjelloret e Drishtit dhe familja Toka e Artës.

Si shihet Engjelloret dhe Komnenët kanë të njejtën origjinë, me zanafillë në shekulin XI.

Më 31 gusht 1057, Isak Komneni u kurorzua perandor i Lindjes dhe po atë vit bëri krushqi me familjen fisnike të Angelo (Engjelli), kesisoj Teodora Komnena u martua me Kostantin Angelo (Engjellin), duke krijuar dinastinë Angelo – Comneno.

Lidhjen e Arianiteve me dinastinë perandorake Angelo-Komnena e konfirmojnë dhe shume historianet, si humanisti yne i madh At Marin Barleci në veprën "*De vita, moribus adversus turcas gestis Georgii Gastrioti MCXXXVII*"; At Dhimiter Frangu në veprën "*Comentario de le cose de' Turchi, et del S. Giorgio Scanderbeg, principe d' Epyro*", botuar me 1539; si dhe historiani Françesko Sansovino në veprën më të madhore "*Dell'istoria Universale dall'origine et Imperio de' Turchi*", botuar në vitin 1564, i cili përfshiu në këtë vëllim dhe veprën e At Dhimiter Frangut.

Sansovino shkruan se e bija e Gjergj Arianiti Komneno – Angelo, Doneca Kominata Komnena (Andronica), u martua me princin Gjergj Kastriotin Skenderbeun, pra duke i vendosur si mbiemera të Gjergjit, ai shpreh lidhjen e Arianitëve me familjen perandorake Komneni – Anxhelo (Engjelli)

Origjinën nga familja perandorake Angelo – Komneno, kapëdan

Kostantini e pasqyron qartësisht në stemen e tij heraldike, ku sfondi masiv ngjyre ari simbolizon origjinën nga Angelo (Engjelloret), fashat e zeza dhe shqiponja dykrereshe, me kurorat perandorake, me skeptrin e artë në kthetrën e djathtë dhe sferën perandorake në të majtë, me arijt dhe luanet ngjyre të kuqe simbolizojnë Komnenet, ndërsa shqyta e vogël me shqiponjë me një kokë, simbolizon dinastinë e lashtë të Arianitëve.

Si fisnik i shquar, princi Kostantin Arianiti kishte dhe medaljonin e tij, njëlloj si gjithë fisnikët e tjerë të kohës. Në medaljon është gdhendur portreti i tij dhe emëri "*Constantinus Cominatus*".

Ky medaljon është riprodhuar në botimin e autorit G. F. Hill: "Corpus of Italian Medals of the Renaissance, II, London 1930, tav. 186, n. 1124", por nuk munda ta publikoj, pasi është i mbrojtur nga Copyright ©.

### **Kostantin Arianit Komneni – kapidan dhe diplomat.**

Në verën e vitit 1491 ndodhen disa ngjarje të papritura, që e tronditën Italinë, por dhe që e bënë Kostantin Arianitin protagonist.

Mbreti i Francës Karli VIII, i fryrë nga lavdia dhe mania për të zgjeruar trojet e mbretërisë së tij, me një ushtri të madhe zbriti në Itali, me synimin të pushtonte mbreterinë e Napolit.

Këtë vendim Karli VIII e justifikoi me pretekstin se kishte të drejtën e trashëgimisë të dinastisë të shuar të Anzhuinëve, prandaj u nis të merrte dhe fronin e mbreterisë së Napolit.

Për të garantuar liri kalimi gjatë marshimit nëpërmjet shteteve të shumta të Italisë, për t'i bindu fisnikët italianë të mos organizonin rezistencë në realizimin e qëllimeve të tij, Karli VIII përhap lajmin se nuk do të pushtonte shtetet e tjera italiane, pasi objektivat ishin Napoli dhe organizimi i Kryqezatës antiturke në vendet ballkanike.

Lajmi i organizimit të kryqezatës antiturke u përhap shpejt dhe ngjalli shpresa dhe mundësi, ndër emigrantet e shumë të albanezë, që kishin lënë vendlindjen dhe prej disa dekada jetonin në Itali.

Kostantini e priti me entuziazëm idenë e kryqezates antiturke, që

e shihte si mundësi të rikthehej në Albania, në vendlindje, që e kishte lënë në moshë të re. Kostantin Arianiti, sapo u njoh me këtë plan të mbretit të Francës, i kerkoi mbesës së tij markezes Maria, që ishte regjente e Shtetit të Monferrato, që ta priste me nderimet e duhura mbretin Karli VIII, pasi Ai mund të udhehiqte një fushatë kundër turqëve për çlirimin e Albanisë dhe Serbisë, pra t'i krijonte mundësi atij dhe familjes së markezes Maria, të rikthehej si sovranë.

Kostantin Arianiti shpresonte, se Karli VIII, sapo të pushtonte Mbreterinë e Napolit, do të marshonte në Pulja e të kalonte detin e të çlironte Albaninë, kesisoj u nxit nga një dëshirë ambicioze, të rikthehej Zot i trojeve të atit, Princit Gjergj Arianiti.

Në shtator 1494, Kostantini në krye të 300 kalorës stratiot, e priti Karlin VIII në Asti dhe e shoqëroi në rezidencën e Monferrato.

Nga bisedat me mbretin Karlo VIII, markeza Maria ashtu dhe kapidan Kostantini, u mbushën me shpresa për çlirimin e Albanisë dhe të Serbisë nga pushtuesit osmane. Gjatë këtij takimi miqësor, mbreti i dorëzoi Mariës të gjithë argjendarinë e tij personale, për ta përdorur në financimin e kryqezatës kundër turqëve.

Pas këtij takimi shpresëdhënës dhe në pritje të pushtimit të shpejtë të mbreterisë të Napolit, Kostantin Arianiti u impenjua të organizonte një flotë me anije, për lundrimin e ushtrisë franceze nga Pulja, për të zbarkuar në Durres dhe në portet e tjera të Albanisë. Për këtë kontribut të Kostantin Arianitit, Karli i VIII e dekoroi me urdhërin "Gjerdani i Arte i Shen Mikelit".

Në këtë fushatë përgatitore u impenjua dhe kapidani gjenovez Andrea Doria, i cili dikur kishte ndihmuar në eksodin e albanezëve drejt brigjeve të Italisë e kësaj rradhe u impenjua të kontribuonte në transportimin e ushtrisë të Karlit VIII drejt Albanisë.

Kjo fushatë përgatitore e Kostantinit ngjalli shqetësim në Republikën e Venecias, e cila nuk e shihte me sy të mirë invazionin francez në Itali dhe as përgatitjen e flotës, që e konsideronte aventurë të pa dobishme, andaj e bllokoi flotën në Venecia dhe në mars 1495 e arrestoi Kostantin Arianitin, por pas disa ditësh, u detyruan ta lirojë,

pasi ai gëzonte imunitet, si mbajtës i titullit patric venecian.

Marshimi i mbretit Karli VIII ne per Itali, nuk shkoi si deshironte, pasi fisnikët italianë organizuan rezistencë kunder francezeve.

Ne betejën e Fornovo me 6 korrik 1495, Kostantini me kavalerinë stratiote, u rendit krah mbretit të Franceë në luftimet kundër lidhjes italiane, por ushtria franceze u thye, mbreti Karli VIII u detyrua të kthehej në Francë, ndërsa Kostantini u mbyll në Monferrato.

Më 27 gusht të vitit 1495, në moshën 29 vjeçe, pa pritur vdiq markezia Maria Brankoviç Paleologo. Në keto rrethana u hap problemi i tutelës të djemëve të mitur, që ishin dhe trashëgimtarët legjitim të titujve dhe pronave të Monferrato.

Në këtë situatë duhej një tutor për drejtimin e shtetit Monferrato. Me që Gulielmi ishte i mitur, mbreti Karli i VIII dergoi sekretarin e tij Filipi Kammynes, i cili e ngarkoi Kostantin Arianitin guvernator i shtetit të Monferrato dhe tutor i djemëve të mitur.

Ky vendim ngjalli reagim dhe kundërshtime nga fisnikët e tjerë italiane, të cilet e shihnin me frikë lidhjen e Kostantinit me mbretin e Francës.

Kete veprim Karli VIII e kreu jo vetem per të ruajtur aleancën me Kostantinin, por dhe për faktin se zyrtarisht Ai ishte ndër trashëgimtarët e ligjshëm të Monferrato, i njohur në testamentin e vitit 1491 të markezit Bonifaci III.

Në vitin 1495, Kostantin Arianiti ishte guvernatori i shtetit të Monferrato dhe tutor i dy djemeve të mitur të mbeses Maria Brankoviçi dhe të markezit Bonifaci III Paleologo.

Afrimi i Kostantinit me mbretin Karli VIII i Frances, nuk u pa me sy të mirë nga sovranet e tjerë, kësisoj, Perandori Maksimiliani I, që u emerua pas vdekjes te atit Frederiku III me 16 nentor 1495, tentoi ta largoi nga francezët dhe ta afronte, duke e njohur zyrtarisht si tutor i djemëve te Maries dhe Bonifaci III Gulielmo e Giangiorgio.

Në vazhdim Perandori Maksimilian I e emeroi Kostantinin ambasador dhe e ngarkoi me disa misione diplomatike të veçanta.

Me këto vendime, Perandori Maksimilian I, shpresonte ta bënte

për vehte Kostantinin, por këto plane nuk funksionuan ashtu si dëshiroi, andaj ne 12 qershor 1496 e braktisi Kostantinin e në vend të tij, si misionar diplomatik emeroi mëkëmbësin e tij të përgjithshëm për Italinë.

Këto qendrimë ndikuan që Kostantini, të rikthehej përsëri me francezët dhe në takimin me mbretin Karli VIII, i kërkoi me insistim të rifillonin zbatimin e projektit të mëparshëm për organizimin e kryqzates kunder turqeve.

Ky qendrim ndikoi në rritjen e besimit dhe të prestigjit të Kostantinit ne oborrin e Karlit VIII, aq sa Filip Kammynes përgatiti dokumentat e protokollit dhe vendimin, për emërimin e Kostantin Arianit Komneni - Mbret i Maqedonisë.

Në shtator 1496 Kostantini u takua me kapidanin Gian Giacomo Trivulzio e së bashku përgatiten mbeshtjen për ushtrinë franceze. Planet e organizimit të kryqzates, për çlirimin e trojeve ballkanike nga pushtuesit otomane dështuan, si nga vështirësitë për të krijuar koalicionin e duhur ushtarak, por dhe nga qendrimi i venecianeve, të cilët për interesat e veta egoiste, sabotuan organizimin e flotës dhe mobilizimin e italianëve dhe të albanezeve në këtë koalicion.

Qendrimi i Kostantinit si guvernator i Monferrato dhe roli i tij në politikën e kohës, terhoqi vemendjen dhe te mbreterive e te fisnikëve të tjerë italianë.

Ne dhjetor 1497, Kostantini priti Nikolò Foskarini, i cili ishte ngarkuar me mision diplomatik nga Duka i Savojës Filiberto, i cili i kerkoi bashkepunim ushtarak dhe mardhenie tregëtare.

Në vitin 1498, vdiq Karli VIII i Francës dhe në fron erdhi kushëriri i tij Luigi d'Orléans, i quajtur Luigi XII, i cili kërkoi të konkretizoi përpjekjet e Karlit VIII, për marrjen e mbretërisë së Napolit dhe Dukatit të Milanos.

Luigji XII ishte trashëgimtar i dukeshes Valentina Viskontit, andaj pretendonte Dukatin e Milanos, kesisoj pushtimi i Milanos dhe i Napolit, u bënë objektiva parësore.

Në verën e vitit 1499, Luigji XII, në krye të ushtrisë franceze, i



kapërceu alpet dhe pas pak ditësh arrijti në Monferrato, ku u prit nga Kostantini dhe populli si dhe nga disa markeza, që ishin kthyer në favor të francezëve.

Luigji XII i kërkoi Kostantinin të rradhitej krah tij. Në gusht të vitit 1499 në betejën e Alessandria, Kostantini me kavalerinë e stratiotëve albanezë u rradhiti me ushtrinë franceze dhe së bashku i thyen forcat italiane të komanduara nga Galeazzo da San Saverino. Pas kësaj fitore, Luigji i XII e ngarkoi Kostaninin dhe Gian Giacomo Trivulzio, me 800 kalorës stratiot, të mbronin qytetin e Alesandrisë.

Në tetor të vitit 1499 shkoi në Pavia, të takoi Luigji XII, i cili ishte i zemëruar me Kostaninin, sepse i kishte dhënë leje disa armiqëve të Frances, që ai i kishte burgosur në Monferrato, kësaj Kostantini duke i dhënë leje, ekishte favorizuar arratisjen e tyre.

Luigji XII, kishte filluar të dyshonte për Kostaninin, pasi e kishin informuar se ai por tentonte të krijonte aleanca të reja.

Kur u kthye në Milano në nëntor 1499, francezët e arrestuan dhe e dërguan në burgun e Vixhevano.

Pas disa ditësh e nxorren para trupit gjykues, që për ironi të fatit përbehej nga miqt e tij Trivulzio, francezi Trémouille dhe disa kapitanë të tjerë, të cilët e dënuan me burg në keshtjellën e Navarra, por më pas, e zbutën ndëshkimin, duke e çuar në internim në Francë.

Pas burgosjes, mbreti Luigji XII i sekuestroi pronat e Kostantinin në Monferrato dhe pronat e gruas Françeska. Për drejtimin e pronave të Monferrato, mbreti emëroi administrator francezin Ligny.

Pra, francezet e keqtrajtuan Kostaninin, i sekuestruan pronat, e persekutuan, e arrestuan disa herë, e çuan në gjyqe, e dënuan, e burgosën dhe e internuan.

Në fillim të 1500, Kostantini, i ndihmuar nga një prej rojeve franceze, u arratis nga burgu dhe u fsheh në zotërimet e tij në Ozzano.

Gjatë kësaj kohe tentoi të lidhet me Republikën e Venecias, por pa rezultate, andaj u detyrua të largohet dhe në muajin maj të viti 1500 zbarkoi në Republikën marinare të Piza, por pizanët nën presionin e francezëve e arrestuan dhe e burgosën, madje i njoftuan

autoritetet franceze se do t'ia dorëzonin.

Në fillim të muajit qershor 1500, i ndihmuar nga disa djemë pizanë, u arratis dhe qëndroi i fshehur në shtëpinë e një miku në Piza. Ndërkohë francezët e kërkonin, madje pas një denoncimi, arrijtën ta arrestojnë.

Në këto rrethana fiorentinët i bënë presion francezëve, ta lirojnë.

Francezët u detyruan ta lirojnë dhe ta dorezojnë fiorentineve, të cilët, sapo e morën e arrestuan dhe e burgosën në Livorno.

Përsëri u arratis nga burgu dhe u rikthye në Piza, ku qëndroi i fshehur për pak kohë në shtëpinë e një miku të vjetër.

Pas këtyre persekutimeve dhe ndëshkimeve, që pesoi Kostantini, e ëma Pietrina Arianiti, i bëri presion Venecias, që të nderhynte te francezët dhe fiorentinët, që të ndërprisnin persekutimet ndaj djalit.

Në gusht të vitit 1500, ikën nga Piza dhe shkon në Benevento, ku e pritën dhe e trajtuan mirë. Pas disa javësh, shkoi në San Leonardo, pranë Manfredonia.

Në dhjetor 1500 shkoi në Venecia, në gjendje të dëshpëruar dhe i revoltuar me francezët, që i a kishin marre pronat e tij dhe të gruas.

Në janar 1501 u prezantua kryelartë dhe dinjitoz para Senatit të Venecias, si e përshkruan kronisti Marino Sanuto (I Diarii, III, anno 1503), ku kërkoi bashkpunim për mbrojtjen e të drejtave si patric.

Në shkurt 1501 e priti Dozha i Venecias, Agostino Barbariko, por me që nuk gjeti mbështetjen që priste, atëhere i u drejtua Vienës.

Perandori i Austrisë Maksimiliani I e mori në shërbim në oborrin e tij dhe në muajin tetor 1501 e dërgoj në Trento.

Në vitin 1502 e emëroi komandant i 200 kalorësve stratiot.

Në vitet 1503 - 1508 Perandori i Austrisë, e emëroi ambasador fuqiptotë pranë Kuria Pontifiçe (*Kostantini Arianiti als Diplomat zwischen König Maximilian I. und Papst Julius II. in den Jahren 1503 bis 1508 Stelzer, Winfried - 1968: "Römische Quartalschrift für christliche Altertumskunde und Kirchengeschichte Bd. 63. 1968. S. 29-48).*

Në shkurt të vitit 1504, Kostantini shkoi në Ferrara, ku u prit nga

Duka Alfonsi d'Este, me të cilin lidhi një alenacë e në vazhdim shkoi në Romë, ku u prit në audiencë nga Papa.

Detyra e ambasadorit e favorizoi të zgjeronte njohjet, krijimin e miqësive dhe të aleancave të reja, që i shfrytëzoi për rikonfirmimin e pozicionit si feudal i Monferrato, madje jo rrallë kryente me aftësi rolet si ndermjetës mes Selisë së Shenjtë, Francës dhe Austrisë.

Me këto ndërhyrje diplomatike, Kostantini shmangu një përplasje ndërmjet francezeve dhe shteteve të përçara italiane, si konfirmojnë të gjithë historianët e mesjetës.

Në mars 1504, shkoi në Ostia për të takuar Cesare Borgia, të cilin e bindi, që t'i dorëzoi Shtetit të Vatikanit, disa fshatra, që ende ishin nën zotërimin e tij.

Kur u kthye në Romë, zhvilloi një aktivitet intensiv diplomatik, për të forcuar raportet me Serenissima Venecia, çka fitoi simpatinë e Papa Giulio II.

Këto takime dhe raporte të reja miqësie, Kostantini i shfrytëzoi për të rimarrë trojet e Monferrato e në këto traktativa pati mbështetjen e Guidobaldo da Montefeltro, që ishte Kapiteni i Përgjithshëm i gardës të Vatikanit.

Për rimarrjen e pronave të Monferrato, Kostantinin e ndihmoi nga ana financiare e motra, Andronika Arianiti Komnena Kastrioti e cila ishte dama e shoqërimit e mbretereshes të Napolit.

Ekzistojnë dokumente në arkivat italiane për ndihmat financiare që i jipte Andronika Kastrioti.

Sipas dokumentave arkiviale, princesha Andronika Kastrioti ndërhyri pranë Këshillit të Venedikut dhe në Vatikan, për ta ndihmuar Kostantinin.

Në prill të vitit 1504, Kostantini shkoi në Gjermani, amabasador i Papës për të ndërmjetësuar në marrëveshjen e paqës të francezëve me Perandorinë Austriake, që arrijti ta përfundoi me sukses.

Në muajin maj 1504 u kthye në Itali, por nuk ishte i kënaqur, pasi francezët nuk po ia rikthenin pronat, që ia kishin grabitur.

Në korrik 1504, Kostantin Arianitin e emëruan guvernator i Forli dhe i gjithë Romagnia dhe u prit me nderime të mëdha nga ipeshkëvi Giovanni di Sako.

Në muajin gusht 1504 shkoi në Cesena, por nuk mundi të kryente asnjë takim, pasi në këtë kohë ra epidemia e murtajës.

Në shtator 1504, u impenjua te vendosi armëpushimin ndërmjet fisnikëve Nikolò Guerra da Bagno dhe Tiberti, që ishin në lufte mes tyre. Gjatë traktativave ndeshi vështirësi t'i pajtoi, andaj u detyrua të ndërhyjë me force dhe për këtë qëllim kërkoi përforcime, që të vinte nën kontroll situatën e ndërlikuar në Forli dhe Cesena.

Kostantini dërgoi në Romë një misionar, me detyrë t'i spjegonte Keshillit të Kardinalëve situatën dhe t'i bindëte t' jepnin përforcime, por me që ata nuk i dërguan asnjë ndihmë, atëhere mori nje anije dhe shkoi në Ostia për të takuar agjentin perandorak Luka Rinaldi dhe një peshkop gjerman, me synim të kërkonte mbështeten e tyre.

Pas shumë kërkesash drejtuar Vatikanit, më së fundi u prit nga Papa Giulio II, të cilin e informoi për situatën e veshtirë të krijuar në Forli dhe Cesena.

Papa e vleresoi kerkesen e Kostantinin dhe i dha nje repart te vogel ushtarësh, që u rradhit krah stratiotëve albanezë. Me këto përforcime, në muajin prillë 1505, Kostantinin hyri në Forli dhe u imponoi me forcë armëpushimin fraksioneve ndërluftuese të Orioli dhe Moretini.

Pas kësaj fitore, Papa Giulio II e thirri ne Rome dhe i dha komanden e gardës Palatine, të formuar me 300 kalorës stratiotë albanezë dhe balestrier grekë.

Në vitin 1506, me detyrat e komandantit të gardës, e shoqëroi Papën në vizitat pastorale, kësisoj në gusht shkuan në Peruxhia, në shtator në Forli dhe në nëntor në Bolonja.

Në vitin 1506, në Valencia të Spanjës, vdiq e motra e Kostantinit, Princesha Andronika Komnena Arianiti Kastrioti, bashkëshortja e kryetrimit të Albanisë Gjergj Kastrioti Skenderbeu.

Në vitin 1501, Princeshen Andronika Kastrioti shkoi në Valencia, si dama shoqeruese e Mbretëreshes Johana (Giovanna) Aragona, motra e mbretit Ferdinando Aragona i Napolit.

Së bashku me Donikën, në Spanje shkuan dhe pjestarë të familjes së saj, mes tyre dhe nipi 15 vjeçar Alfonso Kastrioti, i cili më pas u rikthye në Itali, ku u vu në krye të raparteve stratiote albaneze.

Për Kostantin Komnen Arianitin, vdekja e motrës ishte humbje e madhe dhe e dhimbëshme. Ai menjëherë u nis të asistoi në varrimin e princeshës Donika Arianiti Kastrioti. Në udhëtimin për në Valencia, Kostantinin e shoqëruan një grup kalorësish stratiotë.



Princesha Andronika Komnena Arianiti – Kastrioti  
(1428 – 1506)

Princeshën Andronika Arianiti Kastrioti e varrosën në Manastirin Trinitia e Shenjtë në Valencia. Në ballë të varrit të zbukuruar me dy engjëj dhe lapide me skude, me në qendër shqiponjën dykrenare,

ndodhet afresku i “Zonjës të Keshillës së Mirë”, padrone e Albanisë.

Në një gravurë të shekullit XVI, princesha Andronika Arianiti Kastrioti prezantohet me portretin në profil, me emërin në rrethin e portretit të shkruar në latinisht: “DONICE SCANDERBEGI VXOR - DONIKA GRUAJA E SKENDERBEUT” dhe me dy shkrime, njëra në kronizë në pjesën e sipërme ku është shkruar:

EPIRI REGINA VT SIS PRVDENTIA FECIT QVAEQVE IPSI  
POTERAT FORMA PLAECCE RE IOVI  
DONICE SCANDERBEGI VXOR

Në pjesën e poshtëme të gravurës është një shkrim tjetër, i cili në fakt është pjesë përbërëse e dedikimit të sipërm, madje është fraza fillestare e dedikimit ku thuhet:

TANTA TVO ES MERITIS VENIAT SI FAMA MARITO QUANTA  
SVO QVONDAM DEIDAMIA VIRO

Perkthimi i tekstit i plote:

*“Mençuria tënde dhe bukuria tënde, që do t’i kishte pëlqyer dhe vetë Jupiteri, bënë, që Ti të ishe mbretëresha e Epirit.*

*O ti gruaja e Skenderbeut, që i dhe aq shumë famë burrit tënd, për meritat e tua, ashtu si Deidamia i dha burrit (Akilit)”.*

Theksoj se në mbishkrimin e poshtëm, autori i gravurës ka bërë një gabim orthografik, ka shkruar ES MERITIS, ndërsa në gjuhën latine shkruhet EX MERITIS.

Në mars 1507, Kostantinin e urdhëruan të linte Forlìn dhe Roma-njen dhe të kthehej në Romë, ku e ngarkuan me detyra me rëndësi .

Në shtator 1507, Papa Giulio II, e dërgoi Kostantinin në Gjermani, si përfaqësues i Vatikanit, në bisedimet për të krijuar alleancën me perandorinë Austriake dhe mbreterinë e Francës.

Pikerisht në këtë kohe, perandori Maksimiliani I i Austrisë, i besoi misionin e mediatorit me Vatikanin, për të ndikuar te Papa ta njihnte Perandor, sepse ende nuk e kishte kurorëzuar në Vatikan.

Ky aktivitet intensiv i Kostantin Arianitit, nuk u pa me sy te mirë nga Venecianët, të cilet filluan ta sulmonin dhe të kontrollonin lëvizjet dhe aktivitet e tij.

Në mars 1508, Kostantini e kritikoi Serenissiman, sepse i kishte hapur letrat, që nga Rimin i dërgonte Perandorit të Austrisë.

Konfliktet e Serenissima me Perandorinë Austriake, u thelluan në prill të vitit 1508, kur venecianët pushtuan Forlín dhe kështjellën e Belgrado në Kormons, që ishte pronë e Kostantinit.

Po në vitin 1508, Papa Giulio II e dërgoi Kostantinin të bisedonte me venecianët, për të vendosur klauzolat e Lidhjes të Kambrai (Lega di Cambrai) e në kembim venecianët t'i kthenin Vatikanit, Riminin dhe Faenza.

Në maj 1509 Kostantini shkoi të takoi Maksimilianin I, të cilit i dorëzoi 50.000 dukate, nga ana e Papa Giulio II, që ia dergonte për të financuar rifillimin e luftës kundër Republikës Venecias.

Me t'u kthyer në Vatikan, e derguan në krye të ushtrisë, të rimarrë zoterimet e Pizzighettone dhe Asola, por pa sukses.

Në qershor 1509, Perandori Austriak e ngarkoi Kostantinin me mision të bisedoi me venecianet, që t'i dorezonin Padovën Austrisë, por ata nuk u bindën, andaj bashkë me forcat e Matteo da Bussetto e pushtuan qytetin.

Serenissima nuk e toleroi këtë veprim e menjëherë e sulmoi dhe e mori Padovën, ndersa Kostantini u detyrua të largohej.

Në këto rrethana organizoi një takim sekret me anetarët e Këshillit të Dhjetëve të Serenissima, për t'i bindur ta dorëzojnë qytetin, por përsëri dështoi, nuk mori rezultatet që pretendonte.

Për të dalë nga situata e ndërlikuar, perandori Maksimilian I, e emëroi Kapiten i Pergjithëshëm i reparteve italiane në shërbim të Austrisë. Në krye të këtyre forcave mercenare Kostantini e pushtoi Viçensën, sulmoi venecianët në Padova dhe vazhdoi sulmet në veri, ku mori njeri pas tjetrit qytetet e Goricia dhe Trieste të Friulit.

Në gusht 1509, mobilizoi një repart me mercenarë në Citadella dhe shkoi në mbrojtje të Padovës.

Në shtator 1509, në rradhët e mercenarëve italianë të mobilizuar nga Kostantini, shpërthyen revolta kundërshtie e pakënaqësie, sepse nuk i kishin paguar për shërbimet e kryera.

Në tetor 1509 Perandori Maksimilian I, e emëroi Kostantinin komandant i ushtrisë me 2000 kalorës dhe 1500 këmbësorë, që shkuan në mbrojtje të Vinçensës. Gjatë marshimit drejt Vinçensës, ushtria e Kostantinut sulmoi disa qendra të banuara, duke kryer raprezalje dhe grabitje në popullatë, duke provokuar urrejtje nga banorët, që u masakruan dhe u grabitën nga ushtria.

Në nëntor 1509 shkoi në mbrojtje të Veronës, por pas konfliktit me francezin Jacques de la Palisse, të cilin e sfidoi me duel, u detyrua t'ia lëshoi qytetin trupave të komanduara nga Gaspere San Severino.

Pas këtyre ngjarjeve, Kostantini u kthye në Romë.

Në dhjetor Papa e dërgoi me mision diplomatike në Firencë.

Në janar 1510, Kostantini kaloi në shërbim të vencianeve, të cilët e ngarkuan të ndërmjetësoi të pajtonte Papen me vencianët.

Në prill të vitit 1510, shkoi në Ravena dhe me pas u nis për në Gjermani, i ngarkuar me mision diplomatik nga Papa Giulio II, por dhe nga vencianët, që i dhanë mandatin të bisedonte me Perandorin Maksimilian I, për të firmosur armëpushimin me sejcilin prej tyre në veçanti.

Në muajin maj 1510, Papa e dërgoi në Pesaro e njëkohësisht e emëroi Roja i Përgjithshëm i Koncilit të Vatikanit, që u hap në kishën e Shen Giovanni Laterano në Romë, ndërsa Mbreti i Francës kishte kërkuar, që koncili të mbahej në Piza, që në këtë kohë ishte e pushtuar nga francezët.

Në fund të muajit maj shkoi në Gjermani, megjithë kundërshtimin e Papa Giulio II, që e donte ta kishte pranë.

Në muajin qershor u kthye në Rome dhe pikërisht në këtë kohë, Paolo Lichtenstein e kërkoi të kthehej në Gjermani, për të vazhduar traktativat e nisura për paqen.

Para nisjes takoi Dozhën e Venedikut, i cili i dha 300 dukate, për t'i përdorur si shpenzime për udhëtimin.

Bisedimet për paqe nuk dhane rezultatet, pasi Perandori Maksimilian I kishte shumë pretendime, që nuk mund të realizoheshin as nga Vatikani dhe as nga Venecia.



Në janar 1511, kthehet nga Gjermania e shkon në Kadore, më pas në Kioxhia, ku mori një anije për Ravena. Kur arrijti në Punta su Lago, takoi Papa Giulio II, te cilin e infomoi për dështimin e bisedimeve për paqe me perandorin Maksimilian I.

Në vitin 1512, Papa Giulio II e emëroi Kostantinin, komandanti i forcave të shtetit Papal.

Raportet e miqësisë të Kostantinit me Papa Giulio II, ishin favorizuar dhe nga një rrethanë tjetër, lidhjet e krushqisë me kushëririn e Papës, Bartolomeo Giuppo Della Rovere, i cili ishte i martuar me Maria Arianitin, motrën e Kostantinit. Me këtë fakt, sqarohet historia e Maries, pasi rrefimet popullore shqiptare, thone se e morën robëreshë nga turqit, të cilët e dërguan në Stamboll, në haremin e Sulltanit, madje sipas kësaj legjende, djali i saj u bë Sulltan i njohur Bajaziti II, ndërsa historianet Babinger e Fiori, dokumentojnë se erdhi në Itali, ku u martua me Bartolomeo Giuppo Della Rovere.



Keshtjella Montefiore Conca (Konka),  
rezidenca e Princit Kostantin Arianiti.

Në se rrëfimi i parë është legjendë, kjo që shkruajnë Babinger dhe Fiori janë të dokumentuara. Maria ishte e bija e Gjergj Arianitit me gruan e dytë Petrina Forkone, pra motra e vogël e Kostantinit.

Këto fakte e kanë zgjidhur enigmën e Maria Arianitit, pra mbetet varjanti i Babinger, Maria shkoi në Itali me të nënën dhe vëllezërit.

Më 3 maj 1514, kapidani Kostantin Arianiti ndodhej në Romë, në krye të forcave ushtarake, që asistuan Koncilin e Vatikanit në Kishën e Shen Giovanni Laterano, i njohur Koncili Laterense V.

Pozicionin e komandantit të trupave të Selisë së Shenjtë, e shfrytëzoi me mjeshtëri, për të realizuar qellimet e tij, kështu në muajin korrik takoi në Trentino kardinalin Kurzense dhe së bashku shkuan në Monferrato, ku rimori pronat, që ia kishin rrembyer francezët.

Në mars 1515, Papa Leoni X, kontributin e Kostantin Arianitit, e shperbleu, duke i dhuruar feudin e Fano.

Qëndrimi armiqësor i francezeve e nxiti Kostantinin të dali hapur kundër tyre, madje në qershor 1515, në krye të stratiotëve, u rradhit krahu me zviceranët, duke kontribuar në thyerjen e francezëve.

Në vazhden e sukseseve, në korrik 1515, në krye të 8000 ushtarëve, sulmoi dhe mori zoterimet e Monferrato, kështu rikuperoi pronat dhe forcoi pozicionin e tij politik, ekonomik dhe ushtarak.

Në 1516, Kostantini, me një repart kalorësish stratiotë, shkoi në ndihmë të motrës Maria Arianiti dhe burrit të saj Bartolemo Della Rovere, të cilët i mbaeshteti të rimarrin Dukatin e Urbino.


Një ndër pasardhësit e shquar të fëmijëve të Maria Arianitit, është Ludovik Kixhi Albani Della Rovere (1866 – 1952), princi VIII i Farnese, murg në ushtrinë italiane, grand maestro i Urdhërit ushtarak Sovran të Maltes

Fuqizimi i Kostantinut u pa me xhelozë nga fisnikët e tjerë, kështu Lorenzo de Medici, e sulmoi dhe ia mori zotërimet e Fano, duke u justifikuar, se ndërhyri për të vënë rregull e për të shuar konfliktet, që kishin shpërthyer ndërmjet fraksioneve në qytet.

Këto rrethana e detyruan Kostantinin të rikthehet në Romë.

Marrja e pronave nga francezët dhe nga fisnikët e tjerë italiane, e detyruan Kostantinin të shesë pronat e mbetura Terruxhia, Ozano, Rivalta e Tonengo dhe një shtëpi në kantonin e Montarone, me një vlerë të përgjithshme 30 000 dukate të artë, si rezultojnë në aktin e

shitjes: “Qui, il 16 agosto 1521, Mercurino Arboreo di Gattinara acquista da Costatino Comneno, principe di Tessaglia e di Macedonia (che vende anche a nome della consorte Francesca di Monferrato e dei figli), per tramite di due procuratori, il proprio Lorenzo protonotario apostolico e camerlengo del pontefice ed il proprio maggiordomo Carlo Gazzino: i beni di Terruggia, Ozzano, Rivalta e Tonengo, unitamente a una casa in Casale, situata nel cantone di Montarone, davanti alla chiesa di San Stefano, «quefuit quondam Facini Canis», per 30.000 ducati d'oro. (ASVc, Famiglia Arboreo di Gattinara, marzo 3).



Princi Ludovico Chigi Albani Della Rovere (1866 – 1952).

Në dhjetor 1521, me vdekjen e Papa Leoni X, Kolegji i Kardinalëve të Selisë së Shenjtë, e emëroi Kostantinin, komandanti i 800 këmbësorëve, që të mbanin rregullin në qytetin e Romës. Papa i sapo zgjedhur Adriano VI, duke vlerësuar kontributet e Kostantininit për Shtetin Papal, e shpërbleu duke i dhënë në pronësi Mondainon dhe keshtjellën e Montefiore Conca, qender e banuar malore në Rimini.

Montefiore ishte prona e vetme e mbetur në zoterim, pasi te tjerat ia kishin sekuestruar, ose i kishte shitur, perfshi feudin e Monferrato.

Në gusht 1525, Papa e shpërbleu Kostantinin për shërbimet dhe devotshmërine ndaj Vatikanit, duke i dhuruar Arianit Komnenit, djalit të vetem të Kostantinit, kështjellën e Torrenova. v

Në muajin prill 1530, i lodhur nga mosha, nga mundimet dhe nga një semundje akute, trupi i Kostantinit u dergj në shtrat për rreth një muaj. Në ato ditë vuajtje, pran tij iu ndodhën pjestarët e familjes dhe stratiotët besnike.

Më 8 maj 1530, pushoi se rrahuri zemra e Princit të Arianitëve, pra kete dite u nda nga jeta kapedani trim dhe diplomati i mençur, Kostantin Arianiti Kominata Komneni, që bëri histori në Itali.

Disa thone se vdiq në Rome, sipas te tjerëve në Fano. Edhe vendi i varrimit nuk dihet me saktësi. Sipas Franz Babinger, kapedan Kostantin Arianitin e varrosën në Bazilika Shen Apostujve, por Vincenzo Forcella shkruan: *“Sipas regjistrit të kishës dhe zyrave të tjera të komunës të Romës (Roma 1874, p. 40, nr 117), Kostantin Arianitin e varrosen ne kishen e Shen Agostinit, por varri nuk eshte gjetur, ndersa emeri i tij figuron i shkruar ne latinisht ne regjistrin e Kishes”.*

Më 29 prill 1530, rreth nje jave para se te ndahej nga jeta, Princi Kostantin Komnen Arianiti kishte hartuar testamentin, te cilin fillimisht e ruajti noteri Lorenzo Leardini i Montefiore e me pas origjinali u depozitua në Bibliotekën Komunale të Gambalunga - Rimini (cfr. *Monumenti riminesi autografi raccolti e conservati da Michelangelo Zanotti notajo collegiato di Rimini, XIV, c. 23*).

Me këtë testament, kështjellën e Montefiore Konka (Conca) pranë Riminit, Kostantini ia la të birit Arianit Komnen Arianitit.

## **Pasardhësit e Kostantin Arianitit.**

Nga martesja e Kostantin me Françeska Paleologo linden shtatë femijë, një djalë me emërin Arianit dhe 6 vajza.

Pas vdekjes të Kostantin, për Arianitin e ri u perkujdes e ëma Françeska Paleologa Komenena Arianiti. Nënë e bir jetuan bashkë disa vite në kështjellën e Montefiore Konka në Rimini.

Arianitin, që në moshë të re, e kërkuan në Vatikan dhe e emeruan Prefekt i trupave Pontifiçe.

Vajzat e Kostantin, u martuan me fisnikë italianë, andaj shume historiane kur shkruajnë për këtë familje të gjërë fisnikë e cilesojnë dinastia e Arianiteve.

Vajza e parë e Kostantin me Françesken ishte *Andronika*, e cila u martua me kontin Karlo III Toko, Dhespoti i Zante dhe i Artës dhe princi titullar i Leukades.

Vajza e dytë *Pentesilea*, u martua me fisnikun Lek V Dukagjini, pasardhës i dinastisë të familjes të Dukagjinëve, që pas pushtimit turk iku dhe u vendos në Itali, ku prej vitesh jetonte dhe shërbente në oborrin e mbretërisë së Napolit.

Vajza e tretë, Hippolita (lindur më 1507), në vitin 1525 u martua me Zenodio de Mediçi, konti i Verrukio dhe Skortikata. Një vit me pas (1533), i vdes burri dhe me pas u martua me Lionello Pio, zoti i Karpi-t. Hippolita vdiq në Meldola në vitin 1566.

Vajza e katërt Polissena, në vitin 1524 u martua me kontin Rinaldo Ottoni, Zoti i Matelica në Marke.

Polissena vdiq në moshë të re, në vitin 1531.

Vajza e pestë Deianira, fillimisht u martua me Gaspare Trivulzio, Zoti i Kasteldidone. Pas vdekjes të bashkeshortit, në vitin 1549 u martua me kontin Giorgio Trivulzio di Melzo, komandanti i trupave të Republikës Veneta.

Në vitin 1556, Deianira mori nga pronaria e re e Monferrato një shpërblim konsistent për shërbimet e kryera nga e ëma Françeska, kur jetonte në Monferrato (*ASMi, atti Notarile, Moriggia Gio. Giacomo, 1556 apr. 15.*)

Elena, vajza me e vogel e Kostantinit me Franceskën, ne vitin 1546 u martua me fisnikun spanjoll Don Juan de Luna, kështjellari i Milanos. Nuk kishin femijë. Pas vdekjes te shoqit, Elena u vendos në Genova.

Në testamentin e hartuar më 21 prill 1589, Elena ia dhuroi gjithë pasurinë dhe zoterimet e saj sternipit Françesko di Toko, pra nipi i te motres Andronika (gruaja e Karlo Toko - Dhespoti i Artës).

Pas vdekjes te Kostantinit, baronesha Françeska Arianiti, shkoi të shërbente si dama e shoqërimit e dukeshës Kristina e Danimarkës, gruaja e Françesko II Sforca - Duka i Milanos.

Ndejti pak kohë ne Milano, pasi e ftuan ne Bar, ne oborrin e Lorenës, si guvernatore dhe dama e shoqërimit e vajzave të dukës Françesko di Lorena, ku qëndroi deri ne muajt e parë të vitit 1561.

Në aktin e lirimit nga këto impenjime, Duka Karlo, i biri i Kristinës së Danimarkës, e kompensoi shërbimin shembullor të Françeskës, duke i akorduar një pension vjetor prej 4000 skudesh, me të drejtë depozitimi te trashëgimisë me testament, te 600 skudeve, si tregon vetë Françeska në akt-marrëveshje.

Gjithashtu, duka i Lorenës, do te paguante 500 dukatoni në vit, një prej trashëgimtarëve të saj, që Françeska caktoi nipin, djalin e Andronika Arianitit Komnena Toko.

Në dokumentat e ruajtura në arkivin e familjes Toko, gjendet dhe kopja e një donacioni prej 1200 dukate ari (ose 4000 dukatone), që dukesha Kristina e Danimarkës, i dha Françeska Arianitit Kominata Komnena më 25 qershor 1561. Këtë shumë dukate ari, Françeska ia dhuroi vajzës së madhe, Andronika Arianiti Toko.

Jur ndodhej ne Lorene, para se te rikthehej ne Itali, Françeska Arianiti, me 26 qershor 1561, me testamentin e hartuar në Bar, kryeqyteti i Lorenës, me noteret Nikola dhe Pietro Hardy, rezulton se pronat që i kishin mbetur, ia kaloi mbesës, vajzës të djalit Arianitit, e cila dhe ajo quhej Andronika III.

Kur u kthye ne Itali, markeza Françeska Paleologa Arianiti, shkoi në Koneliano Veneto, ku jetoi me vajzën Deianira dhe dhëndërrin,

kontin Giorgio Trivulzio, komandanti i venecianëve.

Markeza Françeska Paleologa Arianiti, me 17. 12. 1561, la testamentin e fundit, duke anuluar të parin.

Testamenti u hartua në Koneliano Veneto, në prani të noterit Francesco Kollalto.

Ne testament theksohet se në rastin e vdekjes të bijës Andronika Arianiti Toko, pensioni 500 dukatoni, do t'i kalohej dy vajzave: Elenës e martuar me Juan de Luna dhe Deianira-s, e martuar me kont Giorgio Trivulzio, me të cilët kaloi vitet e fundit të jetës.

Ne te gjithë testamentet, markeza Françeska Arianiti cilësohet e bija e markezit Bonifaci III Paleologo i Monferrato dhe mbajtëse e titullit Princesha e Maqedonisë.

Ndër të tjera theksohet se kishte shërbyer deri para disa muajsh si dama e shoqërimit të dukeshave në oborrin e dukëve të Lorenës, të cilët ishin dhe bamirësit, që i kishin dhënë këto pensione.

Djali i Kostantinit, Arianit Kominata Komneni Arianiti, shërbeu në Vatikan si Prefekt i trupave Pontifiçe.

Arianiti, i vetmi trashëgimtar mashkull i dinastise Arianiti, me 15 nentor 1551, mbeti i vvarë në fushën e betejës, kur në krye të trupave Pontifiçe, luftoi kundër dukës së Parmës – Ottavio Farnese.

Kapedanin Arianit Arianiti Kominata Komnena, e varrosën në kishën e Shën Giovanni në Parma.

Arianiti, ishte i martuar, por nuk dihet emëri i bashkëshortes.

Nga kjo martesë lindi një vajzë, që i dhanë emërin Andronika, në nderim të të famëshmes princesha Andronika Arianiti Kastrioti.

Adronika e Arjanitit, ishte trashëgimtaria e fundit në rradhën e dinastisë të Arianitëve.

Në vitin 1568, Andronika u martua me kontin Orazio Trivulzio di Melzo, i cili vdiq ne vitin 1573.

Pas disa muajsh, u martua me Giorgio Seko, konti i Mozzanika. Nga kjo martesë përfitoi konti Seko, i cili pervehtesoi mbiemërin perandorak të bashkëshortes, kësisoj me krenari, por në menyrë abuzive u njoh publikisht si Konti Giorgio Seko Komneno.

Edhe me martesën e dyte, Andronika nuk lindi femijë, por tërë pasurinë dhe mbiemërin perandorak, e morën djemtë e kunatës Virgjinia (e motra e burrit), e cila ishte e martuar me kontin Stefano Soçino Suardo.

Në fund të shekullit XVII, nipat dhe mbesat e Virgjinias, e përdornin mbiemërin Suardo-Komneno.

Pjestari fundit i dinastisë Arianiti, ishte konti Fermo Komneno, i cili vdiq pa lënë trashëgimtar.

Arkivin e familjes së tij, bibliotekën e pasur e plot me dokumenta rre rralla, konti Fermo ia dhuroi Spitalit të Madh të Milanos, bashkë me tërë pasurinë që kishte trashëguar.

Me vdekjen e Kontit Fermo Komneno në vitin 1841, u shua përfundimisht linja mashkullore e dinastisë së famëshme albaneze të Arianitëve, e cila në mbi 10 shekuj, jetoi me krenari dhe lavdi në të dy anet e Adriatikut, në Albania dhe në Itali.